



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 464 Akti

Nr. 698 Vendimi
Tiranë, më 15.9.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 15.9.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Gjergji Tako**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Gjergji

Tako, administroi rezultatet e testimit nga Shkolla e Magjistraturës dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Gjergji Tako është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Z. Gjergji Tako, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.
3. Trupi gjykues, i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia; (ii) të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit; (iii) të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.
4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe më pas nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016. Më tej, u administruan edhe denoncimet e paraqitura nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në datën 13.1.2020, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi subjektit të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues dhe informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Në përgjigje², subjekti paraqiti në Komision deklaratën e datës 31.1.2020, në të cilën deklaronte se nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues dhe më tej përgjigjet e pyetësorit standard.

¹ Email datë 13.1.2020, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

² Përgjigje për pyetësorin standard – protokolluar me nr. *** prot., datë 31.1.2020, në Komision.

7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 6.4.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 6.4.2022, përmes postës elektronike³, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkuar të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 21.4.2022.

9. Në datën 21.4.2022, subjekti përmes postës elektronike⁴ paraqiti pretendimet me shkrim, si dhe depozitoi në protokoll⁵ pranë zyrave të Komisionit parashtrimet dhe provat në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

10. Komisioni, me anë të postës elektronike⁶, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 27.4.2022, ora 10:00.

11. Pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën e datës 27.4.2022, trupi gjykues, në diskutimet mbi vendimmarrjen, konstatoi se: (i) Komisioni në rezultatet e hetimit është shprehur me rezervë lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti për vërtetimin e të ardhurave të realizuara në Itali nga shtetasit R. B. dhe I. S., pasi nuk ishin paraqitur në formën e duhur ligjore dhe subjekti i rivlerësimit në parashtrimet shtesë të depozituara në datën 26.6.2022 pranë Komisionit ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 26.4.2022, të bashkëshortes së tij, znj. M. T., e cila deklaroi se motra e saj D. D. ka shkuar në Itali për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm për subjektin Gjergji Tako; (ii) subjekti i rivlerësimit, në datën 28.4.2022, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike kopje të vendimit, që ka lidhje me pezullimin e hetimeve lidhur me procedimin nr. ***, viti 2010, ndaj shtetasit A. S., të cilin e ka marrë në format *Word* nga arkiva e kompjuterit të tij; (iii) Komisioni, në datën 16.3.2022, ka aplikuar në sistemin elektronik të ASHK-së për t'u njohur me dokumentacionin teknik e ligjor mbi bazën e të cilit është regjistruar pasuria nr. ***, z.

³ Email datë 6.4.2022, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

⁴ Email datë 21.4.2022.

⁵ Parashtrime..., datë 21.4.2022 (nr. *** prot., datë 21.4.2022, në Komision); dokumente shtesë (nr. *** prot., datë 26.4.2022 në Komision); email datë 28.4.2022.

⁶ Email datë 22.4.2022, “Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me procesin e rivlerësimit”.

k. ***, Përmet, nga e cila truell me sip. 275 m² dhe sip. 188 m² ndërtesë, në Përmet, në pronësi të personit të lidhur P. T. (si bashkëpronar) dhe përgjigjja e ASHK-së ende nuk ishte administruar.

12. Sa më sipër, Komisioni, me vendimin e datës 28.4.2022, vendosi: (i) Të riçelë hetimin administrativ kryesisht ndaj subjektit Gjergji Tako për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) Subjekti i rivlerësimit të paraqesë në formën e kërkuar nga ligji: (a) dokumentacionin ligjor lidhur me të ardhurat e realizuara në Itali nga shtetasit I. S. dhe R. B.; (b) vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2010, në ngarkim të shtetasit A. S. bashkë me procesverbalin e marrjes në pyetje të këtij shtetasi; (iii) Të administrojë nga Drejtoria Vendore ASHK Përmet dokumentacionin teknik e ligjor mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i pasurisë nr. ***, z. k. ***, Përmet; (iv) Të shtrijë hetimin lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit duke përzgjedhur nga lista e statistikave të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (pjesë e dosjes së raportit të rivlerësimit profesional të KLP-së) dosje penale të ndjekura nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, duke përjashtuar dosjet e analizuara në raportin nr. *** prot., datë 8.7.2020 të KLP-së, “Për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako”.

13. Komisioni, me anë të postës elektronike⁷, njoftoi subjektin se me vendimin e datës 28.4.2022 ka vendosur kryesisht të riçelë hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit dhe pas përfundimit të hetimit do të njoftohet me anë të postës elektronike në lidhje me hetimin e kryer dhe rezultatet shtesë.

14. Në mbledhjen e datës 4.5.2022, Komisioni përzgjodhi në mënyrë rastësore nga lista e statistikave të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 16 dosje penale të ndjekura nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, duke përfshirë pesë dosje penale të përfunduara me vendim mosfillim procedimi penal, pesë dosje penale të përfunduara me vendim pushim procedimi penal dhe pesë dosje penale të dërguara për gjykim. Gjithashtu, Komisioni vendosi të kërkojë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë listën e çështjeve penale të hetuara nga subjekti Gjergji Tako për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, për veprat penale të parashikuara nga nenet 244, 245, 256, 257, 258, 159, 260, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 283, 283/a, 284, 284/c dhe 285/a të Kodit Penal, me qëllim përzgjedhjen në mënyrë rastësore të çështjeve për shqyrtim.

15. Më pas, në mbledhjen e datës 10.5.2022, Komisioni përzgjodhi në mënyrë rastësore nga lista e përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë pesë dosje penale të regjistruara për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 244, 245, 256, 257, 258, 159, 260, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/d, 283, 283/a, 284, 284/c dhe 285/a të Kodit Penal.

16. Në datën 2.6.2022, subjekti dorëzoi në protokollin e Komisionit⁸ parashtrime shtesë dhe prova lidhur me sqarimin e çështjes së ndjekur nga ana e tij ndaj shtetasit A. S..

17. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit shtesë dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret, në datën 3.6.2022, vendosi: (i) përfundimin e

⁷ Email datë 28.4.2022.

⁸ Parashtrime shtesë dhe prova (nr. *** prot., datë 2.6.2022, në Komision).

hetimit kryesisht shtesë për subjektin e rivlerësimit Gjergji Tako, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit shtesë të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruar nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shtesë, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18. Në datën 3.6.2022, përmes postës elektronike⁹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim subjektit iu kërkua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 13.6.2022.

19. Në datën 13.6.2022, subjekti dorëzoi në protokollin e Komisionit¹⁰ parashtrimet dhe provat lidhur me rezultatet e hetimit shtesë.

20. Komisioni, me anë të postës elektronike¹¹, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 15.6.2022, ora 10:00.

21. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gjergji Tako, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

22. Në datën 27.4.2022 u zhvillua seanca e parë dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë bashkë me avokatin R. K..

23. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

24. Z. Gjergji Tako, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

⁹ Email datë 3.6.2022, “Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit shtesë lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit”.

¹⁰ Protokolluar me nr. *** prot., datë 13.6.2022 pranë Komisionit.

¹¹ Email datë 13.6.2022, “Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit shtesë”.

25. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 27.4.2022, subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako kërkoi konfirmimin në detyrë.

26. Më pas, në datën 15.6.2022, u zhvillua seanca e dytë dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit administrativ shtesë në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

27. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ shtesë, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

28. Z. Gjergji Tako, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht shtesë, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

29. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 15.6.2022, subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, kërkoi konfirmimin në detyrë.

30. Seanca dëgjimore e datës 15.6.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 17.6.2022, për shpalljen e vendimit.

31. Në përfundim të seancës së datës 17.6.2022, trupi gjykues, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 58, nenit 44/b, si dhe të pikës 1 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi: “Pezullimin nga detyra për një periudhë 1-vjeçare të subjektit të rivlerësimit Gjergji Tako dhe detyrimin e tij për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës”. Ky vendim iu dërgua Shkollës së Magjistraturës, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit për subjektin e rivlerësimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

32. Pas përfundimit të programit të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2023, ka njoftuar Komisionin për rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit pas programit të trajnimit, sipas kërkesave të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, nga ku rezultoi përfundimi me sukses i tij, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni në vendimin e ndërmjetëm të datës 17.6.2022.

33. Pas administrimit të këtyre rezultateve, trupi gjykues, i mbledhur në dhomë këshillimi, diskutoi, vlerësoi dhe vendosi të konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Gjergji Tako.

34. Komisioni, me anë të postës elektronike¹², njoftoi subjektin e rivlerësimit se Shkolla e Magjistraturës, bazuar në pikën 2, të nenit 60, të ligjit 84/2016, me shkresën nr. *** prot., datë 21.07.2023, ka dërguar pranë Komisionit rezultatet e provimit përfundimtar dhe rezultoi se

¹² Email datë 13.9.2023, “Komisioni –Ftete në seancë dëgjimore publike për shpalljen e vendimit përfundimtar për procesin tuaj të rivlerësimit”.

subjekti është vlerësuar gjithsej me 90.7 pikë, në nivelin Shumë Mirë, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e ndërmjetëm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjithashtu, e njoftoi se Trupi gjykues, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, vendosi ta ftojë në seancë dëgjimore për shpalljen e vendimit përfundimtar në datën 15.9.2023, ora 9:50.

35. Në datën 15.9.2023, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

36. Subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

37. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

38. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

39. Referuar vendimit nr. 2/2017¹³ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe

¹³ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

40. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

41. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për periudhën 2004 – 2016 dhe në datën 29.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurive*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

42. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2004 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

43. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

44. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit janë si vijon: (i) M. T., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit – person i lidhur; (ii) P. T., babai i subjektit të rivlerësimit – person i lidhur për shkak se është pjesë e gjendjes familjare të subjektit të rivlerësimit; (iii) V. K., teza e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak se i ka dhënë hua subjektit shumën 600.000 lekë në datën 20.2.2005 për blerjen e automjetit; (iv) V. D., vjehrra e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, për shkak se i ka dhënë hua subjektit shumën 8.000 euro në datën 22.8.2012 për blerjen e apartamentit në ***, Tiranë.

Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur

1. Apartament me sipërfaqe 57,1 m², me vlerë 3.400.000 lekë, në Tiranë

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi në rrugën “****”, p. ***, shk. ***, kati ***, ap. ***, sip. 57,1 m², vit i krijimit 2004, vlera 3.400.000 lekë*”, me pjesë takuese 100%. Si burim krijimi deklaron shitjen e banesës së familjes në Përmet me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.11.2004, të ardhurat nga 38 vite punë të pandërprerë dhe pensioni i babait bashkë me nënën, mbetjet (interesat) e tërhequra nga firmat piramidale, të ardhurat nga administrimi i një autoshkolle në Përmet në vitet 1992 – 1996, të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës në të tre vitet, përfshirë edhe vitin e praktikës me pagë të plotë 2003 – 2004¹⁴. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁵.

1.2. Në kushtet kur subjekti kishte deklaruar të njëjtat burime të krijimit për shumë pasuri, me anë të pyetësorit nr. 1¹⁶, Komisioni i kërkoi subjektit të përcaktonte vitin e krijimit të këtyre të ardhurave të shoqëruar me dokumentacionin ligjor justifikues, si dhe të paraqiste dokumentacionin ligjor justifikues që vërteton transaksionet e deklaruar financiare për blerjen e apartamentit.

1.3. Në përgjigje¹⁷, subjekti deklaroi se të ardhurat për krijimin e pasurive apartament janë krijuar si vijon: (i) të ardhurat nga shitja e apartamentit në Përmet janë krijuar në vitin 2004 dhe kjo justifikohet nga kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.11.2004, si dhe nga derdhja monetare që ka kryer pranë Tirana Bank, në datën 2.11.2004, në favor të shitëses A. S.. (ii) të ardhurat nga shoqëritë e skemave piramidale janë krijuar në vitet 1992 – 1997, vërtetuar nga shkresa nr. *** prot., datë 24.10.2016; (iii) të ardhurat nga autoshkolla janë krijuar në vitet 1992 – 1996, fakt i vërtetuar nga deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2017, shkresa nr. *** prot.,

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2016, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 7.12.2016, e DRSSH-së, Gjirokastër; vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016, i ISSH-së Tiranë; vërtetimet nr. *** prot., datë 11.10.2016 dhe nr. *** prot., datë 12.10.2016, të DSHP-së, Përmet; vërtetim nr. *** prot., datë 3.11.2016, i Shkollës së Magjistraturës; vërtetim i datës 17.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, bashkë me tabelën e të ardhurave të realizuara në vitet 2003 – 2007; deklaratë noteriale nr. ***, datë 15.10.2016.

¹⁵ Kontratë shitblerjeje apartamenti nr. ***, datë 29.10.2004; certifikatë pronësie datë 14.12.2004, në emër të shtetasit Gjergji Tako, për apartamentin nr. ***, me sip. 57 m²; kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.11.2004; shkresë nr. *** prot., datë 17.10.2016, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Ministria e Financave, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim.

¹⁶ Email datë 13.5.2020.

¹⁷ Email datë 1.6.2020.

datë 9.11.2016, e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shkresa nr. *** prot., datë 1.12.2016, e DPSHTRR-së; (iv) kursimet e prindërve provohen nga dosjet e pensionit të secilit ku provohet periodha e punësimit të tyre; (v) të ardhurat nga punësimi pranë Shkollës së Magjistraturës provohen nga listëpagesat përkatëse pranë kësaj shkolle; (vi) automjeti me targë *** është financuar pas shlyerjes që bëri shteti koeficientin 20,15%, për likuidimin shoqërisë “***” tek babai i tij në masën 515.085 lekë, në vitet 2001 – 2002. Bashkëlidhur këtij deklarami subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës¹⁸.

1.4. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK¹⁹ Tirana Veri, paraqitur edhe nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe në pyetësorin standard²⁰, rezulton se sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 29.10.2004, subjekti ka blerë nga shtetasit A. S., I. S., A. S. apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 57 m², me adresë rruga “***”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***,Tiranë, kundrejt çmimit 3.400.000 lekë. Në kontratë përcaktohet se ky çmim është likuiduar jashtë zyrës noteriale pa asnjë pretendim nga palët kontraktuese.

1.5. *Lidhur me kohën e fillimit të përdorimit/banimit në këtë apartament*, Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: rruga “***”, p. ***, sh. ***, k. ***, ap. ***. Nga dokumentacioni i administruar nga FSHU-ja²¹ rezulton se subjekti Gjergji Tako figuron klient i OSHEE-së me kontratë furnizimi nr. ***, me instancën në Tiranë dhe me adresë: “***”, ***.

1.6. Nga hetimi administrativ kryesisht, bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 burimin e krijimit të pasurisë apartament, në kundërshtim me paragrafin e parë të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²² subjekti i rivlerësimit shpjegon se deklarami i vitit 2004 është deklarim i parë dhe nuk ka pasur eksperiencë dhe në formularin e deklaramit të vitit 2004 kërkohej shprehimisht përshkrimi i pasurisë, vlera, përqindja takuese dhe koha e krijimit, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* 2017 është shtuar edhe termi “për burimin e krijimit”.

1.7. Pas analizimit të fakteve të rrethanave lidhur me deklaramin e subjektit, si dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit në raport me ligjin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se kjo pasaktësi në deklaramin periodik vjetor nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit, për aq kohë sa Komisioni hetoi në mënyrë shteruese çdo burim të përdorur për këtë pasuri.

¹⁸ Kopje e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 12.11.2004; kopje e shkresës nr. *** prot., datë 24.10.2016, të Ministrisë së Financave, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim; kopje e deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.1.2017; shkresë nr. *** prot., datë 9.11.2016, të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2016, e DPSHTRR-së; kopje e shkresës nr. *** prot., datë 28.5.2020, drejtuar Tirana Bank; kopje e kërkesës, datë 28.5.2020, drejtuar Tirana Bank; kopje e mandatarëkëtitimit nr. *** ose ***, datë 16.11.2004.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2020; kartelë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, datë 25.2.2020; mandat i Raiffeisen Bank “Taksë për shitje apartamenti”, e datës 11.11.2004; kontratë shitblerjeje e apartamentit nr. ***, datë 29.10.2004; vendim nr.***, datë 11.10.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, z. k. ***, datë 11.10.2004; kartelë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, datë 29.10.2004.

²⁰ *Email* datë 13.1.2020.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.1.2020.

²² *Email* datë 21.4.2022.

1.8. Më tej, në funksion të analizimit të vërtetësisë së deklarimeve, Komisioni analizoi deklaratimet e subjektit lidhur me jetesën e përbashkët me prindërit në funksion edhe të burimeve të krijimit të kësaj pasurie.

1.9. Në përgjigje të pyetësorit standard²³, subjekti deklaroi: “Në periudhën e rivlerësimit 1.10.2003 – 11.10.2004, në vitin e tretë të Magjistraturës kam banuar në adresën “***, godina nr. ***”. Kjo është adresa faktike, ndërsa regjistrimi në gjendjen civile është në rrugën “***”, p. ***, shk. ***, kati i 2-të, ap. ***, ku kam banuar tre muajt e tjerë të mbetur të vitit. Shtëpia në këtë adresë është e vëllait tim E. T.. Nuk kam paguar qira për këto tre muaj”. Në vijim deklaroi se në periudhën e rivlerësimit 29.10.2004 – 1.3.2013, ka banuar në adresën rruga “***”, pallati nr. ***, shkalla ***, kati ***-të, apartamenti ***, me pronar vetë subjektin. Gjithashtu, ka deklaruar se për periudhën 29.10.2004 – 12.7.2009 ka bashkëjetuar me prindërit e tij P. dhe L. T. dhe për këto vite shpenzimet e jetesës janë paguar prej tij dhe prindërve, ndërsa për periudhën 12.7.2009 – 2.9.2016 ka bashkëjetuar me babain e tij P. T. dhe shpenzimet e jetesës i kanë paguar bashkërisht.

1.10. Nga informacioni i marrë nga DPGJC-ja²⁴ rezultoi se në datën 17.4.2000 shtetasi Gj. P. T. ka ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Përmet, duke u vendosur në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë. Në datën 26.1.2017 ka ndryshuar vendbanimin nga Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë dhe është vendosur në Njësinë Administrative ***, Bashkia Tiranë, ku rezultoi i regjistruar aktualisht. Ndërsa shtetasi P. T. dhe L. S. T. rezultojnë të regjistruar banor në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë dhe në datën 17.4.2000 kanë ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Përmet, duke u vendosur në Njësinë Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë (L. T. ka ndërruar jetë në datën 20.7.2009). Gjithashtu, nga hetimi administrativ ka rezultuar se babai i subjektit P. T. gjatë periudhës 2008 – 2011 ka zhvilluar aktivitetet si person fizik në qytetin e Përmetit.

1.11. Me anë të pyetësorit nr. 2²⁵, Komisioni i kërkoi subjektin të deklaronte se ku kanë banuar prindërit e tij nga viti 2000 deri më 29.10.2004, si dhe ku ka banuar vetë ai nga viti 2000 deri më 1.10.2003. Në përgjigje²⁶, subjekti deklaroi se prindërit e tij kanë ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Përmet në Bashkinë Tiranë/Njësia Administrative Nr. ***, vetëm në kuptimin dokumentar, ndërsa fizikisht kanë vijuar jetesën në Bashkinë Përmet, në banesën e vjetër të familjes deri në momentin e shitjes së saj, duke kaluar në banesë me qira përsëri në Përmet. Më tej, subjekti deklaroi se: (i) gjatë periudhës janar – qershor 2000 ka banuar në banesën e vëllait të tij, E. T., me adresë Bashkia Tiranë/Njësia Administrative Nr. ***; (ii) gjatë periudhës qershor 2000 – tetor 2001 ka banuar në banesën e vjetër të familjes në Bashkinë Përmet; (iii) gjatë periudhës tetor 2001 – tetor 2002, në godinën nr. *** në ***; (iv) gjatë periudhës tetor 2002 – tetor 2003 në godinën nr. ***, kati i ***,***.

1.12. Nga faktet e analizuar më lart, Komisioni konstaton se subjekti në pyetësorin standard ka deklaruar se në periudhën 29.10.2004 – 12.7.2009 ka bashkëjetuar me prindërit e tij P. dhe L. T.

²³ Përgjigje për pyetësorin standard (protokolluar me nr. ***, datë 31.1.2020, në Komision).

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021.

²⁵ Email datë 21.2.2022.

²⁶ Email datë 2.3.2022.

dhe për periudhën 12.7.2009 – 2.9.2016 ka bashkëjetuar me prindin e tij P. T., ndërsa në pyetësonin nr. 2 deklaroi se babai i tij edhe pas shitjes së banesës në vitin 2004 deri në gusht të vitit 2012 jetonte fizikisht në Përmet, pavarësisht se nga viti 2000 gjendjen civile e kishte transferuar në Tiranë.

1.13. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimin se deklarimi në pyetësonin standard nuk përputhet me deklarinimin në pyetësonin nr. 2 lidhur me adresat e banimit të shtetasit P. T..

1.14. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²⁷, subjekti ka shpjeguar se deklarinimet e tij nuk duhen trajtuar si mospërputhje midis përgjigjeve për pyetësonin standard dhe përgjigjeve për pyetësonin nr. 2, por vetëm si pasaktësi që kanë nevojë për interpretim pasi, sipas tij, ai e ka trajtuar në pyetësonin standard bashkëjetesën me prindërit, kryesisht në lidhje me kriterin ekonomik si kriteri themelor i procesit të rivlerësimit. Në vijim, shpjegon se fakti që babai i tij konsumonte jetën fizike në Përmet, del nga deklarinimet në DIPP-të e viteve 2010, 2011 dhe 2012, si dhe në deklaratën *Vetting*, ku ka deklaruar qendrën e punës së tij si ekografist, me seli në Përmet.

1.15. Në përfundim të analizimit të deklarinimeve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se kjo mospërputhje në deklarinim është një pasaktësi, e cila e vetme nuk mund të përbëjë shkak për marrjes e ndonjë mase disiplinore për atë kohë sa nuk ndikon në analizën e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

Analizimi i burimeve të krijimit të kësaj pasurie

1.16. Në funksion të analizimit të burimit të krijimit në kohën e kryerjes së pagesës, Komisioni pyeti subjektin lidhur me mënyrën e pagesës, i cili në përgjigje të pyetësonit nr. 1²⁸ ka deklaruar se: *“...në datën 29.10.2004, për blerjen e apartamentit nuk është kryer pagesë e plotë e mirëfilltë, por çmimi prej 3.400.000 lekësh është paguar me dy këste në masën 1.700.000 lekë në datën 13.9.2004 (me dy pagesa brenda ditës në vlerën 900.000 lekë dhe 800.000 lekë) dhe në masën 1.700.000 lekë, në datën 2.11.2004. Për pagesën e parë paratë ishin gjendje në familje, ndërsa për pagesën e datës 2.11.2004 janë përdorur të hollat që blerësi i banesës në Përmet i ka kaluar tek shitësi para redaktimit të kontratës së datës 12.11.2004...”*

1.17. Deklarinimet e subjektit lidhur me depozitimet konfirmohen nga informacioni i përcjellë nga Tirana Bank²⁹, nga ku rezulton se në datën 13.9.2004, në llogarinë bankare të shtetasës A. S., janë kryer dy depozitime, me vlerë 900.000 lekë dhe 800.000 lekë, me përshkrimin “Depozitë në arkë Gjergji Tako blerje apartamenti” dhe në datën 2.11.2004 një depozitim me vlerë 1.700.000 lekë me përshkrimin “Depozitë në arkë Gjergji Tako”.

1.18. *Lidhur me këstin e parë, paguar në datën 13.9.2004, në shumën 1.700.000 lekë*³⁰, Komisioni analizoi: (i) të ardhurat nga shoqëritë e skemave piramidale; (ii) të ardhurat nga

²⁷ Email datë 21.4.2022.

²⁸ Email datë 1.6.2020.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.2.2022.

³⁰ Depozituar në llogarinë bankare të palës shitëse me dy veprime në të njëjtën datë.

administrimi i një autoshkolle në Përmet në vitet 1992 – 1996; (iii) kursimet e prindërve të subjektit dhe të ardhurat nga punësimi pranë Shkollës së Magjistraturës, si vijon:

i) *Të ardhurat nga skema e firmave piramidale në shumën 1.450.000 lekë*

1.19. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e apartamentit “*Mbetjet (interesat) e tërhequra nga firmat piramidale*”.

1.20. Në përgjigje të pyetësorit standard³¹, subjekti deklaron si një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament³² të ardhurat e krijuara nga tërheqjet pranë firmave piramidale “****”, “****” dhe shoqëria “****”, në shumën rreth 1.450.000 lekë, përpara kompensimit me koeficientët e vendosur nga shteti për likuidimin përfundimtar.

1.21. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017³³ dhe i administruar nga Komisioni nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim³⁴, rezulton se shtetasi P. T. ka qenë kreditor në shoqëritë “****”, “****” dhe “****” dhe ka kryer depozitime në shumën totale 5.079.958 lekë, tërheqje në shumën 1.482.065 lekë përpara mbylljes së tyre me ligjin nr. 8188, datë 23.1.1997, “Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes” dhe tërheqje sipas koeficientëve në shumën 653.259 lekë pas mbylljes së tyre.

1.22. Shoqëritë Huamarrëse në Administrim informojnë se për sa i përket transaksioneve të kryera me shoqërinë “****” disponohet informacion lidhur me datat e depozitimit dhe tërheqjeve. Konkretisht, në datën 20.8.1996, me mandatar-këtimin nr. *** është depozituar vlera 14.000 USD dhe, më tej, janë tërhequr interesa në datën 21.10.1996, mandatapagesa nr. ***, vlera 2.240 USD dhe në datën 21.12.1996, mandatapagesa nr. ***, vlera 2.240 USD. Ndërsa lidhur me depozitimet dhe tërheqjet pranë shoqërive të tjera, nuk disponohet informacion për datat e transaksioneve³⁵. Lidhur me shumat e tërhequra sipas koeficientëve, kreditori i ka tërhequr pranë Bankës Kombëtare Tregtare Tiranë dhe një kopje e këtij mandati i jepej në dorë kreditorit dhe një kopje e mban vetë banka. Kjo praktikë vlente për të gjithë kreditorët e shoqërive huamarrëse. Bashkëlidhur shkresës gjendet fleta e përpunimit si kreditor nga ana e Qendrës së Informatizimit Financiar.

1.23. Për sa i përket datave të tërheqjeve pas mbylljes së firmave, konfirmohet se tërheqja nga shoqëria “****” është kryer në datën 2.8.2005³⁶, ndërsa për dy shoqëritë e tjera, në kushtet e mungesës së informacionit³⁷, Komisioni e pasqyroi tërheqjen nga shoqëria “****” në analizën financiare të vitin 2002, referuar deklaratimit të subjektit³⁸, si dhe tërheqjen pranë shoqërisë “****” në të njëjtin vit që është kryer tërheqja pranë shoqërisë “****” në vitin 2005.

³¹ Shpjegime datë 31.1.2020 (nr. *** prot., Komision).

³² Nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 57 m².

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2016, e Shoqërive Huamarrëse në Administrim.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 11.10.2021, e Shoqërive Huamarrëse në Administrim.

³⁵ Kompanitë “****” dhe “****” nuk disponojnë mandate (arkëtim-pagesa), pasi një kopje i jepej kreditorit, pasi kryeshin veprimet.

³⁶ Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka paraqitur dokumentin e tërheqjes së vlerës 103.295 lekë në datën 2.8.2005 pranë BKT-së, në cilësinë e kreditorit të shoqërisë “****”.

³⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2022, BKT-ja informon se nuk disponon informacion.

³⁸ Në pyetësorin nr. 1, subjekti ka deklaruar se automjeti me targë *** është financuar pas shlyerjes që bëri shteti me koeficientin 20,15%, për likuidimin e shoqërisë “****” tek babai i tij në vlerën 515.085 lekë, në vitet 2001 – 2002.

1.24. Në lidhje me burimin e krijimit të depozitimeve/investimeve në firmat piramidale, Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) periudhën kohore të kryerjes këtyre investimeve pranë shoqërive piramidale, vitet 1992 – 1996; (ii) periudhën kohore të tërheqjes së shumave të përdorura si burim për pagimin e këstit të parë të apartamentit, vitin 1996; (iii) statusin e subjektit, i cili ishte fillimisht nxënës e më tej student në vitin e parë të universitetit në kohën e investimit dhe tërheqjes së këtyre përfitimeve; (iv) faktin që me veprime konkludente kësti i parë i këtij apartamenti është paguar më 13.9.2004 dhe subjekti është dekretuar si prokuror më 11.10.2004; (v) gjatë periudhës 1997 – 2003 nuk ka rezultuar nga hetimi administrativ se personi i lidhur ka kryer investime të atilla që do ta kishin vendosur në kushtet e nevojës për përdorimin e këtyre fondeve para pagesës së këstit të parë të apartamentit; si dhe (vi) faktin se informacioni i administruar nga institucionet shtetërore³⁹ provon përfitimet e marra nga personi i lidhur/babai i subjektit në shumën 1.482.065 lekë nga firmat piramidale, para miratimit të ligjit nr. 8188, datë 23.1.1997, që ndaloi ushtrimin e kësaj veprimtarie, shumën 1.482.065 lekë – i përfshiu si të ardhura në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të personit të lidhur (babait të subjektit) për blerjen e apartamentit në rrugën “***”.

1.25. Vlerësimi i Komisionit mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave do të ndalet deri në lejimin prej dispozitave të Kodit Civil të mundësisë për krijimin e tyre pa analizuar më tej mbi rolin dhe përgjegjësinë e huadhënësve për përmasat kolosale që krijoi këtë aktivitet për publikun e gjerë, duke qenë se në terma makro e të përgjithshëm të dëmtuarit e këtij aktiviteti të konsideruar kriminal, ishin vetë huadhënësit, sipas situatave konkrete të secilit prej tyre.

1.26. Në këto kushte, gjendur para faktit se subjekti i rivlerësimit ka mundur të paraqesë dokumente të lëshuara nga institucione shtetërore (Ministria e Financave) që provojnë përfitimet periodike të marra nga huamarrja në firmat piramidale, Komisioni vlerëson se të ardhurat e krijuara nga familja e subjektit prej këtij aktiviteti e të përfituara para miratimit të ligjit nr. 8188, datë 23.1.1997, që ndaloi ushtrimin e kësaj veprimtarie, duhet konsideruar se plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme dhe, për pasojë, janë konsideruar si të tilla në analizën financiare të kryer për kontrollin e burimeve të ligjshme të familjes për pagimin e këstit të parë të apartamentit.

ii) Të ardhurat e shtetasit P. T. nga autoshkolla, në shumën 200.000 lekë

1.27. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur/babai i subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 224.000 lekë pas zbritjes së detyrimeve shtetërore, e krijuar nga administrimi i një autoshkolle në Përmet në periudhën 1992 – 1996.

1.28. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezulton se DRT Gjirokastër⁴⁰ sqaron se nuk disponon informacion për asnjë nga autoshkollat që vepronin në qytetin e Përmetit për periudhën 1992 – 1997 dhe se nuk ekziston asnjë e dhënë për autoshkollën e shtetasit P. G. T.. Gjithashtu, DPSHTRR-ja⁴¹ sqaron se nuk disponon informacion dhe dokumentacion për autoshkollat që ushtronin aktivitet në vitet 1992 – 1997 në qytetin e Përmetit,

³⁹ Shoqëritë Huamarrëse në Administrim pranë Ministrisë së Financave.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2016.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2016.

duke përfshirë edhe shtetasin P. T.. Në vijim, sqaron se në këtë periudhë autoshkollat regjistroheshin në sektorin e policisë rrugore pranë komisariateve të policisë dhe në vitin 1997, si rezultat i trazirave në atë vit, kartoteka e Policisë Rrugore u dogj me të gjithë informacionin dhe dosjet e drejtuesve të mjeteve.

1.29. Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 deklaratën noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, të babait të tij P. T. (të administruar dhe nga noter E. S. B.⁴²), i cili pasi është njohur me shkresat e institucioneve të mësipërme deklaroi se ka qenë administrator i një autoshkolle në qytetin e Përmetit dhe në hapësirën kohore 1992 – 1997 ka organizuar 4 kurse me nga 7 kursantë për çdo kurs, ku pagesa për kursant ka qenë 10.000 lekë. Në vijim deklaroi emrin e inxhinierit mekanik, të instruktorit të praktikës (Dh. T.) dhe emrat e disa shtetasve që janë pajisur me leje drejtimi nga autoshkolla e tij, si dhe kërkon që ky deklaram të mbahet parasysh në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 nga organet që do të kryejnë procesin e rivlerësimit.

iii) Kursimet e prindërve dhe të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, në shumën 60.000-70.000 lekë

1.30. Komisioni kreu analizën financiare kronologjike për vitet 1996⁴³ – 2004, duke konsideruar: (i) tërheqjet e babait nga firmat piramidale përpara mbylljes; (ii) tërheqjet e babait nga shoqëria “***” sipas koeficientit, pas mbylljes; (iii) të ardhurat e babait nga punësimi⁴⁴, duke filluar nga janari 1997 dhe nga pensioni⁴⁵; (iv) të ardhurat e së ndjerës, nënës së subjektit, nga punësimi⁴⁶, duke filluar nga janari 1997 dhe nga pensioni⁴⁷; (v) të ardhurat e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës⁴⁸ dhe nga punësimi⁴⁹; (vi) shpenzimet e jetesës⁵⁰; (vii) blerjen e automjetit në datën 6.6.2002; (viii) shtesat/pakësimet për çdo vit të depozitës në ish-Bankën e Kursimeve⁵¹ të nënës së subjektit; (ix) shtesat e llogarisë bankare të subjektit⁵². Referuar analizës financiare, në fund të muajit gusht 2004 rezultoi një balancë pozitive e fondeve, e mjaftueshme për pagesën e kryer në datën 13.9.2004.

1.31. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, lidhur me pagesën e parë në vlerën 1.700.000 lekë, datë 13.9.2004, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për*

⁴² Shkresë datë 3.9.2021.

⁴³ Duke filluar nga momenti i tërheqjeve nga firmat piramidale.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2021, nga DRSH-ja Tiranë, arkiva (sipas vërtetimit të DSHP-së Përmet, datë 1.9.1997, ndodhur në dosjen e pensionit); shkresë nr. *** prot., datë 17.2.2022, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Përmet.

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2021, nga ISSH-ja Tiranë.

⁴⁶ Vërtetim nga DRSSH-ja Gjyrokastër për të ardhurat e nënës për periudhën maj 1995 – dhjetor 2000, paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017.

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021, nga ISSH-ja Gjyrokastër.

⁴⁸ Vërtetim nr. *** , datë 3.11.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

⁴⁹ Vërtetim datë 17.10.2016 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁵⁰ Shpenzimet e jetesës të përllorarit: (i) 66% e të ardhurave për 1997 – 1999; (ii) bazuar në shkresën e ILDKPKI-së nr. *** , datë 4.3.2019, për periudhën 2000 – 2016 (në mungesë të të dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës 108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së, 174.072 lekë/vit për person. Për këtë periudhë u konsideruan 3 persona (subjekti dhe prindërit).

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.2.2022, nga Raiffeisen Bank.

⁵² Llogaritë bankare të subjektit në Tirana Bank.

pagesën e shumës 200.000 lekë, pasi nuk provohen të ardhurat e personit të lidhur/babait të subjektit të deklaruara të përfituara nga aktiviteti i autoshkollës.

1.32. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁵³, subjekti ka kërkuar që të vihet në pozitën e parashikuar nga neni 32 i ligjit nr. 84/2016, pasi DPSHTRR-ja dhe DRT Gjirokastër shprehen se nuk kanë të dhëna pasi dokumentacioni i Policisë Rrugore në Komisariatin e Policisë Përmet është djegur në vitin 1997. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumente shtesë për të provuar ushtrimin e aktivitetit të autoshkollës nga babai i tij P. T.⁵⁴.

1.33. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

1.34. Sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti të jetë në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër.

1.35. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, rezulton se DRT Gjirokastër⁵⁵ konfirmon se nuk disponon të dhëna për asnjë nga autoshkollat që vepronin në qytetin e Përmetit për periudhën 1992 – 1997 dhe ekziston pamundësia e vërtetimit të pagesave për detyrimet tatimore për autoshkollën e shtetasit P. T. për shkak se periudha tatimore 1992 – 1996 është jashtë sistemit të unifikuar tatimor. Gjithashtu, DPSHTRR-ja⁵⁶ sqaron se nuk disponon informacion dhe dokumentacion për autoshkollat që ushtronin aktivitet në vitet 1992 – 1997 në qytetin e Përmetit, duke përfshirë edhe shtetasin P. T., duke sqaruar në vijim se në këtë periudhë autoshkollat regjistroheshin në sektorin e policisë rrugore pranë komisariateve të policisë dhe në vitin 1997, si rezultat i trazirave në atë vit, kartoteka e Policisë Rrugore u dogj me të gjithë informacionin dhe dosjet e drejtuesve të mjeteve.

1.36. Në shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2022, të paraqitur nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, DPSHTRR-ja ka sqaruar se autoshkolla nr. *** e rrethit të Përmetit për periudhën 1993 – 1996 ka të regjistruar dhe të kualifikuar 270 shtetas për leje drejtimi, por nuk ka sqaruar nëse kjo autoshkollë i përkiste shtetasit P. T..

⁵³ Email datë 21.4.2022.

⁵⁴ Deklaratë noteriale nr.***, datë 15.4.2022, e shtetasit Dh.T. dhe deklaratë noteriale nr. ***, datë 14.4.2022, e shtetasit Z. D.; deklaratë noteriale nr. ***, datë 13.4.2022, e shtetasit A. M.; deklaratë noteriale nr.***, datë 19.4.2022, e funksionarit shtetëror të kohës A. L.; shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër; shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër; shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2022, e arkivit të sistemit të Ministrisë së Brendshme; shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2022, e DPSHTRR-së; aplikim për informacion dhe dokumentacion pozitiv ose negativ nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Fondi Biografi për autoshkollën nr. *** , P. T., datë 14.4.2022, ora 16:20 (bashkëlidhur mandatarëkëtimet në Postën Shqiptare).

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 30.12.2016; shkresë nr. *** prot., datë 14.4.2022.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 1.12.2016.

1.37. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë ekzistencën e ushtrimit të aktivitetit autoshkollë e, për rrjedhojë, as të ardhurat e krijuara prej saj.

1.38. Për pasojë, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 200.000 lekë, për pagesën e këstit të parë prej 1.700.000 lekësh të apartamentit me sipërfaqe 57,1 m², me adresë rruga “****”, Tiranë.

1.39. Lidhur me këstin e dytë, paguar më 2.11.2004, në shumën 1.700.000 lekë, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit⁵⁷ shitjen e banesës së familjes në Përmet me kontratën nr. ***, datë 12.11.2004.

1.40. Komisioni vëren se, pavarësisht faktit se në kontratën e shitblerjes nr.***, datë 29.10.2004, përcaktohet se çmimi është likuiduar jashtë zyrës noteriale, rezulton se depozitimi në Tirana Bank⁵⁸ i shumës 1.700.000 lekë është kryer pas datës së nënshkrimit të kontratës, në datën 2.11.2004.

1.41. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Përmet⁵⁹ rezulton se sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 5.11.1973, shtetasi P. T. ka blerë nga shtetasi Q. F. një shtëpi dykatëshe, me konstruksion të gurtë, të ndodhur në qytetin e Përmetit, në lagjen “****” (me këtë përbërje: një dhomë, një sallon, oborr, manxhato, një korridor dhe një kuzhinë). Në vijim, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12.11.2004, shtetasi P. T. dhe shtetasja L. T., bashkëshortja e tij, pasurinë e mësipërme ia shesin shtetasit M. H. kundrejt çmimit të shitblerjes 1.950.000 lekë. Në kontratë parashikohet se kjo shumë është likuiduar midis tyre jashtë zyrës noteriale dhe para redaktimit të kontratës së shitblerjes.

1.42. Me anë të pyetësorit nr. 1⁶⁰, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me burimin e pagesës së kryer në datën 29.10.2004 për blerjen e apartamentit, pasi shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në Përmet rezulton të jetë përfituar më 12.11.2004, disa javë më vonë. Në përgjigje⁶¹, subjekti deklaroi se: *“Në datën 29.10.2004, për blerjen e apartamentit nuk është kryer pagesë e plotë e mirëfilltë, por çmimi prej 3.400.000 lekësh është paguar me dy këste në masën 1.700.000 lekë në datën 13.09.2004 (me dy pagesa brenda ditës në vlerën 900.000 lekë dhe 800.000 lekë) dhe në masën 1.700.000 lekë në datën 2.11.2004. Për pagesën e parë paratë ishin gjendje në familje, ndërsa për pagesën e datës 2.11.2004 janë përdorur të hollat që blerësi i banesës në Përmet i ka kaluar tek shitësi para redaktimit të kontratës së datës 12.11.2004, sikurse me korrektësi noteri e përshkruan tek paragrafi 7 i faqes së parë të kontratës duke thënë “...jashtë*

⁵⁷ Nr. pasurie ***, z. k. ***.

⁵⁸ Shkresë nr.***, datë 15.2.2022.

⁵⁹ (1) Shkresë nr. *** prot., datë 20.2.2020; (2) deklaratë noteriale e pronarëve kufitarë, pa datë; (3) deklaratë personale e P. T., pa datë; (4) kërkesë për regjistrim pronësie e P. T., pa datë; (5) kontratë shitblerjeje nr. *** akti., nr. *** kol., datë 5.11.1973; (6) procesverbal i ZVRPP-së Përmet, viti 2004; (7) vendim i ZVRPP-së Përmet (pa numër dhe datë) viti 2004; (8) vërtetim noteri nr. *** rep., datë 21.8.2004; (9) vërtetim i Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet, datë 19.11.2000; (10) vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 9.9.2004, në emër të P. T.; (11) vërtetim pronësie i Zyrës së Hipotekës, datë 3.6.1996; (12) vërtetim pronësie i Zyrës së Hipotekës, datë 6.12.1995; (13) deklaratë personale, pa datë; (14) kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.11.2004; (15) mandatarkëtimi nr. ***, datë 16.11.2004.

⁶⁰ Email datë 13.5.2020.

⁶¹ Email datë 1.6.2020.

zyrës noteriale dhe para redaktimit të kësaj kontrate shitblerjeje”. Subjekti ka dorëzuar kopje të dokumentacionit justifikues⁶².

1.43. Me anë të pyetësorit nr. 2⁶³, Komisioni i kërkoi subjektit të specifikonte se kur e ka bërë pagesën e çmimit të blerjes së banesës në Përmet blerësi M. H. dhe për mënyrën e kryerjes së kësaj pagese (*cash/bankë*). Në përgjigje⁶⁴, subjekti deklaroi se disponon një shkresë dore të hartuar nga shtetasit Xh. M. Gj. dhe E. T. të datës 13.10.2004. Kjo shkresë përcakton se në këtë datë Xh. Gj. i ka dhënë një kapar prej 200.000 lekësh shtetasit E. T., vëllait të tij, si kapar për blerjen e shtëpisë në Përmet tek P. T.. Sipas subjektit, kjo shkresë lidhet plotësisht me citimin në kontratën e shitblerjes së banesës se shumica e blerjes është shlyer para lidhjes së kësaj kontrate. Gjithashtu, sqaron se disponon përgjigjen nr. *** prot., datë 6.7.2020, të Tirana Bank, ku vërtetohet se ka derdhur këstin e tretë për blerjen e shtëpisë në Tiranë në datën 2.11.2004 dhe, sipas tij, kjo do të thotë se shtetasi M. H. e ka paguar shumën për blerjen e banesës tek babai P. T. midis datave 13.10.2004 – 2.11.2004, për sa kohë ka pasur mundësi ta bëjë derdhjen e këstit të tretë në datën 2.11.2004. Lidhur me mënyrën e pagesës deklaroi se ajo është kryer *cash* nga M. H. tek P. T. Bashkëlidhur ka paraqitur dokumentacionin provues⁶⁵.

1.44. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe prindërit e tij nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e shumës 1.700.000 lekë, pasi kjo shumë është paguar në datën 2.11.2004, ndërkohë që kontrata e shitjes së apartamentit në Përmet është lidhur në datën 12.11.2004, pra 10 ditë më vonë.*

1.45. Në përgjigje të rezultateve të hetimit⁶⁶, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12.11.2004, të banesës në Përmet parashikohet në mënyrë të qartë se: *“...paratë janë paguar përpara nënshkrimit të kësaj kontrate...”*. Gjithashtu, ka paraqitur si provë deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.4.2022, ku vetë subjekti deklaroi se shtetasi M. H. i ka dërguar në *email*-in e tij shtetëror deklaratën e tij dhe kopje të dokumentit të identifikimit. Në deklaratën e dërguar, shtetasi M. H. ka deklaruar se *kunati i tij Xh. Gj. i kishte paguar 200.000 lekë të reja si kapar djalit të madh të P. T., E. T., dhe se kjo shumë parash është dhënë pasi ai ka ardhur nga Franca në qytetin e Tiranës rreth datës 1 ose 2 nëntor*. Bashkëlidhur deklaratës gjendet fotokopja e pasaportës së Republikës Franceze. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë deklaratën noteriale nr. ***, datë 19.4.2022, të shtetasit Xh. Gj., i cili deklaroi se *në datën 13.10.2004, me kërkesë të shtetasit M. H. i ka dhënë djalit të P. T. një kapar prej 200.000 lekësh të reja për blerjen*

⁶² (1) Kopje e mandatarkëtimit nr. ***, datë 16.11.2004; (2) kopje e shkresës së datës 28.5.2020; (3) kopje e shkresës nr. *** prot., datë 28.5.2020, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁶³ *Email* datë 21.2.2022.

⁶⁴ *Email* datë 2.3.2022.

⁶⁵ Kopje e kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 12.11.2004; kopje e deklaratës me shkrim dore të hartuar nga shtetasit Xh. M. Gj. dhe E. T. datë 13.10.2004; shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2020, nga Tirana Bank.

⁶⁶ *Email* datë 21.4.2022.

e shtëpisë së P. T. në Përmet dhe më vonë ka ardhur vetë M. P. (H.) dhe pjesën tjetër ia ka dhënë në Tiranë personalisht djemve të P. T.. Në këto momente deklaroi se ka qenë vetë i pranishëm.

1.46. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore – arsyetoi se:

1.47. Në kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 12.11.2004, të lidhur ndërmjet shtetasve P. dhe shtetasja L. T. me shtetasin M. H., me objekt shitjen e banesës në Përmet është parashikuar se çmimi i shitblerjes është likuiduar përpara lidhjes së kontratës. Gjithashtu, rezultoi se pagimi i shumës 1.700.000 në llogari të shitëses A. S. për blerjen e apartamentit në Tiranë është në datë të afërt⁶⁷ me datën e lidhjes së kontratës së shitjes së banesës në Përmet. Në këto kushte, Komisioni krijoi bindjen se burimi i pagesës në shumën 1.700.000 lekë për blerjen e apartamentit në Tiranë janë të ardhurat nga shitja e banesës në Përmet.

1.48. Sa më lart, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në analizën financiare të ardhurat e realizuara nga shitja e banesës në Përmet në shumën 1.700.000 lekë si burim për pagesën e kështit të dytë për blerjen e apartamentit në Tiranë.

1.49. Në tabelën vijuese pasqyrohet analiza financiare e rishikuar, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet, për periudhën 1996 – 2004, për subjektin e rivlerësimit dhe prindërve të tij.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare kronologjike për periudhën 1996 – 2004

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Pasuri/ shpenzim	Gjendje progresive
1996	Tërheqje nga firmat piramidale ⁶⁸	1,482,065	-	1,482,065
1997 – 1999	Të ardhura babai nga punësimi	544,985	-	2,027,050
1997 – 1999	Të ardhura nëna nga punësimi	778,965	-	2,806,015
1997 – 1999	Shpenzime jetese	-	873,807	1,932,208
2000	Të ardhura babai nga punësimi	186,526	-	2,118,734
2000	Të ardhura nëna nga punësimi	314,266	-	2,433,000
2000	Të ardhura nëna nga pensioni	5,133	-	2,438,133
2000	Shpenzime jetese	-	324,000	2,114,133
2001	Të ardhura babai nga pensioni	124,311	-	2,238,444
2001	Të ardhura nëna nga pensioni	134,496	-	2,372,940
2001	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	67,620	-	2,440,560
2001	Shpenzime jetese	-	324,000	2,116,560
Janar – maj 2002	Të ardhura babai nga pensioni	56,385	-	2,172,945
	Të ardhura nëna nga pensioni	60,880	-	2,233,825
	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	118,325	-	2,352,150
	Shpenzime jetese	-	117,330	2,234,820
2002	Tërheqje sipas koef. nga shoqëria “***”	515,085	-	2,749,905
6.6.2002	Blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”	-	650,000	2,099,905

⁶⁷ Datë 2.11.2004.

⁶⁸ Tërheqje nga firmat piramidale përpara mbylljes.

Qershor – dhjetor 2002	Të ardhura babai nga pensioni	78,938	-	2,178,843
	Të ardhura nëna nga pensioni	85,232	-	2,264,075
	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	165,655	-	2,429,730
	Shpenzime jetese	-	164,262	2,265,468
2002	Shtesë depozitë ish Banka e Kursimeve	-	518,804	1,746,664
2002	Të ardhura nga interesat 2002	19,476	-	1,766,139
2002	Shtesë depozite ish Banka e Kursimeve	-	19,476	1,746,664
2003	Të ardhura babai nga pensioni	148,239	-	1,894,903
2003	Të ardhura nëna nga pensioni	160,122	-	2,055,025
2003	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	239,420	-	2,294,445
2003	Të ardhura subjekti nga punësimi	82,238	-	2,376,683
2003	Shpenzime jetese	-	281,592	2,095,091
2003	Të ardhura nga interesat 2003	39,954	-	2,135,045
2003	Shtesë depozitë ish Banka e Kursimeve	-	184,812	1,950,233
2003	Shpenzime udhëtimi ⁶⁹	-	9,000	1,941,233
Janar – gusht 2004	Të ardhura babai nga pensioni	107,188	-	2,048,421
	Të ardhura nëna nga pensioni	115,944	-	2,164,365
	Të ardhura subjekti nga punësimi	632,449	-	2,796,814
	Shpenzime jetese	-	187,728	2,609,086
13.9.2004	Pagesë për apartamentin rr. “****”	-	900,000	1,709,086
13.9.2004	Pagesë për apartamentin rr. “****”	-	800,000	909,086
	Të ardhura nga shitja e apartamentit Përmet	1,950,000	-	2,859,086
2.11.2004	Pagesë për apartamentin rr. “****”	-	1,700,000	1,159,086
Shtator – dhjetor 2004	Të ardhura babai nga pensioni	53,594	-	1,212,681
	Të ardhura nëna nga pensioni	57,972	-	1,270,653
	Të ardhura subjekti nga punësimi	316,225	-	1,586,877
16.11.2004	Pagesë tatimi mbi shitje pasuri e paluajtshme	-	9,750	1,577,127
Shtator – dhjetor 2004	Shpenzime jetese	-	93,864	1,483,263
2004	Shpenzime arredimi ap. rr. “****”	-	23,000	1,460,263
2004	Shpenzime TIMS (udhëtimi datë 19.11.2004)	-	41,824	1,418,439
2004	Të ardhura nga interesat 2004	27,118	-	1,445,557
2004	Pakësim depozita ish-Banka e Kursimeve	-	-573,092	2,018,649
2004	Shpenzime udhëtimi ⁷⁰	-	49,500	1,969,149
Nëntor – dhjetor 2004	Shpenzime qiraje babai Përmet	-	10,000	1,959,149
31.12.2004	Shtesë llogaritë bankare subjekti	-	240,010	1,719,139
	TOTAL	8,668,806	6,949,668	1,719,139

1.50. Referuar analizës financiare, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e kështit të dytë prej 1.700.000 lekësh të apartamentit me sipërfaqe 57,1 m², ndodhur në Tiranë.

1.51. Në përfundim, për sa i përket pasurisë “apartament me sipërfaqe 57,1 m², me vlerën 3.400.000 lekë në Tiranë”, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 200.000 lekë, për pagesën e apartamentit në shumën 3.400.000

⁶⁹ Shpenzime udhëtimi vendbanim – vendi i punës, subjekti.

⁷⁰ Shpenzime udhëtimi vendbanim – vendi i punës subjekti.

lekë, mungesë e cila nuk përbën e vetme shkak për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

2. Apartament banimi në Tiranë në vlerën 38.760 euro

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Apartament banimi në posedim – njësia e administrimit vendor ****, Bashkia Tiranë, pallatet e shoqërisë “****” sh.p.k., hyrja ***, kati ***, ap. ***, viti i krijimit 2012 – sipërfaqe 101.87 m². Vlera e porosisë 38.760 euro, por janë paguar vetëm 34.760 euro, pasi pjesa tjetër do të shlyhej me daljen e regjistrimit në ZVRPP. Krijuar me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2012 dhe deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 13.10.2012”, me pjesë takuese 100%.

2.2. Si burim krijimi deklaron: (i) kredi bankare në shumën 3.450.000 lekë, në Credins Bank; (ii) hua nga shtetasja V. D. në shumën 8.000 euro; (iii) mbyllje e llogarisë bankare nga babai P. pranë Tirana Bank nr. ***. Gjithashtu, deklaron se shtetasja V. D. e ka burimin e kësaj shume parash të dhënë hua nga një depozitë bankare në euro të shtetasve I. S. dhe R. B. të hapur në vitin 2008 në Raiffeisen Bank, ku shtetasi I. S. i ka dhënë të drejtë administrimi shtetases V. D.. Shtetasit I. S. dhe R. B. e kanë burimin e të ardhurave nga emigrimi i ligjshëm në Itali nga viti 1997 e në vijim. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues⁷¹.

2.3. Lidhur me deklarinin ndër vite, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi (ende vetëm në posedim) nr. ****, me sip. 101.87 m², Yzberisht, pallatet e shoqërisë “****”, në vlerën 38.760 euro dhe paguar 34.760 euro, me pjesë 100%.

2.4. Lidhur me deklarinin e burimit në këtë DIPP, Komisioni konstaton se në seksionin “Detyrimeve ndaj personave fizikë e juridikë”, subjekti ka deklaruar: “*Kredi bankare me qëllim blerje apartamenti banimi sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2012, afati i shlyerjes 20 vjet, shuma e marrë 3.450.000 lekë, kësti mujor 37.388 lekë. Fillimi i kredisë data 1.10.2012*”, si dhe “*Hua e marrë nga shtetasja V. D. në shumën 8.000 euro për të plotësuar shumën për blerjen e apartamentit të banimit, data e fillimit 22.8.2012, afati i shlyerjes 10 vjet, pa interes*”. Ndërsa shuma e tërhequr nga depozita e babait nuk është deklaruar si burim, por vetëm si mbyllje llogarie nga ana e babait në deklaratën e tij.

2.5. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 detyrimin ndaj shitësve në shumën 4.000 euro, në kundërshtim me shkronjën “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Gjithashtu, këtë detyrim nuk e ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 31 dhe shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016.

⁷¹ Kontratë premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2012; kontratë sipërmartjeje datë 3.12.2009; Aneks i “Kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.12.2009”, e datës 1.4.2010; deklaratë noteriale nr.***, datë 13.10.2012; kontratë për kredi afatgjatë nr. ***, datë 14.9.2012; konfirmim nr. ***, datë 23.1.2017, nga Credins Bank; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.3.2013; nxjerrje llogarie nga Agjencia ***, vulosur nga Raiffeisen Bank, me datë printimi 19.3.2013; kartat e specimenteve të nënshkrimeve të autorizuara për klientët individë, datë 6.8.2008, nxjerrje e vulosur nga Raiffeisen Bank; kartat e specimenteve të nënshkrimeve të autorizuara për klientët individë, datë 6.8.2008, vulosur nga Raiffeisen Bank; kontratë depozite me afat, datë 22.8.2011; fotokopje të kartës së identitetit italiane nr. *** në emër të shtetasit I. S. dhe nr. *** në emër të shtetasës R. B.; nxjerrje llogari page (në gjuhën italiane) në emër të shtetasit I. S. për muajt nëntor 2015, tetor 2016 – dhjetor 2016; dokument në gjuhën italiane në emër të shtetasës R. B. për llogaritjen e pagës; depozitim për të tretë nga Raiffeisen Bank datë 3.10.2016.

2.6. ILDKPKI-ja⁷², sipas procesverbalit të datës 26.1.2016, i ka kërkuar subjektit të sqarojë burimin për blerjen e apartamentit me sip. 101,87 m², në ***, si i ka kryer pagesat, nëse i ka likuiduar totalisht deri në datën 31.12.2014, nëse ishte i banueshëm dhe nëse e ka të regjistruar. Në përgjigje, subjekti ka deklaruar: *“Ky apartament është blerë në vitin 2012, në vlerën 38.760 euro. Burimi është kredia e marrë në Credins Bank në vlerën 3.400.000 lekë, pakësimi i depozitës në emër të babait tim në Tirana Bank në vlerën 1.100.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 8.000 euro nga shtetasja V. D.. Likuidimi i vlerës prej 34.000 euro ndaj palës shitëse është kryer cash. Detyrimi i mbetur pa paguar palës shitëse deri në datën 31.12.2014 është në vlerën 4.000 euro dhe do të likuidohet kur të pajisem me certifikatë pronësie. Ky apartament është bërë i banueshëm rreth marsit të vitit 2013. Mobilimi i këtij apartamenti ka shkuar rreth 5.000 euro dhe burimi është nga vlerat e deklaruara më sipër”*.

2.7. Në përgjigje të pyetësorit standard⁷³, subjekti deklaroi: *“Në vitin 2012 kam marrë në posedim një banesë me adresë ***, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, ap. *** ose *** në masën 38.760 euro, nga të cilat kam paguar faktikisht 34.760 euro. Burimi i këtij financimi është një kredi e marrë pranë Credins Bank, një hua e marrë nga shtetasja V. D. dhe një pjesë e shumës prej 1.169.913 lekësh që posedonte babai im P. T.”*.

2.8. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën Vetting 2017 rezultoi se në kontratën premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012, pala premtuese shitëse A. R., A. R. dhe L. Dh., të përfaqësuar nga E. Dh., si pronare truall, deklaroi se i kanë dhënë me sipërmarrje për ndërtim truallin pronë të tyre, shoqërisë “****” sh.p.k. dhe në këmbim të saj do të përfitonin, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 3.12.2009, ndërmjet të tjerave, apartamentin nr. ***, kati ***, me sipërfaqe totale 101,87 m². Në vijim, në kontratë parashikohet se pala premtuese shitëse i premtonte palës blerëse Gjergji Tako shitjen e një apartamenti të ndodhur në ***, me nr. ***, kuota +23.90, kati ***, tipologjia 2+1, me sipërfaqe totale 101,87 m² dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 90,97 m², kundrejt shumës 38.760 euro. Palët deklaroi se me nënshkrimin e kontratës pala blerëse i likuidoi palës shitëse shumën 2.000 euro (nuk parashikoi sesi është bërë pagesa) dhe diferencën e çmimit prej 36.760 euro do ta likuidojnë me çeljen e një kredie nga Credins Bank.

2.9. Për sa i përket fillimit të banimit në këtë apartament, Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2013, krahas adresës ku është regjistruar në gjendjen civile, subjekti ka deklaruar dy adresa të tjera, konkretisht: (i) rruga “****”, p. ***, sh. ***, k. ***, ap. ***; (ii) Komuna ***, pallatet “****”, kati ***.

2.10. Në procesverbalin e datës 26.1.2016, të mbajtur pranë ILDKPKI-së⁷⁴, subjekti ka deklaruar se apartamenti është bërë i banueshëm rreth marsit të vitit 2013.

2.11. Në përgjigje të pyetësorit standard⁷⁵ lidhur me adresat e banimit, subjekti ka deklaruar se për periudhën e rivlerësimit 1.3.2013 e në vijim banon në ***, ***, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, ap. *** ose ***.

⁷² Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2021.

⁷³ Përgjigje për pyetësorin standard nr. *** prot., datë 31.1.2020, të Komisionit.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2021.

⁷⁵ Përgjigje për pyetësorin standard nr. *** prot., datë 31.1.2020, të Komisionit.

2.12. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këtë adresë banimi të deklaruar nga subjekti.

2.13. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasit A. R., A. R., L. Dh., E. Dh., V. D. dhe nga hetimi nuk rezultoi se në emër të këtyre shtetasve të jetë regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara⁷⁶, ku subjekti të jetë prokuror i çështjes. Në këto kushte nuk konstatohet gjendja e subjektit në kushtet e konfliktit të interesit.

2.14. Lidhur me datat e pagesës së shumës 38.760 euro, rezulton se: (i) pagesa e parë në shumën 2.000 euro është bërë në datën 1.9.2012, sikurse përcaktohet në kontratën premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012; (ii) pagesa e dytë në shumën 32.760 euro është bërë në datën 13.10.2012, e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. ***, datë 13.10.2012, e shtetasit E. Dh.⁷⁷, paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017; (iii) pagesa përfundimtare në shumën 4.000 euro është shlyer gjatë vitit 2019 dhe 2021, e vërtetuar nga deklarata noteriale nr. ***, datë 5.6.2021, e administruar nga notere E. S. B.⁷⁸, bashkëlidhur së cilës gjendet certifikata e regjistrimit të pronësisë së pasurisë apartament⁷⁹ në emër të z. Gjergji Tako bashkë me kartelën e pasurisë së paluajtshme.

2.15. Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar në mënyrë të rregullt rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, në: (i) deklaratën *Vetting* 2017, pasi nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shitësve në shumën 4.000 euro, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016; (ii) DIPP-në e vitit 2012, pasi nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shitësve në shumën 4.000 euro, sipas kërkesave të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

2.16. Komisioni, nisur nga fakti që subjekti nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shitësve në shumën 4.000 euro në deklaratën *Vetting*, në DIPP-në e vitit 2012, vit në të cilin është krijuar kjo pasuri dhe në vijim në DIPP-të e viteve 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, duke marrë në konsideratë edhe faktin që deklarata e shitësit është bërë gjatë procesit të rivlerësimit, duket se subjekti e ka likuiduar shumën e mësipërme në vitin 2012, vit në të cilin ka lidhur kontratën premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012.

Analizimi i burimeve të krijimit të kësaj pasurie

2.17. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti për blerjen e apartamentit ka deklaruar këto burime: (i) një pjesë të shumës 1.169.913 lekë të tërhequr (mbyllje llogarie) nga babai i tij P. T. nga Tirana

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

⁷⁷ Shtetasi E. Dh. deklaron se ka marrë në dorëzim nga z. Gjergji Tako (me çeljen e kredisë nga Credins Bank) shumën prej 32.760 euro, shumë e cila përfaqëson këstin e dytë për blerjen e një apartamenti, sipas kontratës premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2012, noter A. M. dhe mbetet për t'u likuiduar shuma 4.000 euro.

⁷⁸ Shkresë e datës 3.9.2021, ku shtetasi E. Dh. deklaron: “Jashtë zyrës së noterisë sot, më datë 5.6. 2021, kam marrë nga z. Gjergji Tako shumën prej 2.000 euro, ekuivalente në lekë sipas kursit ditor zyrtar të Bankës së Shqipërisë, shumë e cila ishte ende për t'u paguar në zbatim të deklaratës noteriale nr. ***, datë 13.10.2012, hartuar nga notere A. M.. Kjo shumë është shlyer pas plotësimit të kushtit të daljes së certifikatës për vërtetim pronësie në emër të shtetasit Gjergji Tako. Tashmë me plotësimin e kushtit të daljes së certifikatës për vërtetim pronësie, nga njëra anë dhe shlyerja e shumës në total prej 4.000 euro (4.000 euro) (2.000 euro të paguara më parë datë 6.4.2019) (rezerva e mbajtur), deklaroj se shtetasi Gjergji Tako nuk më ka asnjë detyrim dhe është likuiduar me mua”.

⁷⁹ Nr. pasurie ***, z. k. ***, ***, Tiranë.

Bank; (ii) kredi nga Credins Bank në shumën 3.450.000 lekë; (iii) hua nga shtetasja V. D. në shumën 8.000 euro, të analizuar në vijim:

i) Shuma e tërhequr nga mbyllja e llogarisë nga babai i subjektit P. T. pranë Tirana Bank

2.18. Në përgjigje të pyetësorit standard⁸⁰, subjekti ka deklaruar se: “Prindi im P. T. ka financuar brenda një shume të poseduar prej tij prej 1.169.913 lekësh, një pjesë prej 6.000 euro për prenotimin e apartamentit me adresë ***, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, ap. *** (ose ***) dhe si burim të kësaj shume deklaroi se është mbyllja e llogarisë në emër të P. T. me nr. ***, pranë Tirana Bank në masën 1.169.913 lekë”.

2.19. Në pyetësin nr. 01⁸¹, Komisioni i kërkoi subjektin të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të provuar të ardhurat e ligjshme dhe transaksionin financiar si huaja/dhurimi nga babai i tij për blerjen e apartamentit. Në përgjigje⁸², subjekti ka paraqitur si provë printimin e datës 28.5.2020 të llogarisë bankare të shtetasit P. T. (nga Tirana Bank).

2.20. Nga dokumentacioni i administruar nga Tirana Bank⁸³ evidentohet një depozitim në vlerën 1.000.000 lekë në llogarinë e babait të subjektit në datën 10.6.2009 me përshkrimin “Dep-depozitë në arkë poc 1900 open në deal from P. T. and L. ***”. Pas kalimit në depozita me afat ndër vite, në datën 4.7.2012, babai i subjektit ka tërhequr vlerën 1.169.832 lekë, e përbërë nga depozitimi i sipërcituar dhe nga interesat.

2.21. Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e të dhënave konfidenciale, personi i lidhur/babai i subjektit ka deklaruar se tek Tirana Bank ka llogaritë e tij me origjinë nga kursimet e tij të punës që nga viti 1965.

2.22. Në procesverbalin e ILDKPKI-së⁸⁴, datë 26.1.2016, në përgjigje të pyetjes lidhur me burimin e depozitës, subjekti ka deklaruar se babai ka qenë drejtor politik i spitalit të Përmetit deri në vitin 1990, pastaj radiolog pranë këtij spitali, e më tej ka shpjeguar se janë edhe të ardhurat nga puna e nënës tek tatimet në Përmet deri në daljen në pension.

2.23. Komisioni vëren se në DIPP-në e vitit 2004, subjekti ka përfshirë të dhënat e deklarimit para fillimit të detyrës së bashku me ato të vitit 2004. Në këtë deklaratë konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar.

2.24. Nga analizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2000 – 2004, rezultoi një balancë pozitive prej 1.014.830 lekësh, si në tabelën vijuese.

⁸⁰ Përgjigje për pyetësin standard, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 31.1.2020.

⁸¹ Email datë 13.5.2020.

⁸² Email datë 1.6.2020.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2020, nga Tirana Bank.

⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2021.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare kronologjike për periudhën 2000 – 2004 (subjekti)

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Shpenzim	Gjendje progresive
2001	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	67,620		67,620
Janar – maj 2002	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	118,325		185,945
Qershor – dhjetor 2002	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	165,655		351,600
2003	Të ardhura subjekti Shkolla e Magjistraturës	239,420		591,020
2003	Të ardhura subjekti nga punësimi	82,238		673,258
Janar – gusht 2004	Të ardhura subjekti nga punësimi	632,449		1,305,707
Shtator – dhjetor 2004	Të ardhura subjekti nga punësimi	316,225		1,621,932
Tetor 2001 – dhjetor 2004	Shpenzime jetese 1 person		308,592	1,313,340
Nëntor 2003 – dhjetor 2004	Shpenzime udhëtimi ⁸⁵		58,500	1,254,840
31.12.2004	Shtesë llogaritë bankare subjekti ⁸⁶		240,010	1,014,830
	TOTAL	1,621,932	607,102	1,014,830

2.25. Balanca pozitive prej 1.719.139 lekësh e rezultuar nga analiza financiare e subjektit dhe prindërve⁸⁷ përfshin edhe kursimin potencial që do të rezultonte duke llogaritur vetëm pagat dhe shpenzimet e subjektit në vlerën 1.014.830 lekë e, për rrjedhojë, diferenca e mundshme për kursim vetëm nga ana e prindërve duket të ketë qenë 704.309 lekë⁸⁸.

2.26. Për këtë arsye, për të verifikuar ligjshmërinë e burimeve të ligjshme për kryerjen e depozitimit në datën 10.6.2009, në vlerën 1.000.000 lekë, Komisioni kreu analizën financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit, fillimisht duke mbartur vlerën 704.309 lekë dhe duke vijuar më tej me vitet 2005 – 2008⁸⁹. Duke qenë se prindërit nuk kanë pasur detyrim për plotësim të deklaratës së interesave private, analiza financiare nuk mund të kryhet në fund të çdo viti kalendarik, siç kryhet për vetë subjektin, por në vijimësi, duke mbartur në vitin pasardhës edhe balanca të mundshme pozitive që mund të rezultojnë nga vitet paraardhëse.

2.27. Në këtë analizë u konsideruan: (i) të ardhurat e babait nga pensioni⁹⁰; (ii) të ardhurat e të ndjerës, nënës së subjektit, nga pensioni⁹¹; (iii) të ardhurat e babait nga aktiviteti si ekografist⁹²; (iv) tërheqjet nga mbyllja e firmave piramidale trajtuar më lart; (v) shpenzime jetese për 2

⁸⁵ Shpenzime udhëtimi vendbanim – vendi i punës.

⁸⁶ Tirana Bank.

⁸⁷ Referojuni analizës financiare kronologjike paraqitur në tabelën nr. 1 – Analiza financiare kronologjike për periudhën 1996 – 2004 (subjekti dhe prindërit).

⁸⁸ Diferenca midis 1.719.139 lekë me 1.014.830 lekë. Përfshihet vlera 1.014.830 lekë (kursimi potencial vetëm nga të ardhurat/shpenzimet e subjektit), pasi në DIPP-në e vitit 2004 nuk janë deklaruar likuiditete *cash* jashtë sistemit bankar.

⁸⁹ Nuk u konsiderua periudha janar – maj 2009, pasi ajo është e përfshirë në analizën financiare për pagesën e vlerës 11.800 euro.

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2021, nga ISSH-ja Tiranë.

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021, nga ISSH-ja Gjirokastër.

⁹² Trajtuar në vijim të relacionit.

persona⁹³; (vi) shpenzime qiraje babai në Përmet⁹⁴; (vii) shtesa/pakësim i llogarive bankare⁹⁵, nga ku rezultoi një balancë pozitive, siç paraqitet në tabelën vijuese.

Tabela nr. 3 – Analiza financiare kronologjike për periudhën 2005 – 2008 (prindërit)

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Pasuri/ shpenzim	Gjendje progresive
	Balanca e analizës në fund të vitit 2004	704,309		704,309
2005	Të ardhura babai nga pensioni	173,949		878,258
2005	Të ardhura nëna nga pensioni	188,513		1,066,771
2005	Shpenzime jetese 2 persona		219,114	847,657
2005	Tërheqje sipas koeficientit nga shoqëritë “***” “***”	138,174		985,831
2005	Shpenzime qiraje babai Përmet		60,000	925,831
2006	Të ardhura babai nga pensioni	184,721		1,110,552
2006	Të ardhura nëna nga pensioni	199,044		1,309,596
2006	Shpenzime jetese 2 persona		219,114	1,090,482
2006	Shpenzime qiraje babai Përmet		60,000	1,030,482
2007	Të ardhura babai nga pensioni	199,484		1,229,966
2007	Të ardhura nëna nga pensioni	208,704		1,438,670
2007	Shpenzime jetese 2 persona		348,144	1,090,526
2007	Shpenzime qiraje babai Përmet		60,000	1,030,526
2008	Të ardhura babai nga pensioni	217,837		1,248,363
2008	Të ardhura babai nga aktiviteti privat	155,700		1,404,063
2008	Kontribut në pagesën e shumës 11.800 euro		155,700	1,248,363
2008	Të ardhura nëna nga pensioni	224,028		1,472,391
2008	Shpenzime jetese 2 persona		273,240	1,199,151
2008	Shpenzime qiraje babai Përmet		60,000	1,139,151
2008	Shtesë e llogarive bankare (31.12.2008 – 31.12.2004)		2,955	1,136,196
10.6.2009	Depozitim në Tirana Bank		1,000,000	136,196
	TOTAL	2,594,463	2,458,267	136,196

2.28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur/babai kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 1.169.832 lekë për pagesën e apartamentit, pasi kjo vlerë e ka origjinën nga krijimi i depozitës bankare të personit të lidhur/babait, e cila rezultoi se është krijuar me burime të ligjshme.

ii) Kontratë kredie në shumën 3.450.000 lekë

2.29. Në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit kredinë e marrë nga Credins Bank në shumën 3.450.000 lekë me kontratën nr. ***, datë 14.9.2012.

⁹³ Bazuar në shkresën nr. ***, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së për periudhën 2000 – 2016 (në mungesë të të dhënave për vitin 2001 u konsiderua vlera e vitit paraardhës 108.000 lekë/vit për person), ndërsa vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. *** prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së, 174.072 lekë/vit për person.

⁹⁴ Në pyetësorin nr. 2, subjekti ka deklaruar se babai tij nuk ka udhëtuar Tiranë-Përmet-Tiranë, pasi ai jetonte fizikisht në Përmet, në katin e gjashtë të një pallati në ***, për një shifër qiraje 5.000 lekë/muaj, pasi u shit banesa e vjetër tek M. H.. Ai kishte zhvendosur prej vitit 2000 gjendjen civile në Tiranë, por konsumin fizik të jetës e ka kryer në Përmet deri në gusht 2012. Për vërtetimin e deklaratimit subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale të dy komshinjve, S. Gj. e L. B., të cilët deklarojnë se shtetasit P. T. ka banuar në shtëpinë e shtetasit K. J. për periudhën 2004 – 2012, kundrejt qirasë prej 5.000 lekësh.

⁹⁵ Diferenca e balancës së datës 31.12.2008 me atë të datës 31.12.2004, Raiffeisen Bank. Llogaritë në Tirana Bank janë çelur në datën 10.6.2009.

2.30. Në përgjigje të pyetësorit standard⁹⁶, subjekti ka deklaruar: “*Credins Bank ka financuar blerjen e banesës në posedim në ***, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, ap. *** ose ***, në masën 3.393.000 lekë (neto) në trajtën e një kontrate kredie nr. *** rep., *** kol., datë 14.9.2012*”.

2.31. Nga shqyrtimi i DIPP-ve vjetore rezulton se subjekti e ka deklaruar këtë kredi, qëllimin e përdorimit të saj, afatin dhe shlyerjet në DIPP-në e vitit 2012 e në vijim⁹⁷.

2.32. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 dhe të administruar nga Credins Bank⁹⁸ rezulton se sipas kontratës për kredi afatgjatë nr. ***, datë 14.9.2012, nr. ***, me palë kredidhënëse Credins Bank, kredimarrës Gjergji P. Tako, dorëzanës F. P. M., banka i ka dhënë subjektit një kredi në shumën 3.450.000 lekë, me qëllim kreditimi për blerje banese me afat 20 vjet dhe normë interesi REPO + 7,5 % në vit, i rishikueshëm me ndryshimet e REPO-s.

2.33. Sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 14.9.2012, kolateral është vendosur pasuria nr. ***, z. k. ***, me sip. 57,1 m², lloji i pasurisë apartament, me adresë: “Rruga “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, në pronësi të Gjergji Takos”.

2.34. Nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë së subjektit pranë Credins Bank rezulton se në datën 1.10.2012 është disbursuar shuma 3.415.500 lekë dhe po në të njëjtën datë subjekti ka tërhequr *cash* shumën 3.393.000 lekë.

2.35. Për sa i përket marrëdhënies me garantuesen F. M., me anë të pyetësorit nr. 1⁹⁹ Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime dhe, në përgjigje¹⁰⁰, ai deklaroi se: “*Unë nuk kam pasur asnjë marrëdhënie me shtetasen F. M.. Ajo ka qenë në marrëdhënie shoqërore të ngushtë me shtetasen V. D., nëpërmjet së cilës u arrit komunikimi dhe marrëveshja. Nga ana e shtetasen F. M. është vendosur në parim si kolateral gjithë pasuria e saj sikurse përshkruhet në nenin 8 të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2012. Nga ana e bankës është kërkuar dhe administruar për këtë dorëzanës vërtetimi i punësimit datë 31.8.2012 dhe lëvizjet në llogarinë bankare për këtë shtetase për periudhën 1.1.2012 – 31.8.2012*”. Bashkëlidhur shpjegimeve ka paraqitur edhe dokumentacionin provues¹⁰¹.

⁹⁶ Përgjigje për pyetësorin standard protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 31.1.2020.

⁹⁷ (i) Në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar kredi bankare me qëllim blerje apartamenti banimi sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.9.2012, afati i shlyerjes 20 vjet, shuma e marrë 3.450.000 lekë, kësti mujor 37.388 lekë. Fillimi i kredisë data 1.10.2012. Shlyer 7.242 lekë për principalin dhe 69.419 lekë për interesat, mbetur 3442.757 lekë; (ii) Në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar kontratën e kredisë bankare sipas përshkrimit të mësipërm dhe shlyerje të saj në shumën 402.034,78 lekë për interesat dhe 46.621 lekë për principalin, mbetur 3.392.639,46 lekë; (iii) Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar kontratën e kredisë bankare sipas përshkrimit të mësipërm dhe shlyerje të saj në shumën 361.816,48 lekë, paguar për interesa dhe 88.839,52 lekë, paguar për principalin, mbetur 3.343.731,84 lekë; (iv) Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar kontratën e kredisë me përshkrimin e mësipërm dhe shlyerjen e saj në shumën 353.118,04 lekë për interesa dhe 58.904,18 lekë për principalin, mbetur 3.268.493,56 lekë; (v) Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar kontratën e kredisë me përshkrimin e mësipërm dhe shlyerjen e saj në shumën 61.486 lekë për principalin dhe 387.188 lekë për interesat, mbetur 3.218.662 lekë.

⁹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2021; kontratë hipoteke nr. ***, datë 14.9.2012; kontratë për kredi afatgjatë nr. ***, datë 14.9.2012.

⁹⁹ Email datë 13.5.2020.

¹⁰⁰ Email datë 1.6.2020.

¹⁰¹ Kopje e vërtetimit datë 31.08.2012 për shtetasen F. M.; kopje llogarie bankare për shtetasen F. M. për periudhën 1.1.2012 – 31.8.2012; kopje e nenit 8 të kontratës nr. ***, datë 14.9.2012.

2.36. Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹⁰², arsyeton se nga leximi harmonik i dispozitave që rregullojnë konceptin e “personit tjetër të lidhur” me dispozitat që rregullojnë mënyrën e deklarimit dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në procesin e rivlerësimit, arrihet në përfundimin që marrëdhënia në të cilën një person bëhet dorëzanës kundrejt një kreditori, e shndërron të parin në person tjetër të lidhur.

2.37. Megjithatë, në kushtet kur dorëzanësja F. M. nuk ka vënë në hipotekë ndonjë pasuri të saj për të garantuar kredinë e marrë nga subjekti, por ka vendosur në parim si kolateral gjithë pasurinë e saj, nuk ekziston ndonjë dyshim për fshehje pasurie nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni hetoi vetëm lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasen F. M. në prokuroritë ku ka punuar subjekti i rivlerësimit. Në përgjigje¹⁰³ nuk rezultoi se në emër të kësaj shtetaseje të jetë regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara.

iii) Hua nga shtetasja V. D. në shumën 8.000 euro

2.38. Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet e blerjes së apartamentit huan nga shtetasja V. D. në shumën 8.000 euro dhe se kjo shtetase e ka burimin e kësaj shume parash nga një depozitë bankare në euro të shtetasve I. S. dhe R. B. të hapur në vitin 2008 në Raiffeisen Bank, ku shtetasi I. S. i ka dhënë të drejtë administrimi shtetases V. D. dhe burimi i kësaj shume është emigrimi i ligjshëm në Itali nga viti 1997 e në vijim, i pandërprerë i këtyre shtetasve. Në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar: “*Hua e marrë nga shtetasja V. D. ...pa interes*”, si dhe ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁰⁴.

2.39. Referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 21.3.2013, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe të administruar nga noteri D. K.¹⁰⁵, shtetasja V. D. ka deklaruar se i ka dhënë në dorë z. Gjergji Tako shumën prej 8.000 euro për blerjen e një apartamenti banimi të ndodhur në ***, Tiranë, me sip. 90,97 m², kjo e konfirmuar nga kontrata premtim shitjeje datë 1.9.2012, nr. *** rep., nr. *** kol., të noteres A. M. dhe se është plotësisht dakord që shuma të likuidohet me një afat 10-vjeçar.

2.40. Nga shqyrtimi i DIPP-ve vjetore konstatohet se subjekti e ka deklaruar këtë hua në vitin DIPP-në e vitit 2012, konkretisht: “*Hua e marrë nga shtetasja V. D. në shumën 8 mijë euro për të plotësuar shumën për blerjen e apartamentit të banimit, data e fillimit 22.8.2012, afati i shlyerjes 10 vjet, pa interes*”.

¹⁰² Vendim nr. 28, datë 30.10.2019 (JR) (pg. 48), i Kolegjit.

¹⁰³ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

¹⁰⁴(1) Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2013; (2) nxjerrje llogarie nga Agjencia ***, vulosur nga Raiffeisen Bank, me datë printimi 19.3.2013; (3) kartat e specimenteve të nënshkrimeve të autorizuara për klientët individë, datë 6.8.2008, nxjerrje e vulosur nga Raiffeisen Bank; (4) kontratë depozite me afat, datë 22.8.2011; (5) fotokopje të kartës së identitetit italiane nr. ***, në emër të shtetasit I. S. dhe nr. *** në emër të shtetasës R. B.; (6) nxjerrje llogarie page (në gjuhën italiane) në emër të shtetasit I. S. për muajt nëntor 2015, tetor 2016 – dhjetor 2016; (7) dokument në gjuhën italiane në emër të shtetasës R. B. për llogaritjen e pagës; (8) depozitim për të tretë nga Raiffeisen Bank, datë 3.10.2016.

¹⁰⁵ Shkresë e protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 27.9.2021.

2.41. Në DIPP-të e viteve 2013, 2014 e 2015 ka deklaruar 0 (zero) euro të shlyer, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar se ka shlyer 500 euro. Mbetur: 7.500 euro. Ky detyrim është deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*.

2.42. Në procesverbalin e datës 26.1.2016, të ILDKPKI-së, lidhur me pyetjen se cili është burimi i vlerës së dhënë hua nga shtetasja V. D. dhe sa është detyrimi deri në datën 31.12.2014, subjekti ka deklaruar se: *“Burimi nga shtetasja V. D. është motra e saj R. dhe bashkëshorti i saj I. S., emigrant zyrtar me letra reale që prej vitit 1997 në Itali. Ky çift nga puna e tyre 15-vjeçare ka depozituar një shumë prej 58.000 euro në bankat shqiptare dhe V. ka pasur të drejtë të kryejë veprime tek kjo depozitë. Ndaj shtetasës V. D. nuk kam kryer shlyerje dhe deri në datën 31.12.2014 është 8.000 euro”*.

2.43. Në përgjigje të pyetësorit standard¹⁰⁶ subjekti ka deklaruar se: *“Shtetasja V. D. ka financuar marrjen në posedim të apartamentit në masën 8.000 euro sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2012, me adresë ***, pallati ****, hyrja ***, kati ***, ap. *** ose ***. Burim i këtij financimi ka qenë depozita bankare nr. *** e shtetasit I. S., vërtetuar me aktin e tërheqjes nga Raiffeisen Bank, dega Vorë, e datës 22.8.2012, në shumën 8.000 euro. Ky financim është bërë në trajtën e një huaje sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2013. Gjendja aktuale është 5.500 euro, mbetje për t’u shlyer”*.

2.44. Me anë të pyetësorit nr. 1¹⁰⁷, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues për mundësitë financiare të shtetasve I. S. dhe R. B. në momentin/kohën kur është dhënë huaja, si dhe të shpjegojë marrëdhënien midis shtetasës V. D. me shtetasit e mësipërm dhe përse këta shtetas i dhanë autorizim të pakufizuar V. për të operuar me depozitën e tyre. Në përgjigje¹⁰⁸, subjekti ka deklaruar: *“Shtetasit I. S. dhe R. B. janë ligjërish shtetas italian dhe janë të punësuar ligjërish në shtetin italian. Është e provuar se ata kanë hapur një llogari në monedhën euro në Raiffeisen Bank që në vitin 2008, pra shumë më parë se marrja e huas nga ana ime. Shtetasja V. D. është motra e R. B. dhe kunata e I. S. Këta shtetas i kanë dhënë autorizim të pakufizuar shtetasës V. D. në mënyrë që kjo e fundit në çdo moment kryente veprime pranë Raiffeisen Bank për t’iu kursyer udhëtimet e shpeshta e të paprogramuara drejt Shqipërisë”*.

Analiza e llogarive në Raiffeisen Bank në emër të shtetasit I. S.

2.45. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* rezulton se sipas dokumentit “Karta e specimenteve të nënshkrimeve të autorizuar për klientët individë”, datë 6.8.2008, të Raiffeisen Bank, titullari i depozitës I. S. ka autorizuar shtetasen V. D. që në llogarinë nr. *** të kryejë veprime deri në 100% të shumës, si dhe për thyerje depozite.

2.46. Nga analizimi i transaksioneve në këto llogari, përcjellë nga Raiffeisen Bank¹⁰⁹, konstatohet se në vitin 2008 janë depozituar 46.000 euro, konkretisht në datën 6.8.2008 shtetasi I. S. depoziton 20.000 euro dhe në datën 16.9.2008 shtetasja V. D. depoziton 26.000 euro.

¹⁰⁶ Përgjigje për pyetësorin standard, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 31.1.2020.

¹⁰⁷ Email datë 13.5.2020.

¹⁰⁸ Email datë 1.6.2020.

¹⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.10.2021.

2.47. Më tej, këto shuma kalojnë në dy depozita me afat dhe bashkohen në një të vetme në vitin 2009, e cila maturohet dhe shlyhet disa herë, derisa maturohet në datën 4.8.2011. Në datën 22.8.2011, shtetasja V. D. depoziton 7.000 euro¹¹⁰, të cilat i bashkohen shumës së maturuar të depozitës së mësipërme dhe krijohet një depozitë e re me afat 1-vjeçar, me vlerë 56.100 euro. Pas shlyerjes së kësaj depozite në datën 22.8.2012, në të njëjtë datë V. D. tërheq 8.000 euro¹¹¹, vlerë të cilën subjekti e deklaron si burim të huas. Pjesa e mbetur pas kësaj tërheqjeje kalon në depozitë me afat 1-vjeçar. Në datën 18.9.2014, pas maturimit, vlera prej 51.200 euro e mbetur në llogari, i transferohet në Itali shtetasit I. S.. Në datën 31.8.2015, shtetasja V. D. depoziton 7.000 euro, shumë e cila i transferohet në Itali shtetasit I. S. në të njëjtën datë.

2.48. Lidhur me provimin e ligjshmërisë së të ardhurave të shtetasve I. S. dhe R. B., në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin nr. 1, subjekti ka kartat e identitetit¹¹² të shtetasve I. S. dhe R. B., si edhe dokumentacionin lidhur me pagat e tyre përgjatë viteve 2015 – 2016¹¹³.

2.49. Në vijim, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, në pyetësin nr. 2¹¹⁴, subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me të ardhurat përpara momentit të dhënies së huas, konkretisht *CUD-et*¹¹⁵ që i referohen viteve 2002 – 2007, në emër të shtetasit I. S., dokumentacion të cilin e paraqiti në formën e kërkuar ligjore në datën 16.6.2022¹¹⁶.

2.50. Referuar këtyre deklaratave, shuma e të ardhurave bruto për këtë periudhë është 145.692 euro, ndërsa shpenzimet e jetesës¹¹⁷ për dy persona kanë qenë 69.923 euro.

2.51. Sa më lart, duket se të ardhurat e ligjshme kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për 2 persona dhe për dhënien e huas në vlerën 8.000 euro.

2.52. Lidhur me shlyerjen kësaj huaje, referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se subjekti ka kryer këto shlyerje: (i) vlerën 500 euro në datën 3.10.2016, me anë të depozitimit nga ana e subjektit në llogarinë bankare të analizuar më lart, me përshkrimin “Gjergji Tako pagesë kësht huaje në favor të V. D.”¹¹⁸; (ii) vlerën 2.000 euro në datën 5.4.2019, referuar deklaratës noteriale

¹¹⁰ Me përshkrimin “V. D. derdh në llog”.

¹¹¹ Me përshkrimin “V. D. ***”.

¹¹² Dokument në gjuhën italiane “*Carta D’ Identita*”, ***, me datë lëshimi 14.4.2014 në emër të shtetasit I. S. dhe dokumenti në gjuhën italiane “*Carta D’ Identita*”, ***, me datë lëshimi 8.8.2012 në emër të shtetasës R. B..

¹¹³ Sipas dokumentit në gjuhë italiane rezulton se shtetasi I. S. për muajt nëntor 2015, tetor 2016 – dhjetor 2016, me pagë mujore rreth 2.000 euro dhe sipas dokumentit në gjuhë italiane (llogaritja e pagës), periudhë e paidentifikuar, shtetasja R. B. është paguar në shumën neto 539 euro. Në pyetësin standard, përveç dokumenteve të mësipërme, subjekti ka paraqitur dhe fotokopje të dokumenteve në gjuhën italiane emër të shtetasës R. B., ku në muajin tetor 2016 është paguar në shumën 539 euro, në muajin nëntor 2016 është paguar në shumën 539 euro dhe në muajin dhjetor 2016 është paguar në shumën 565 euro.

¹¹⁴ *Email* datë 21.2.2022.

¹¹⁵ *Certificazione Unica dei redditi di lavoro Dipendente*.

¹¹⁶ Inventar shtesë për raportin e datës 3.6.2022 (nr. *** prot., datë 16.6.2022, pranë Komisionit).

¹¹⁷ Referuar <https://www.istat.it/it/dati-analisi-e-prodotti/contenuti-interattivi/soglia-di-poverta>, me kriteret 2 persona 18-59 vjeç, Nord, area metropolitana.

¹¹⁸ Mandat i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting*, konfirmuar edhe në lëvizjet e llogarive të përcjella nga Raiffeisen Bank me shkresë nr. ***, datë 6.10.2021.

nr. ***, datë 6.4.2019¹¹⁹; (iii) vlerën 2.000 euro në datën 5.6.2021, *cash*, referuar deklaratës noteriale nr. ***, datë 5.6.2021¹²⁰.

2.53. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasit R. B. dhe I. S. dhe nga hetimi nuk rezultoi se në emër të këtyre shtetasve të jetë regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi, përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara¹²¹.

2.54. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur/babai kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 8.000 euro për pagesën e apartamentit, pasi personat e tjerë të lidhur/I. S. dhe R. B. (nëpërmjet V. D.) kanë pasur mundësi të ligjshme financiare për dhënien e huas.

Shpenzimet për mobilimin e apartamentit në vlerën 791.000 lekë (viti 2012)

2.55. Në pyetësin standard¹²², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të detajuara shpenzimet e kryera¹²³ për mobilimin e banesës në ***, të cilat rezultojnë në vlerën totale 791.000 lekë. Më tej¹²⁴ ka deklaruar se midis tetorit 2012 dhe marsit 2013 ka bërë shpenzim rreth 5.000 euro për orenditë e apartamentit të marrë në posedim në adresën ***, pallati “****”, hyrja ***, kati ***, apartamenti *** ose ***. Burim i shpenzimit, ka vijuar subjekti, është mospagesa e një shifre prej 4.000 euro tek poseduesi i mëparshëm i apartamentit në formën e pengut deri në pajisjen me certifikatë pronësie dhe montimin e ashensorit dhe të ardhurat e tij dhe të babait P. T.. Ndërsa në procesverbalin e datës 26.1.2016, të ILDKPKI-së subjekti ka deklaruar se apartamenti është bërë i banueshëm rreth marsit të vitit 2013 dhe mobilimi i tij ka shkuar rreth 5.000 euro.

2.56. Sa më lart, Komisioni pasqyroi në analizën financiare shpenzime mobilimi në vlerën 791.000 lekë dhe e pasqyroi atë në analizën financiare të vitit 2012.

Shpenzime të tjera për mobilimin e apartamentit (vitet 2013 dhe 2015)

i) Kredi pranë Credins Bank, në vlerën 700.000 lekë

2.57. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti deklaroi: “*Kredi në Credins Bank nr. *** kredie, qëllimi është pagesë për kompletim banese pasi në vitin që u mor kjo kredi u vu ashensori në banesë dhe me plotësimin e këtij elementi teknik pritej vijimi i regjistrimit në ZVRPP i saj, nga ku*

¹¹⁹ Shkresë e datës 24.11.2021, noter Y. Ç.. Shtetasja V. D. ka deklaruar: “*Jashtë zyrës së noterisë, në datën 5.4. 2019 kam marrë nga z. Gjergji Tako shumën prej 2.000 euro (dy mijë) ekuivalente në lekë sipas kursit ditor zyrtar të Bankës së Shqipërisë, shumë të cilën ia kisha dhënë hua sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2013, hartuar nga notere D. K.*”.

¹²⁰ Shkresë e datës 3.9.2021, notere E. S. B.. Shtetasja V. D. ka deklaruar: “*Sot, me nënshkrimin e kësaj deklaratë, deklaroj se mora cash jashtë zyrës noteriale pa interesa, cash, shumën 2.000 euro, ekuivalente në lekë sipas kursit ditor zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe jam në dijeni se këtë shumë z. Gjergj e ka tërhequr nga Credins Bank, me datë 27.5.2021, sipas edhe mandatit bashkëlidhur dhe deklaroj se shtetasi Gjergj Tako më ka borxh edhe 3.500 euro*”.

¹²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 26.10.2021, e Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

¹²² Përgjigje për pyetësin standard, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 31.1.2020.

¹²³ TV Philips 0 (zero) lekë nga banesa e mëparshme; aparat TV 25.000 lekë; dollap me dy kanata 0 (zero) lekë nga banesa e mëparshme; kontrabufë kuzhine 150.000 lekë; kënd ndenje, tavolinë me 6 karrige, etazher, tavolinë mesi me vlerë 220.000 lekë; elektroshtëpiake 167.000 lekë (frigorifer, furrë, suprinë, aspirator, mikrovalë 117.000 lekë blerë në rrjetin e dyqaneve “****”, lavatrici 50.000 lekë blerë në rrjetin e dyqaneve “****”); aparat digjital TV 20.000 lekë; ndriçimi 50.000 lekë; dhomë gjumi bashkë me dyshekun, i blerë i përdorur 100.000 lekë; babai i tij P. T. me shpenzimet e tij ka blerë një dollap, një krevat së bashku me dyshekun në vlerën 59.000 lekë, si edhe vjehrra V. D. i ka dhuruar një krevat fëmije, një dollap me 2 kanata dhe një portomanto në shumën 80.000 lekë (në pyetjen nr. 4 subjekti ka specifikuar periudhën shkurt 2017).

¹²⁴ Përgjigje e pyetjes nr. 9.

do të më lindte detyrimi për pagesën 4.000 euro të mbetura si kusht që në kontratën fillestare të apartamentit me subjektin që hartova kontratën premtim shitjeje, shuma totale 700.000 lekë, kohëzgjatja 5 vjet, kësti mujor 15.394 lekë”.

2.58. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, të administruar dhe nga Credins Bank¹²⁵, rezulton se ndërmjet Credins Bank, në cilësinë e kredidhënësit, subjektit Gjergji Tako, në cilësinë e kredimarrësit, dhe shtetasit G. V. P., në cilësinë e dorëzanësit, është lidhur kontrata e kredisë nr. ***, datë 22.6.2015, sipas së cilës banka i ka dhënë kredimarrësit një kredi në shumën 700.000 lekë, me qëllim “konsumatore për mobilim”. Në vijim është lidhur marrëveshja siguruese nr. ***, datë 22.6.2015, ku parashikohet se subjekti i rivlerësimit lë peng kontratën premtim shitje për shitjen e apartamentit të ndodhur në *** me këto të dhëna: apartamenti 66, kuota + 23.90, kati 7, tipologjia 2+1, sipërfaqe totale 101,87 m² dhe sipërfaqe e shfrytëzuar 90,97 m².

2.59. Me anë të pyetësorit nr. 1¹²⁶, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime se cila ishte marrëdhënia e tij me shtetasin G. P.. Në përgjigje¹²⁷, subjekti deklaroi se: “*Shtetasi G. P. është nga njëra anë koleg shumëvjeçar pune në Prokurorinë e Rrethit Tiranë dhe nga ana tjetër është lidhje e ngushtë shoqërore dhe farefisni e shkallës 3 me kumatën time S. T. në fshatin ***, Sarandë”.* Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin G. P. dhe nga hetimi nuk rezultoi se në emër të këtij shtetasi të jetë regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi, përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara¹²⁸.

ii) Shuma e dhuruar nga vëllai E. T., 229.700 lekë, e përdorur për kondicionerë (viti 2013)

2.60. Në përgjigje të pyetësorit standard¹²⁹ deklaroi se ka marrë dhuratë në vlerën 229.700 lekë nga vëllai i tij E. T. në vitin 2013 dhe si burim i kësaj dhurate është blerja me *leasing* e tre kondicionerëve nga i vëllai pranë qendrës tregtare “****” nëpërmjet Union Bank, me datë fillimi 22.5.2013 dhe datë mbylljeje 27.5.2014. Bashkëlidhur ka paraqitur edhe dokumentacionin provues¹³⁰.

2.61. Union Bank¹³¹ konfirmon kredinë konsumatore me kredimarrës E. T. dhe P. T., me afat 1-vjeçar, të kaluar në datën 22.5.2013, për blerje pajisje “****” sh.p.k., në vlerën 229.700 lekë.

2.62. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personit të lidhur/babait, për vitin 2012, nga ku u konstatua një balancë negative në vlerën 270.705 lekë.

2.63. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e

¹²⁵ Kontratë kredie nr. ***, datë 22.6.2015.

¹²⁶ Email datë 13.5.2020.

¹²⁷ Email datë 1.6.2020.

¹²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 28.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 31.1.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹²⁹ Përgjigje për pyetësorin standard, protokolluar pranë Komisionit me nr. ***, datë 31.1.2020.

¹³⁰ Informacion përmblendhës, i datës 17.1.2020, i Union Bank bashkë me planin e shlyerjes.

¹³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2022.

rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *Subjekti dhe personi i lidhur (babai i tij) kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 270.705 lekë për pagesën e apartamentit në vlerën 38.760 euro dhe të mobilimit të tij, si edhe për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2012; (ii) Subjekti e ka paguar shumën 4.000 euro në vitin 2012, vit në të cilin ka lidhur kontratën premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012, duke qenë se: (a) nuk e ka deklaruar detyrimin ndaj shitësve në deklaratën Vetting, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 31 dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016; (b) nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012, vit në të cilin është krijuar kjo pasuri edhe në DIPP-të e viteve 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017, në kundërshtim me shkronjën “dh” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.*

2.64. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹³², subjekti ka shpjeguar se mospasqyrimi në kolonën “Detyrime” i shumës së mbetur nuk do të thotë se pagesa prej 4.000 euro është kryer që në vitin 2012, pasi shitësi nuk ishte i pajisur me certifikatë pronësie dhe se mosdeklarimi i shumës 4.000 euro në këtë kolonë është pasaktësi.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.65. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar Vetting 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

2.66. Subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar pasurinë apartament në vlerën 38.760 euro dhe se ka paguar 34.760 euro. Të njëjtin deklaram ka bërë edhe në deklaratën Vetting 2017. Gjithashtu konstatohet se në kontratën premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012, përcaktohet se pagesa e parë në shumën 2.000 euro është bërë në datën e nënshkrimit të kontratës dhe diferencën e çmimit prej 36.760 euro do ta likuidojë me çeljen e një kredie nga Credins Bank.

2.67. Më pas, rezulton se shtetasi E. Dh. (shitësi) në deklaratën noteriale nr. ***, datë 13.10.2012, ka deklaruar se: “...ka marrë në dorëzim nga z. Gjergji Tako (me çeljen e kredisë nga Banka Credins) shumën 32.760 euro, shumë e cila përfaqëson këstin e dytë për blerjen e një apartamenti, sipas kontratës premtim shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2012 dhe mbetet për t’u likuiduar shuma 4.000 euro”. Dhe në deklaratën noteriale nr. ***, datë 5.6.2021, shtetasi i mësipërm ka deklaruar se detyrimi i mbetur prej 4.000 euro është shlyer plotësisht në vitin 2019 (2.000 euro) dhe në vitin 2021 (2.000 euro).

2.68. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm, Komisioni vlerëson se subjekti ka provuar që në vitin 2012 ka paguar vetëm shumën 34.760 euro e, për rrjedhojë, në analizën financiare u pasqyrua vlera 4.000 euro, si detyrim i pashlyer ndaj shitësve të apartamentit.

2.69. Analiza financiare e rishikuar për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2012 paraqitet në tabelën në vijim:

¹³² Email datë 21.4.2022.

Tabela nr. 4 – Analiza financiare për vitin 2012

Përshkrim	Vlera
Apartament me sip. 101,87 m ² në posedim, Tiranë (38.760 euro) ¹³³	5,353,919
Ndryshim likuiditete	-1,071,976
Total pasuri	4,281,943
Të ardhura nga pagat subjekti	935,459
Të ardhura nga mësimdhënia subjekti	91,800
Të ardhura nga pagat babai	70,192
Të ardhura nga pensioni babai	264,004
Të ardhura nga interesat bankare babai (depozita në Tirana Bank)	36,778
Total të ardhura	1,398,233
Hua V. K. (tezja), 600.000 lekë, datë fillimi 20.2.2005	-20,000
Detyrim ndaj shitësve të ap. Yzberisht	552,520
Kredi Credins Bank, vlerë 3.450.000 lekë, datë 1.10.2012	3,450,000
Hua V. D. (vjehera), 8.000 euro	1,105,040
Total detyrime	5,087,560
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI – INSTAT (2 persona)	282,048
Shpenzime për arredim	791,000
Shpenzime për shlyerje kredie Raiffeisen Bank (principal, interesa etj.)	488,574
Shpenzime për shlyerje kredie Credins Bank 3.450.000 lekë	76,661
Shpenzime interesa <i>overdraft</i> -i	38,752
Shpenzime qiraje babai Përmet	35,000
Shpenzime për ceremoni familjare	210,000
Total shpenzime	1,922,035
Balanca e fondeve (të ardhura + detyrime - pasuri - shpenzime)	281,815

2.70. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e shumës 34.760 euro për blerjen e apartamentit dhe për kryerjen e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “a” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, me vlerë 650.000 lekë**

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Automjet tip “Mercedes-Benz”, targë ***, vit i krijimit 2002, vlera në dokumentacion 250.000 lekë, vlera e sendit 650.000 lekë. Automjeti është vjedhur në datën 15.2.2005, sipas shkresës b. i. me pjesë 100% para vjedhjes*”. Si burim krijimi deklaron kontratën e dhurimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2002, nga babai i tij dhe burimi tek babai i tij janë: të ardhurat nga 38 vjet pune (21.8.1964 – 31.12.2000); pensioni së bashku me nënën; mbetjet (interesat) e tërhequra nga firmat piramidale; të ardhura nga administrimi i një autoshkolle në Përmet në vitet 1992 – 1996. Për vërtetimin e deklarimeve subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹³⁴.

¹³³ Vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit datë 3.9.2012, sipas Bankës së Shqipërisë, 1 euro = 138.13 lekë. I njëjti kurs këmbimi u aplikua edhe mbi huan në vlerën 8.000 euro.

¹³⁴ Deklaratë zhdoganimi, datë 5.3.2001; vërtetim zhdoganimi datë 6.3.2001; vërtetim hyrjeje, datë 14.2.2001; mandatarkëtimi i Bankës së Kursimeve, datë 6.3.2001; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.6.2002. Leje qarkullimi automjeti nr.***, me targë ***, kontratë dhurimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.7.2002; shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2016, e Komisarariatit të Policisë Nr. *** , Tiranë.

3.2. Në DIPP-në e vitit 2004, ku ka deklaruar: *“Autoveturë tip Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1984, targë ***. Blerë nga I. M., Përmet. Me vlerë 650.000 lekë*. Pjesë takuese 100% dhe periudhë krijimi mars 2004. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit në kundërshtim me paragrafin e parë dhe me shkronjën “b” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

3.3. Në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar: *“Vjedhje automjeti. Bërë kallëzim tek Kom. Nr. ***, Tiranë. Targa ***”*.

3.4. Në pyetësin nr. 1¹³⁵, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me mospërputhjen e deklarimeve të bëra lidhur me çmimin e blerjes së automjetit pasi në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar vlerën 650.000 lekë, ndërsa në deklaratën *Vetting 2017* ka deklaruar vlerën në dokumentacion 250.000 lekë. Në përgjigje¹³⁶, subjekti ka deklaruar: *“Nuk ka mospërputhje midis DPV-së së vitit 2004 dhe deklaratës *Vetting 2017* në lidhje me çmimin e automjetit me targë ***. Në të dyja deklaratat çmimi real i paguar nga unë dhe babai im P. T. tek shitësi është 650.000 lekë. Në deklaratën *Vetting 2017* unë kam bërë sqarimin shtesë se në kontratën e shitblerjes nr. *** rep. *** kol., datë 6.6.2002, çmimi ishte shënuar 250.000 lekë, për të qenë plotësisht korrekt me faktet”*.

3.5. Sa më sipër, për efekt të analizës financiare, Komisioni mori në konsideratë vlerën 650.000 lekë të deklaruar të paguar nga subjekti, përkundrejt çmimit 250.000 lekë të shënuar në kontratë.

3.6. Në vijim, lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti, në përgjigje të pyetësit nr. 1, ka deklaruar: *“Automjeti me targë *** është financuar pas shlyerjes që bëri shteti me koeficientin 20,15%, për likuidimin e shoqërisë “***” tek babai im në masën 515.085 lekë, në vitet 2001 – 2002”*.

3.7. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja¹³⁷ rezulton se me kontratën e datës 6.6.2002 shtetasi I. M. i shet automjetin e mësipërm blerësve P. T. e Gjergji Tako. Në kontratë përcaktohet çmimi i shitblerjes në shumën 250.000 lekë, i cili është likuiduar midis palëve jashtë zyrës noteriale përpara redaktimit të kontratës. Më pas, me kontratën e dhurimit të datës 24.7.2002, shtetasi P. T. i ka dhuruar pjesën e tij në bashkëpronësi të automjetit subjektit Gjergji Tako¹³⁸. Gjithashtu, rezulton se automjeti me targë *** figuron në pronësi të shtetasit Gjergji Tako me statusin “çregjistrim i përhershëm”. Sipas shkresës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ndodhet në dosjen e automjetit, dhe shkresës së Komisarariatit të Policisë Nr. ***¹³⁹, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017*, rezulton se automjeti me targë *** është vjedhur.

¹³⁵ Email datë 13.5.2020.

¹³⁶ Email datë 1.6.2020.

¹³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.1.2020.

¹³⁸ Sipas kartelës së mjetit të datës 3.10.2002 automjeti ka ndryshuar targën nga *** në ***.

¹³⁹ Në dosjen e administruar ndodhet shkresa nr. *** prot. e datës 24.3.2005 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë (protokolluar me nr. ***, datë 25.3.05) mbi të cilën është shënimi “Për veprim, datë 29.3.2005” me anë të së cilës kërkohet dosja e automjetit me targë ***, në pronësi të shtetasit Gjergji Tako me shënimin “(mjet i vjedhur)”. Në deklaratën *Vetting 2017* subjekti ka paraqitur shkresën e Komisarariatit të Policisë Nr. ***¹³⁹, drejtuar subjektit të rivlerësimit, që sqaron lidhur me kërkesën e tij për pajisjen me një kopje të kallëzimit penal që ka bërë pranë Komisarariatit të Policisë Nr. *** për mjetin e tij me targë *** materialet procedurale janë referuar me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2005, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal dhe nga ana e tyre nuk disponohet kopje e kallëzimit të bërë nga ana e tij, pasi nga oficerët e policisë gjyqësore nuk mbahen kopje të akteve procedurale.

3.8. Për sa i përket burimeve të ligjshme financiare, referuar analizës financiare kronologjike për periudhën janar 1997 – dhjetor 2004¹⁴⁰, në fund të muajit maj 2002¹⁴¹ rezultoi me balancë pozitive.

3.9. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë *** në vitin 2002.

4. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, me vlerë 5.100 euro**

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Automjet i markës “Mercedes-Benz” me targë ***, viti i krijimit 2005. Vlera: 5.100 euro*”. Si burim krijimi deklaroi: “*Hua e shtetas V. K. në masën 600.000 lekë¹⁴², tërheqje e babait P. 103.295 lekë nga kompensimin me 11% i parave të humbura tek “***”, të ardhurat vjetore të familjes baba-nënë-unë. Shtetasja V. K. i ka krijuar të ardhurat nga puna e saj e pandërprerë dhe pensionin e pandërprerë, si dhe nga puna e bashkëshortit jurist dhe nga puna e vajzës së saj G. K. si juriste*”. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁴³.

4.2. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip “Mercedes-Benz”, Klas ***, me vlerë 5.000 euro dhe pjesë takuese 100%*”. Si burim krijimi deklaroi pagën dhe shpërblimet në vlerën 1.162.088 lekë. Në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” deklaroi: “*Huamarrje shuma 600.000 lekë. Shuma e shlyer 50.000 lekë. Gjendje detyrimi 550.000 lekë*” dhe në seksionin “Të dhëna që nuk publikohen” deklaroi: “*Huamarrje shuma 600.000 lekë. Huadhënës shtetasja V. K.*”.

4.3. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2005 subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë automjet vetëm pagën dhe shpërblimet dhe në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar huan në shumën 600.000 lekë, por nuk ka deklaruar shkakun e saj (në formularin e deklarimit, përveç deklarimit të detyrimit, kërkohet edhe shkakun).

4.4. Në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar: “*Hua marrë nga i afërm në shumën 500.000 lekë, pa interes, fillimi 20.2.2005, pa datë mbarimi fikse*”. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 50.000 lekë + 50.000 lekë. Gjendje detyrimi: 400.000 lekë. Në seksionin “Të dhëna që nuk publikohen” ka deklaruar: “*Hua nga i afërm – tezja, V. K., e bija e S. dhe O., Tiranë*”.

4.5. Në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar huan sipas përshtimit në paragrafin e mësipërm. Shuma e shlyer: 100.000 lekë. Gjendje detyrimi: 300.000 lekë.

4.6. Për herë të parë subjekti e ka deklaruar qëllimin e përdorimit të kësaj huaje në DIPP-në e vitit 2008, ku ka deklaruar: “*Hua marrë nga i afërm për blerje të një automjeti, shuma është 500.000*”.

¹⁴⁰ Paraqitur në tabelën nr. 1 të këtij vendimi.

¹⁴¹ Kontrata e shitblerjes nr. *** mban datën 6.6.2002.

¹⁴² Në deklaratën *Vetting* 2017 ka deklaruar “Hua e shtetas V. K. në masën 6.000.000 lekë, e cila u reduktua brenda vitit deklarues 2005 në 5.000.000 lekë” dhe me anë të pyetësorit nr. 2 subjekti shpjegoi se shifrat 6.000.000 lekë dhe 5.000.000 janë lapsus teknik nga ana e tij në deklaratën *Vetting* 2017 dhe kjo vërtetohet pasi po në të njëjtën deklaratë, tek kapitulli “Detyrime financiare ndaj personave fizikë”, i ka shkruar shifrat në mënyrë korrekte 600.000 lekë dhe 500.000 lekë.

¹⁴³ Kontratë shitjeje datë 3.3.2005; leje e qarkullimit të automjetit me targë ***, në emër të z. Gjergji Tako; certifikatë pronësie e mjetit me targë ***, në emër të z. Gjergji Tako; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016; rezultatet e kërkimit RBS datë 11.10.2016; vërtetim nr. ***, datë 24.1.2017; njoftim debitimi në shumën 140.000 lekë, datë 24.10.2016, i Raiffeisen Bank; shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2006, e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtoria e Statistikës – QKID; deklaratë noteriale nr. ***, datë 21.3.2014; vërtetim datë 25.1.2017 nga Tirana Bank; librezë e kontributit të Sigurimeve Shoqërore për shtetasen V. K..

lekë; nuk ka interesa; data e fillimit 20.2.2005, pa datë mbarimi fikse”. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm: 150.000 lekë. Gjendje detyrimi: 150.000 lekë.

4.7. Nga shqyrtimi i DIPP-ve vjetore konstatohet se subjekti ka deklaruar shlyerjet si në vijim: 100.000 lekë në vitin 2005; 150.000 lekë në vitin 2006; 100.000 lekë në vitin 2007; 20.000 lekë në vitin 2009; 30.000 lekë në vitin 2011; 20.000 lekë në vitin 2012; 80.000 lekë në vitin 2013 (shlyerje e plotë).

4.8. Gjithashtu konstatohet se subjekti, në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të DIPP-ve të viteve 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018 ka deklaruar: “Hua e marrë nga tezja V. K., datë 20.2.2005”.

4.9. Në pyetësin standard¹⁴⁴, subjekti ka deklaruar: “Tezja ime V. K. ka financuar blerjen e automjetit me targë ***, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2005, në shumën 5.100 euro, në formën e një huaje pa interesa. Ky financim ka burim të ardhurat e saj si punonjëse në Bankën Qendrore të Shqipërisë, paga e punës si jurist e bashkëshortit të saj K. K., si nënkryetar i Gjykatës së Lartë, Kryetar i Gjykatës së Lartë dhe si avokat me detyrën e Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, paga e vajzës së saj G. K. pranë Tirana Bank nga viti 1998 e në vijim”.

4.10. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja¹⁴⁵ rezulton se sipas lejes së qarkullimit të lëshuar në datën 17.6.2004 nga vendi i origjinës (Gjermani), të përkthyer në shqip, automjeti me targë ***, me nr. shasie ***, i tipit “Daimler Benz”, është regjistruar në emër të shtetasës L. A. (L.). Më pas, me kontratën e shitjes datës 3.3.2005 (vërtetuar nënshkrimi nga noteri me nr. ***, datë 3.3.2005), subjekti ka blerë nga shtetasja L. A. (L.) automjetin e mësipërm, me targë ***, në shumën 5.100 euro. Në kontratë pasqyrohet se: “Pala blerëse i likuidoi palës shitëse shumën e mësipërme në prani të noteres dhe merr në dorëzim automjetin”.

4.11. Në dosjen e automjetit gjenden: (i) dokumenti i lëshuar nga komandanti i V.K.K. “****”, që vërteton se automjeti ka hyrë në P.K.K. “****” në datën 17.8.2006; (ii) deklarata doganore (data e palexueshme) e vitit 2006, ku pasqyrohet se shtetasit Gjergji Tako e L. L. kanë shlyer detyrimin doganor në shumën 186.528 lekë; (iii) leja e qarkullimit lëshuar në datën 13.11.2006.

4.12. Në përgjigje të pyetësin nr. 2¹⁴⁶, subjekti deklaroi se detyrimi doganor është shlyer nga vetë ai. Për rrjedhojë, kjo vlerë u pasqyrua në analizën financiare të vitit 2006.

4.13. DPPSH-ja¹⁴⁷ vuri në dispozicion të Komisionit raportin e hyrje-daljeve në territorin shqiptar të shtetasës L. N. A. (L.) për periudhën 1.5.2004 – 17.11.2021 dhe rezulton se në datën 3.3.2005 është regjistruar hyrja e saj në territorin shqiptar nëpërmjet linjës Trieste-Venecia KAD, nga Komisariati i Policisë i Portit të Durrësit. Lidhur me hyrjen në territorin shqiptar të automjetit me targë ***, DPPSH-ja¹⁴⁸ informon se: “Nga verifikimi në sistemin TIMS rezultoi se për automjetin tip “Mercedes-Benz” me targë ***, ka një regjistrim në territorin shqiptar, në datën 12.12.2004”.

¹⁴⁴ Përgjigje për pyetësin standard, protokolluar në Komision me nr. ***, prot., datë 31.1.2020.

¹⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2021.

¹⁴⁶ Email datë 2.3.2022.

¹⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2021.

¹⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 14.12.2021.

4.14. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Veprimet e subjektit për përdorimin e automjetit me targë *** për periudhën 3.3.2005 – 13.11.2006, pa leje qarkullimi dhe pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe me paraqitjen e një dokumenti të ndryshëm nga ai që administron DPPSH-ja lidhur me datën e hyrjes në territorin shqiptar të këtij automjeti, nuk është në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij*”.

4.15. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁴⁹, subjekti ka shpjeguar se mjeti nuk ka dalë në përdorim në rrugët publike, pasi ka qëndruar në oborrin e banesës së shtetasit N. J. për 2-3 muaj. Gjithashtu, shpjegon se ndaj shoqërisë dhe shtetit nuk ka shkaktuar asnjë dëm pasuror, pasi automjeti nuk është përfshirë në asnjë aksident për periudhën kur ishte i pa zhdoganuar (3.3.2005 – 17.8.2006) dhe ndaj tij nuk ka ngritur asnjë person padi civile për dëmshpërblim për periudhën 1.1.2004 – 1.1.2011. Gjithashtu, ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2022, të Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin në DPPSH¹⁵⁰, në të cilën shpjegohet se implementimi për regjistrimin e shtetasve dhe mjeteve në Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) për pikën e kalimit kufitar “***” ka filluar në datën 21.3.2007. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues¹⁵¹.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

4.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

4.17. Referuar legjisllacionit të kohës, ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të pandryshuar, rezulton se në nenin 92¹⁵² parashikohet se automjetet për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të DPSHTRR-së. Neni 93¹⁵³ parashikonte se në rastin e ndryshimit të pronësisë, brenda

¹⁴⁹ Email datë 21.4.2022.

¹⁵⁰ Inventar shtesë, protokolluar me nr. *** prot., datë 26.4.2022, pranë Komisionit.

¹⁵¹ Deklaratë e shtetasit N. J., vërtetuar nënshkrimi nga noter M. J. L., me nr. *** rep., datë 16.4.2022; vërtetimin nr. ***, datë 19.4.2022, i Komisarariatit Rajonal i Policisë Rrugore; vërtetimin datë 19.4.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁵² Kodi Rrugor, neni 92, parashikon: “1. Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”.

¹⁵³ Neni 93 parashikon: “1. Në rast ndryshimi pronësie të automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove ose në rastin kur i jepen në përdorim të tjerëve a kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, dega përkatëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e interesuar, brenda 10 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera, si dhe për lëshimin e certifikatës së re të pronësisë. 2. Zyra e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, sipas kërkesës së paraqitur nga pronari brenda afateve të përcaktuara në pikën 1, merr masa për rinovimin ose azhurnimin e lejes së qarkullimit që pasqyron ndryshimet e treguara në pikën e mësipërme. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe për ndryshimin e vendbanimit”.

10 ditëve nga nënshkrimi i aktit, në degën përkatëse të DPSHTRR-së bëhet ndryshimi i pronësisë. Në vijim, neni 130¹⁵⁴ parashikonte se automjetet e regjistruara në një shtet të huaj lejohet të qarkullojnë në Shqipëri për një periudhë maksimale 1-vjeçare, në bazë të dokumenteve të regjistrimit të shtetit të origjinës dhe lejes ndërkombëtare të qarkullimit, ndërsa për qytetarët që banojnë në Shqipëri dhe për personat juridikë me qendër në Shqipëri zbatohen dispozitat e nenit 93.

4.18. Në rastin konkret, nga hetimi administrativ kryesisht ka rezultuar se subjekti është vënë në posedim të automjetit në datën 3.3.2005, kur është nënshkruar kontrata e shitjes dhe është pajisur me leje qarkullimi nga DPSHTRR-ja në datën 13.11.2006. Gjithashtu rezulton se ka shlyer detyrimet doganore në shumën 186.528 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën e Departamentit për Kufirin dhe Emigracionin në DPPSH¹⁵⁵, në të cilën shpjegohet se implementimi për regjistrimin e shtetasve dhe mjeteve në Sistemin e Menaxhimit Total të Informacionit (TIMS) për pikën e kalimit kufitar “****” ka filluar në datën 21.3.2007.

4.19. Sa më sipër, Komisioni arsyeton se me shlyerjen e detyrimeve doganore dhe regjistrimin i automjetit pranë DPSHTRR-së, pavarësisht se me vonesë, subjekti i rivlerësimit ka treguar se nuk ka pasur si qëllim shmangien nga zbatimi i Kodit Rrugor dhe legjislacionit doganor. Si pasojë, Komisioni, duke marrë në konsideratë parimin e proporcionalitetit, vlerëson se parregullsia e konstatuar në zbatimin e Kodit Rrugor dhe legjislacionit doganor nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si shkak i vetëm që prodhon situatën e cenimit të besimit të publikut.

4.20. Në përfundim, Komisioni vlerëson se regjistrimi me vonesë i automjetit me targë *** pranë DPSHTTR-së do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin pasurisë.

Burimet e krijimit

i) Hua nga shtetasja V. K., në vlerën 600.000 lekë

4.21. Bazuar në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasja V. K. konsiderohet “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies së huas që ekziston ndërmjet tyre dhe të pranuar nga të dyja palët. Në këto kushte, Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, hetoi lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua.

4.22. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017¹⁵⁶ dhe në pyetësin nr. 1¹⁵⁷, rezulton se shtetasja V. K. në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.3.2014, deklaroi se është tezja e Gjergji P. Tako dhe në datën 20.2.2005 i ka dhënë hua pa interes dhe pa afat të caktuar shumën 500.000 lekë nipit Gjergji Tako dhe nga kjo shumë, deri në datën 1.1.2013, i kishte mbetur pa i kthyer vlerën 80.000 lekë, e cila i është kthyer gjatë vitit 2013.

¹⁵⁴ Neni 130 parashikon: “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot e regjistruara në një shtet të huaj dhe që i kanë kryer formalitetet doganore, kur këto janë të parashikuara, lejohet të qarkullojnë në Shqipëri për një periudhë maksimale njëvjeçare, në bazë të dokumenteve të regjistrimit të shtetit të origjinës dhe lejes ndërkombëtare të qarkullimit. 2. Për qytetarët që banojnë në Shqipëri dhe për personat juridikë me qendër në Shqipëri, zbatohen dispozitat e nenit 93”.

¹⁵⁵ Inventar shtesë, protokolluar me nr. *** prot., datë 26.4.2022, pranë Komisionit (shkresa nr. *** prot., datë 26.4.2022).

¹⁵⁶ Deklaratë noteriale nr. *** prot., nr. *** kol., datë 21.3.2014; vërtetim datë 25.1.2017, nga Tirana Bank.

¹⁵⁷ Email datë 13.5.2020.

Gjithashtu deklaroi se vlera e dhënë hua është shlyer totalisht, duke mos pasur asnjë pretendim financiar.

4.23. Në procesverbalin e datës 26.1.2016, të ILDKPKI-së¹⁵⁸, lidhur me pyetjen se cili është burimi i vlerës së dhënë hua nga shtetasja V. K. dhe sa është detyrimi deri në datë 31.12.2014, subjekti ka deklaruar se: “Burimi i shtetases V. K. është puna e saj dhe bashkëshortit K. K. ...Ndaj shtetases V. K. likuidimi është shlyer totalisht...”.

4.24. Në pyetësin nr. 1¹⁵⁹, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues për të ardhurat e shtetases V. K. (përfshirë edhe të vajzës së saj dhe/ose bashkëshortit të saj) për periudhën kur është dhënë huaja. Në përgjigje¹⁶⁰, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁶¹.

4.25. Për të verifikuar mundësitë e personit tjetër të lidhur, znj. V. K., për dhënien e huas prej 600.000 lekësh në datën 2.2.2005, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2000 – 2004 për të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj shtetaseje dhe vajzës së saj G. K., në kushtet e mungesës së informacionit për të ardhurat e të ndjerit, bashkëshortit të V. K., shtetasit K. K., i cili ka ndërruar jetë në shkurt të vitit 1999.

4.26. Referuar dokumentacionit të administruar, të ardhurat nga paga pranë Bankës së Shqipërisë të shtetases V. K.¹⁶² kanë qenë në shumën 2.324.451 lekë, të ardhurat nga paga pranë Tirana Bank të shtetases G. K.¹⁶³ kanë qenë në shumën 4.295.793 lekë dhe shpenzimet jetike për këtë periudhë për dy persona kanë qenë në shumën 995.184 lekë. Si pasojë, rezulton se personi i lidhur V. K. ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas.

4.27. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi i lidhur V. K. ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në shumën 600.000 lekë.

4.28. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetaset V. K. dhe G. K.¹⁶⁴ dhe nga hetimi nuk rezultoi se në emër të këtyre shtetasve të jetë regjistruar procedim penal dhe nuk ka fashikuj procedimi, përfshirë ato të mosfilluara, pushuara apo pezulluara¹⁶⁵.

*ii) Tërheqje e shumës 103.295 lekë nga kompensimi i parave të humbura tek shoqëria “***”*

4.29. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, konkretisht referuar mandatpagesës nr. *, kreditorët e shoqërisë “***”, lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare, vlera**

¹⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2021.

¹⁵⁹ Email datë 13.5.2020.

¹⁶⁰ Email datë 1.6.2020.

¹⁶¹ Vërtetim datë 27.5.2020, i Tirana Bank; kërkesë e datës 27.5.2020, e shtetases V. K..

¹⁶² Referuar kreditimeve në llogarinë në Tirana Bank, pagesa e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat e konfirmuar me shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2022, DRSSH Tiranë, Arkivi Qendror Lundër dhe vërtetim nr. *** 25.1.2017 lëshuar nga Tirana Bank, paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017.

¹⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021.

¹⁶⁴ Nga dokumentacioni i administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁶⁴ rezulton se në ngarkim të shtetases G. K. është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, datë 26.4.2013, për konsumimin e veprave penale “shkatërrim prone”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe “vetëgjyqësi”, të parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Ky procedim pena është ndjekur nga prokurori E. K., i cili me vendimin e datës 17.5.2013 ka vendosur mosfillimin e materialit kallëzues.

¹⁶⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 4.10.2021 dhe nr. *** prot., datë 28.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë; shkresat nr. *** prot., datë 26.10.202 dhe nr. *** prot., datë 31.1.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

103.295 lekë është tërhequr në datën 2.8.2005, pra pas datës së lidhjes së kontratës, më 3.3.2005. Për rrjedhojë, shuma e tërhequr nga BKT-ja prej babait të subjektit si kreditor i shoqërisë “***”, nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e automjetit dhe, për këtë arsye, nuk u morën në konsideratë në analizën financiare.

iii) Të ardhurat vjetore të familjes (babai, nëna dhe subjekti) deri në datën 3.3.2005

4.30. Komisioni kreu analizën financiare në datën 3.3.2005 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për pasuritë, detyrimet, të ardhurat e shpenzimet për subjektin e rivlerësimit, nga ku rezultoi me balancë pozitive në shumën 117.250 lekë.

4.31. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, në vlerën 5.100 euro.

5. Automjet tip “Volkswagen Golf 2”, në vlerën 90.000 lekë

5.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Volkswagen Golf 2”, viti i krijimit 2005, me vlerë 90.000 lekë. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat vjetore të familjes në tërësi dhe mbyllja e një depozite bankare nga ana e tij në Tirana Bank. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁶⁶.

5.2. Në pyetësin nr. 1¹⁶⁷, subjekti ka deklaruar: “*Automjeti i markës “Volkswagen Golf 2” nuk është regjistruar pranë autoriteteve për pamundësi financiare. Ky automjet është bllokuar nga policia në datën 20.10.2010... dhe në datën 1.9.2014 ka kaluar në pronësi të Rezervave të Shtetit në Lundër”.*

5.3. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 rezultoi se subjekti, me kontratën nr. ***, datë 14.12.2005, ka blerë nga shtetasi Sh. Ç.¹⁶⁸ automjetin tip “Volkswagen”, pa targa, kundrejt vlerës 90.000 lekë. Në kontratën e shitjes pasqyrohet: “*Blerësi të bëjë zhdoganimin dhe regjistrimin e mjetit*”. Në dokumentacionin e administruar nga noteri I. H.¹⁶⁹ rezultoi se bashkëlidhur kontratës gjendet dokumenti “*Vërtetim hyrje*”, i datës 4.9.2005, i Doganës, në emër të shtetasit Sh. Ç., ku pasqyrohet se automjeti me targë *** është i destinuar për qëndrim të përkohshëm.

5.4. Për sa i përket analizës financiare, duke konsideruar se automjeti është blerë në datën 14.12.2005 dhe duke mos pasur një periudhë të saktë se kur mund të jetë kryer shlyerja e detyrimit ndaj shtetasës V. K., Komisioni vlerësoi që ta kryejë analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet e subjektit të rivlerësimit në fund të vitit kalendarik, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti.

5.5. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës

¹⁶⁶ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2005; prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.12.2004; librezë mjeti me vit prodhimi 1986, italisht, bashkë me përkthimin shqip; certifikatë pronësie e mjetit italisht bashkë me përkthimin shqip.

¹⁶⁷ Email datë 1.6.2020.

¹⁶⁸ Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga znj. E. M.

¹⁶⁹ Shkresë datë 18.2.2022.

me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Veprimet e subjektit për përdorimin e automjetit me targë ***, pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe pa paguar detyrimet doganore, nuk janë në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij.*

5.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁷⁰, subjekti ka shpjeguar se automjeti ka qëndruar në banesën e shtetasit S. T. dhe se nuk ka qenë përdoruesi efektiv i tij, por ky shtetas. Për vërtetimin e deklaramenteve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁷¹.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

5.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaramentet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting 2017*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramentet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

5.8. Referuar arsytimit të pasqyruar në paragrafin 4.17, Komisioni arsyeton se Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i pa ndryshuar, në nenin 92 parashikonte se automjetet për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të DPSHTRR-së dhe në nenin 93 parashikonte se në rastin e ndryshimit të pronësisë, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i aktit, në degën përkatëse të DPSHTRR-së bëhet ndryshimi i pronësisë.

5.9. Gjithashtu, referuar ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 8¹⁷² përcaktohet se detyrimi që ka një person për të paguar shumën e detyrimeve të importit përkufizohet si borxh doganor. Neni 103¹⁷³ parashikonte se mallrat jo shqiptare të vendosura në qarkullim të lirë i nënshtrohen pagesës së importit. Në vijim, neni 216¹⁷⁴ përcaktonte se borxhi doganor i importit lind nëpërmjet vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të importit, ndërsa neni 217¹⁷⁵ parashikonte se debitor është personi që blen ose mban mallrat në fjalë dhe që në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave ishte në dijeni ose objektivisht duhej të dinte që ato ishin futur në mënyrë të paligjshme.

¹⁷⁰ Email datë 21.4.2022.

¹⁷¹ Shkresë nr. *** prot., datë 2.6.2020, e Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore; deklaratë noteriale nr. ***, datë 11.4.2022, e shtetasit S. T..

¹⁷² Kodi Doganor (1999), neni 8, parashikon: “9. “Borxh doganor” do të thotë: detyrimi që ka një person për të paguar shumën e detyrimeve të importit (borxh doganor importi) ose shumën e detyrimeve të eksportit (borxh doganor eksporti), që zbatohen për mallra të caktuara sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁷³ Kodi Doganor 1999, neni 103, parashikon: “Vendosja në qarkullim të lirë u jep mallrave joshqiptare statusin doganor të mallrave shqiptare. 2. Kjo sjell zbatimin e masave të politikës tregtare, kryerjen e formaliteteve të tjera të parashikuara për importimin e mallrave, si edhe pagesën e detyrimeve të importit”.

¹⁷⁴ Neni 216 parashikon: “1. Borxhi doganor i importit lind nëpërmjet: (a) vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të importit...”.

¹⁷⁵ Neni 217 parashikon: “2. Borxhi doganor lind në çastin kur mallrat futen në mënyrë të paligjshme. 3. Debitorët janë: (a) personi që i fut këto mallra në mënyrë të paligjshme; (b) çdo person që merr pjesë në futjen e paligjshme të mallrave dhe që ka dijeni ose objektivisht duhet të dijë që kjo hyrje është e paligjshme; dhe (c) çdo person që blen ose mban mallrat në fjalë dhe që, në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të dinte që ato ishin futur në mënyrë të paligjshme”.

5.10. Në rastin konkret rezulton se subjektit të rivlerësimit i ka kaluar pronësia mbi automjetin tip “Volkswagen Golf”, me kontratën nr. ***, datë 14.12.2005 dhe në zbatim të nenit 93 të Kodit Rrugor kishte detyrimin për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë pranë DPSHTRR-së.

5.11. *Lidhur me përdorimin e këtij automjeti*, rezulton se subjekti ka paraqitur në përgjigje të rezultateve të hetimit shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2020, të Komisarariatit Rajonal të Policisë Rrugore, me anë të së cilës ka sqaruar se automjeti tip “Volkswagen”, modeli “Golf”, rezulton i bllokuar nga “Shërbimet për mbikëqyrjen e autostradave”, në datën 20.10.2010 dhe se procesverbali i konstatimit të shkeljes është plotësuar në emër të shtetasit S. T. për mungesë dokumentacioni të mjetit dhe pas plotësimit të afatit të qëndrimit në pikën e ruajtjes ky mjet është transferuar në Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit.

5.12. Sa më sipër, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka provuar se pavarësisht se i kishte kaluar pronësia me kontratën nr. ***, datë 14.12.2005, nuk ishte përdorues i automjetit tip “Volkswagen Golf 2”, por shtetasi S. T., dhe ishte ky i fundit që ka përdorur një automjet pa u pajisur me leje qarkullimi dhe pa shlyer detyrimet doganore.

5.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin për regjistrimin pranë DPSHTRR-së të ndryshimit të pronësisë së automjetit tip “Volkswagen Golf,” mangësi e cila do të vlerësohet në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin pasurisë.

6. Automjet tip “Mercedes-Benz” me targë *, në vlerën 200.000 lekë**

6.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, me çmim blerjeje 200.000 lekë. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat e bashkëshortes, e punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Rurale. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁷⁶.

6.2. Në DIPP-në e vitit 2016, ka deklaruar: *“Blerje automjeti me targë ***, me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016. Origjina janë të ardhurat nga paga e bashkëshortes. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa takuese: 100%”*.

6.3. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja¹⁷⁷, paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezulton se me urdhrin nr. *** prot., datë 30.3.2009, të ministrit të Brendshëm janë transferuar pa pagesë në Prokurorinë e Përgjithshme 3 automjete të konfiskuara me vendime gjyqësore, ndërmjet të cilëve edhe automjeti tip “Mercedes-Benz” me targë ***. Më pas rezultoi se Prokuroria e Përgjithshme e ka transferuar automjetin tek Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila më pas ka kërkuar nga DPSHTRR-ja ndryshimin e targës¹⁷⁸.

¹⁷⁶ Kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.10.2016; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.9.2014; kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2010; leje qarkullimi e automjetit; mandat nga Credins Bank, datë 18.10.2016; kopje e noterizuar e librezës së punës të shtetasës M. D.; urdher nr. ***, datë 26.7.2016, i Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

¹⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021.

¹⁷⁸ Kërkesë datë 2.4.2009.

6.4. Prokuroria e Përgjithshme, bazuar në ankandin e zhvilluar, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.5.2010, e ka shitur këtë automjet tek shtetasi G. Xh. (subjekt rivlerësimi) kundrejt vlerës 150.000 lekë. Më pas, ky shtetas e ka shitur automjetin tek shtetasi B. N. kundrejt vlerës 1.700 euro¹⁷⁹ dhe ky i fundit ia ka shitur shtetasit G. P. kundrejt vlerës 1.000 euro¹⁸⁰. Në vijim, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.10.2016 (të administruar edhe nga notere E. S. B.¹⁸¹), shtetasi G. P. e ka shitur automjetin e mësipërm tek subjekti i rivlerësimit kundrejt çmimit të shitjes prej 200.000 lekësh. Në kontratë parashikohet se çmimi i shitjes do të likuidohet nëpërmjet bankës në llogarinë e shitësit.

6.5. Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 lëvizjen e llogarisë së shtetases M. D. pranë Credins Bank për periudhën 31.7.2016 – 23.1.2017, ku evidentohet një transfertë në favor të shtetasit G. P. në datën 18.10.2016¹⁸², në shumën 200.000 lekë, me përshkrimin “Pagesë për blerje automjeti, bashkëshorti Gjergji Tako”. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me punësimin e shtetases M. D. (T.)¹⁸³.

6.6. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të shtetases M. T. përpara martese rezultoi se ajo ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e automjetit në vlerën 200.000 lekë.

6.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e automjetit në vlerën 200.000 lekë.

7. Automjet tip “Mercedes-Benz” me targë *, me vlerë 135.000 lekë**

7.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa origjinale ***, me çmim blerjeje 135.000 lekë, i cili është plotësisht jashtë funksionit e përdorimit. Si burim krijimi deklaron të ardhurat e bashkëshortes e punësuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Drejtorisë së ALUIZNI-t, Tirana Rurale. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin provues¹⁸⁴.

7.2. DPSHTRR-ja¹⁸⁵ informon se automjeti me targë *** nuk figuron i regjistruar.

7.3. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 rezulton se sipas dokumentit “urdhër çlirimi” të Drejtorisë së Doganave, shoqëria “****” sh.p.k. figuron në cilësinë e “deklaruesit” dhe shtetasi E. A. në cilësinë e “marrësit” dhe sipas deklaratës doganore të datës 7.9.2016, kjo shoqëri ka paguar detyrimin doganor në shumën 88.525 lekë.

¹⁷⁹ Kontratë shitjeje nr. ***, datë 8.9.2014.

¹⁸⁰ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 19.1.2015.

¹⁸¹ Shkresë datë 3.9.2021.

¹⁸² Data e martesës 2.9.2016.

¹⁸³ Kopje e noterizuar e librezës së punës; urdhër nr. ***, datë 26.7.2016, e ALUIZNI-t “Për emërimin në detyrë të znj. M. D.”, sipas të cilit znj. M. D. emërohet arkivist/protokollist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve mbështetëse në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana Rurale.

¹⁸⁴ Veprim juridik, aktmarrëveshje për shitblerje automjeti datë 12.10.2016; vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 12.10.2016, për letërnjoftimin e shtetasit Gjergji Tako; vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 12.10.2016, pasaportën biometrike të shitësit E. A.; vërtetim i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 21.1.2017, bashkëngjitur urdhërçlirimi nga ***, mandat datë 18.10.2016, i Credins Bank; ekstrakt i lëvizjeve të llogarisë bankare pranë Credins Bank, e shtetases M. D.; deklaratë mbi burimin e fondeve nga shtetasja M. D.

¹⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021.

7.4. Në dokumentin “veprim juridik”, aktmarrëveshje (për shitblerje automjeti) e datës 12.10.2016, përcaktohet: “...z. E. A. i shet z. Gjergji Tako automjetin e markës, me targa të origjinës, tashmë të çregjistruara, ***, me nr. shasie ***, viti i prodhimit 1998... Çmimi i shitjes do të jetë 135.000 lekë”. Në kontratë parashikohet që pagesa do të bëhet nëpërmjet bankës në llogarinë e shitësit pranë Raiffeisen Bank.

7.5. Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 lëvizjen e llogarisë së shtetasës M. D. pranë Credins Bank, për periudhën 31.7.2016 – 23.1.2017, ku evidentohet një transfertë në favor të shtetasit E. A., në datën 18.10.2016, shumën 135.000 lekë, me përshkrimin “Pagesë për blerjen e automjetit nga bashkëshorti Gjergji Tako nga E. A.”. Kjo shumë është përdorur nga teprica e llogarisë së bashkëshortes në datën 1.9.2016, në vlerën 605.596 lekë (përpara lidhjes së martesës dhe fillimit të jetesës së përbashkët), tepricë e cila është analizuar në seksionin e pasurive të personit të lidhur, bashkëshortes.

7.6. Me anë të pyetësorit nr. 1¹⁸⁶, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte se përse nuk e kishte regjistruar këtë automjet pranë autoriteteve shqiptare dhe se cila është situata aktuale e automjetit. Në përgjigje¹⁸⁷ subjekti ka deklaruar: “Automjeti tip “Mercedes-Benz” i blerë në vitin 2016 në vlerën 135.000 lekë është blerë në gjendje jo të aftë për punë dhe me qëllim për t’u përdorur për pjesë këmbimi në funksion të automjetit me targë ***, i cili është ekzaktësisht i të njëjtit model. Aktualisht ky automjet është shitur për skrap në vlerën 50.000 lekë, sipas faturës tatimore nr. ***, datë 4.5.2018 tek subjekti S. N., me NIPT”.

7.7. Bashkëlidhur ka paraqitur fotokopje të faturës me nr. serie ***, nr. ***, datë 4.5.2018, të përgatitur nga blerësi, në të cilën figuron shitës Gjergji Tako dhe blerës S. N., me përshkrimin “Blerje autoveturë Mercedes-Benz s. 140”, me çmim 50.000 lekë. Gjithashtu, ka paraqitur kopje të dokumentit “deklaratë midis palëve”, të datës 4.5.2018, ku deklaruesi S. N. deklaroi se ka rënë dakord për shitblerjen e automjetit me pronar Gjergji Tako, me nr. shasie ***, vit i prodhimit 1998, për një vlerë totale prej 50.000 lekësh, i cili ishte jashtë funksionit, i prishur dhe do të përdorej për pjesë këmbimi.

7.8. Subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së¹⁸⁸ prokurën e posaçme nr. ***, datë 8.10.2012, të shtetasit E. A., në të cilën ky i fundit ka deklaruar se është pronar i automjetit tip “Mercedes-Benz 140”, me targë ***, viti i prodhimit 1998 dhe autorizon shtetasin Gjergji Tako të administrojë dhe përdorë këtë automjet.

7.9. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri në përdorim, pasi nga hetimi rezulton se subjekti e ka poseduar me të drejta të plota sikur të ishte pronar këtë automjet që nga viti 2012; (ii) referuar konstatimit në pikën më lart, duket se vetë veprimet e subjektit për përdorimin e këtij automjeti për një periudhë afërsisht 4-

¹⁸⁶ Email datë 13.5.2020.

¹⁸⁷ Email datë 1.6.2020.

¹⁸⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 22.9.2021.

vjeçare, pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe pa paguar detyrimet doganore, nuk janë në përputhje me etikën e një magjistrati jashtë ushtrimit të funksionit të tij.

7.10. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁸⁹, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.4.2022, të shtetasit E. A., i cili deklaroi se automjetin në fjalë e ka blerë për nevoja personale dhe nuk ka arritur ta zhdoganojë, për shkak se disa ditë pas blerjes pësoi defekt të rëndë dhe nuk mund të lëvizte dot. Gjithashtu, ky shtetas deklaroi se tagrat e dhëna prej tij në prokurën nr. ***, datë 8.10.2012, nuk u realizuan, përveç dy-tre rasteve kur automjeti ka lëvizur për efekt testimi për rregullim defekti, i cili nuk u rregullua dhe gjendja mbeti njësoj deri në shitjen përfundimtare për pjesë këmbimi. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin e zhdoganimit të automjetit dhe kopje të kontratës noteriale nr. ***, datë 15.10.2008, të blerjes së këtij automjeti nga shtetasi E. A., si dhe dokumentacionin e blerjes në Itali.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.11. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

7.12. *Lidhur me konstatimin e Komisionit se e ka poseduar me të drejta të plota sikur të ishte pronar këtë automjet që nga vitit 2012*, subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit ka paraqitur kontratën noteriale “shitje automjeti”, nr. ***, datë 15.10.2008, të lidhur ndërmjet shtetasit B. K., në cilësinë e shitësit dhe shtetasit E. A. në cilësinë e blerësit, me objekt “Shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” me nr. shasië ***, vit prodhimi 1998, kundrejt çmimit 5.500 euro”. Pra, subjekti i rivlerësimit ka provuar se pronar i këtij automjeti është shtetasi E. A..

7.13. *Lidhur me konstatimin se ka përdorur automjetin e mësipërm për një periudhë 4-vjeçare, pa leje qarkullimi, pa e regjistruar në degën përkatëse të DPSHTRR-së, si dhe pa paguar detyrimet doganore*, rezulton se në dokumentin “veprim juridik”, akt marrëveshje (për shitblerje automjeti), e datës 12.10.2016, përcaktohet: “...z. E. A. i shet z. Gjergji Tako automjetin e markës, me targa të origjinës, tashmë të çregjistruara, *** ...”. Në kuptim të përmbajtjes së këtij dokumenti, palët në marrëveshje kanë parashikuar se automjeti është i çregjistruar, pra është jashtë qarkullimit. Si pasojë vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka blerë një automjet jashtë qarkullimit.

7.14. Gjithashtu, nga hetimi administrativ rezulton se automjeti me targë *** është i njëjti model me automjetin me targë ***, të analizuar në pikën 6¹⁹⁰ dhe në deklaratën e datës 4.5.2018 shtetasi S. N. (blerësi i automjetit) ka deklaruar se ka rënë dakord për shitblerjen e automjetit me pronar Gjergji Tako, me nr. shasië ***, vit prodhimi 1998, për një vlerë totale prej 50.000 lekësh, i cili ishte jashtë funksionit, i prishur dhe do të përdorej për pjesë këmbimi.

¹⁸⁹ Email datë 21.4.2022.

¹⁹⁰ Automjet tip “Mercedes-Benz”, klasi ***, viti i prodhimit 1998.

7.15. Sa më sipër, Komisioni krijon bindjen se automjeti tip “Mercedes Benz,” me targë ***, për periudhën nga viti 2012, deri në lidhjen e aktmarrëveshjes (për shitblerje automjeti), të datës 12.10.2016, nuk ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe se ka provuar që ky automjet ka qenë jashtë funksionit.

7.16. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie, duke plotësuar kriteret e parashikuara nga shkronja “a” e pikës 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

8. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë *, në përdorim**

8.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz”, në përdorim, me targë ***, vit prodhimi 2016, me nr. shasie ***. Si burim krijimi deklaracion autorizimin e datës 27.10.2016, të Prokurorisë Tiranë. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁹¹.

8.2. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 rezulton se me shkresën nr. *** prot., datë 27.9.2013, SHISH informon Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kthimin pranë ambienteve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***. Më pas, me autorizimin datës 27.10.2016, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka autorizuar prokurorin Gjergji Tako të përdorë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë ***, për nevoja pune dhe emergjenca shëndetësore familjare, nga data 27.10.2016 e në vijim, deri në një vendimmarrje të dytë.

8.3. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika mbi këtë pasuri, që lidhet me procesin e rivlerësimit.

9. Automjet tip “Alfa Romeo”, me targë *, në përdorim**

9.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjetin tip “Alfa Romeo”, me targë ***, me të drejtë përdorimi. Nuk ka deklaruar burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues¹⁹².

9.2. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (të administruar edhe nga noter M. L.¹⁹³) rezulton se sipas kontratës për huapërdorje nr. ***, datë 28.11.2010, huadhënësi S. T. i jep në përdorim huamarrësit Gjergji Tako automjetin tip “Alfa Romeo”, me targë ***, i cili është në pronësi të shtetasit A. S.. Bashkëlidhur kontratës gjendet kopja e lejes së qarkullimit të automjetit me targë ***, në emër të shtetasit A. M. S.. Gjithashtu rezulton se me anë të prokurës nr. ***, datë 5.11.2010, shtetasi A. S. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm shtetasin S. T., duke i dhënë të drejta të plota që automjetin tip “Alfa Romeo 930”, me targë ***, ta përdorë, ta japë në huapërdorje dhe ta shesë duke caktuar çmimin e shitjes.

¹⁹¹ Autorizimi i datës 27.10.2016, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. *** prot., datë 27.9.2013, e SHISH; procesverbal për marrjen e dokumenteve, datë 23.9.2013, i Prokurorisë panë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁹² Kontratë huapërdorjeje nr. *** prot., nr.***, datë 28.11.2010; leje qarkullimi të automjetit në emër të shtetasit A. M. S.

¹⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2021.

9.3. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasit A. M. S. dhe S. T.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁹⁴ informon se për shtetasin A. S. është marrë vendimi i pushimit të akuzës, në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2011 (2010), i cili është bashkuar me procedimin penal nr. ***, viti 2010 dhe dosja penale është pezulluar dhe ndodhet në Drejtorinë e Policisë Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁹⁵ informon Komisionin se dosja hetimore nr. *** e vitit 2010 është kërkuar nga Gjykata për efekt të gjykimit të kërkesës penale nr. *** akti, datë regjistrimi 25.7.2011, e përfunduar me vendimin e datës 24.9.2012 të gjykatës që ka vendosur pushimin e gjykimit dhe nga verifikimet e kryera rezulton se dosja gjyqësore nr. ***, datë 24.9.2012, është transferuar në arkivin qendror të sistemit gjyqësor në Lundër.

9.4. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2012, 2013 e 2014, të drejtën e përdorimit të automjetit tip “Alfa Romeo” me targë ***, në kundërshtim me nenin 4, shkronja “b” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, të ndryshuar me ligjin nr. 85/2012.*

9.5. Në përgjigje të rezultateve të hetimit¹⁹⁶, subjekti shpjegon se ka një dallim të qartë në formularin e deklarimeve periodike në vite dhe formularit të deklaratës *Vetting* 2017, ku kjo e fundit në mënyrë të qartë kërkon që sendet në përdorim të deklarohen. Gjithashtu, subjekti i referohet vendimit nr. ***, datë 15.12.2020, të Kolegjit, në të cilin arsyetohet se subjektet deklarues nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim.

9.6. Më pas, me anë postës elektronike¹⁹⁷, subjekti i rivlerësimit i ka përcjellë Komisionit kopje të vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2010, në ngarkim të shtetasit A. S. dhe në datën 2.6.2022¹⁹⁸ paraqiti pranë Komisionit parashtrime dhe prova lidhur me vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, viti 2010, në ngarkim të shtetasit A. S..

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyetohet se:

9.8. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se Komisariati i Policisë Nr. *** Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.5.2022, ka informuar në lidhje me ngjarjen e datës 23.12.2009, ku shtetasi L. Sh. ka pasur konflikt me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe

¹⁹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 31.3.2022.

¹⁹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 1.6.2022.

¹⁹⁶ Email datë 21.4.2022.

¹⁹⁷ Email datë 28.5.2022.

¹⁹⁸ Parashtrime shtesë dhe prova (nr. *** prot., datë 2.6.2022, në Komision).

ka paraqitur kallëzim penal ndaj shtetasit A. S., i datëlindjes 1.7.1957, lindur në Krujë dhe banues në rrugën “***”. Në vijim, rezulton se Komisariati i Policisë Nr. *** Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 29.12.2009, i ka përcjellë Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë formularët ***, bashkëlidhur të cilëve konstatohen të dhënat nga sistemi TIMS për shtetasin A. H. S., i datëlindjes 1.7.1957. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur kopje të vendimit të datës 2.5.2011, për pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2010.

9.9. Komisioni konstaton se sipas prokurës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.11.2010, të administruar nga noteri M. L.¹⁹⁹, pronar i automjetit tip “Alfa Romeo 930”, me targë *** është shtetasi A. M. S., i datëlindjes 25.7.1981, ndërsa sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, procedimin penal nr. ***/2010 është regjistruar në emër të shtetasit A. H. S., i datëlindjes 1.7.1957.

9.10. Sa më sipër, nga krahasimi i të dhënave të gjendjes civile vërtetohet se shtetasi A. S., ndaj të cilit është regjistruar procedimi penal nr. ***/2010, nuk është i njëjti person me shtetasin A. S., pronar i automjetit tip “Alfa Romeo 930”, me targë ***.

9.11. Lidhur me konstatimin për mosdeklarim të së drejtës për përdorimin e automjetit tip “Alfa Romeo” me targë ***, Komisioni, bazuar edhe në praktikën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit²⁰⁰, vlerëson se detyrimi për të deklaruar pasuritë e paluajtshme në përdorim dhe zotërim të subjekteve rivlerësuese është përcaktuar në mënyrë të shprehur për herë të parë në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

9.12. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjekti është i saktë në përputhje me ligjin dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

10. Automjet tip “Opel Astra G”, me targë *, në përdorim të subjektit, në pronësi të bashkëshortes**

10.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar automjet tip “Opel Astra G”, me targë ***, me të drejtë përdorimi sipas prokurës nr. ***, datë 9.3.2012. Si burim krijimi deklaroi prokurën nr. ***, datë 9.3.2012. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁰¹.

10.2. Sipas prokurës së posaçme nr. ***, datë 9.3.2012, të dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezulton se shtetasja M. D. i jep në përdorim Gjergji Takos dhe S. T. të përdorin së bashku ose veç e veç, për një afat të papërcaktuar kohor, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, automjetin tip “Opel Astra G”, me targë ***.

¹⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.10.2021.

²⁰⁰ Vendim nr. ***, datë 15.12.2020.

²⁰¹ Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.3.2012.

10.3. DPGJC-ja²⁰² informon se shtetasja M. D. (T.) ka lidhur martesën në datën 2.9.2016 me subjektin Gjergji Tako dhe si pasojë, në cilësinë e “personit të lidhur”, ka plotësuar deklaratën *Vetting* 2017.

10.4. Me anë të pyetësorit nr. 1²⁰³, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegonte lidhjen e tij me znj. M. D. në vitin 2011, duke marrë parasysh faktin se ajo i ka dhënë një autorizim me disa tagra (të drejtë përdorimi, për ta shitur) atij dhe kushëririt të tij disa muaj pas blerjes. Në përgjigje,²⁰⁴ subjekti deklaroi: “*Në vitin 2011 shtetasja M. D. ka qenë në marrëdhënie të afërta shoqërore me mua (e dashur...) dhe ajo ka dhënë autorizimin për mua dhe kushëririn tim në mënyrë që unë dhe kushëririn im të ishim plotësisht brenda kuadrit ligjor të kohës përpara punonjësve të Policisë Rrugore në rast se do të gjendeshim në drejtim të automjetit në raste emergjente apo edhe në drejtim të zakonshëm të automjetit. Gjithashtu janë dhënë tagrat për të shitur automjetin në mënyrë që unë dhe kushëririn im të merreshim me gjetjen e klientëve dhe të komunikojmë me ta në rast se M. D. do të vendoste ta shiste automjetin, pra për komoditet të pronares së automjetit”.*

10.5. Burimi financiar i krijimit të këtij automjeti është trajtuar në pasuritë e deklaruara nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. T..

KONSTATIME TË TJERA

11. Kontrata nr. *, datë 24.6.2009, për prenotim apartamenti, paguar shuma 11.800 euro**

11.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka paraqitur kontratë premtim shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2009, të lidhur ndërmjet shtetasit G. L. në cilësinë e shitësit dhe subjektit Gjergji Tako në cilësinë e blerësit. Në këtë kontratë përcaktohet se shitësi, në bazë të aktmarrëveshjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2007, të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., nga 1/3 e 1% e sipërfaqes së përgjithshme e objektit që do të ndërtohet nga shoqëria “****” sh.p.k. në pronën e shoqërisë “****” sh.p.k., të përllogaritur rreth 120 m², do t’i shesë subjektit 60 m² bashkë me sipërfaqet e përbashkëta me çmimin 19.800 (euro), kundrejt një kapari prej 10.800 euro. Pjesa e mbetur 9.000 euro do të likuidohet menjëherë me daljen e lejes së ndërtimit.

11.2. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2²⁰⁵, subjekti ka paraqitur deklaratat noteriale të shtetasit G. L., ku: (i) në deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2009, deklaroi: “...në vijim të kontratës për premtim shitje nr. ***, datë 24.6.2009, mora nga z. Gjergji Tako shumën prej 1.000 euro, si pjesë e çmimit për shitjen e një apartamenti me sipërfaqe rreth 60 m², bashkë me sipërfaqet e përbashkëta, duke mbetur pa likuiduar edhe 8.000 euro nga vlera totale e kësaj shitjeje...”; (ii) në deklaratën noteriale nr. ***, datë 27.3.2010, ka deklaruar: “...z. Gjergji Tako më ka paguar shumën prej 11.800 euro në dy këste. Meqenëse shoqëria ndërtuese nuk arriti të nxjerrë lejen e ndërtimit brenda periudhës së përcaktuar në kontratë, unë G. L. i njoh z. Gjergji Tako detyrimin për shumën 11.800 euro, të cilën do t’ia kthej brenda datës 20.4.2010. Në rast se nga ana ime

²⁰² Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021.

²⁰³ Email datë 13.5.2020.

²⁰⁴ Email datë 1.6.2020.

²⁰⁵ Email datë 2.3.2022.

shuma si më lart prej 11.800 euro nuk do të kthehet brenda këtij afati jam dakord që kjo deklaratë të shërbejë si titull ekzekutimi pranë Zyrës së Përmbartimit sipas Kodit të Procedurës Civile”.

11.3. Me anë të pyetësorit nr. 1²⁰⁶, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se përse transaksioni nuk është përfunduar, çfarë ka ndodhur me apartamentin e porositur dhe nëse shitësi e ktheu parapagimin. Në përgjigje²⁰⁷, subjekti ka deklaruar: *“Apartamenti nuk u ndërtua kurrë. Shitësi nuk e ktheu kurrë parapagimin”*. Bashkëlidhur ka paraqitur dokumentacionin përkatës²⁰⁸.

11.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit rezulton se sipas vendimit nr. *** akti, datë 20.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, subjekti ka paraqitur kërkesë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2010. Në përfundim, Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Në këtë vendim pasqyrohet shënimi se Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 1.12.2010, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 20.5.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pranimin e kërkesës. Lëshimin e urdhrin për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2010, të lëshuar nga deklaruesi G. L., para noterit R. K.”*.

11.5. Referuar vendimit nr. ***, datë 3.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmbartuesi gjyqësor A. P. ka kërkuar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit G. L., pasi është vërtetuar se ky shtetas ka ndërruar jetë në datën 8.2.2012. Gjykata ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të shtetasit G. L., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të tij “R. L., bashkëshortja, M. L., i biri, M. L., e bija”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 18.10.2013, pasi nuk është ankimuar.

11.6. Në vijim, përmbartuesi gjyqësor ka lëshuar kërkesën për paraqitje me nr. *** prot., datë 27.5.2014, drejtuar shtetasit R. L., duke kërkuar paraqitjen e saj në datën 4.6.2014 pranë zyrës së tij. Sipas procesverbalit të datës 10.6.2014, të nënshkruar vetëm nga përmbartuesi dhe kreditori Gjergji Tako, pasqyrohet se: *“...Nga ana e palës kreditore u dakordësua se nëse nga ana e trashëgimtarës shlyhet shuma prej 6.000 euro atëherë të bëhet pushimi i ekzekutimit edhe nëse paguhet me këste në masën 5.000 lekë. Në rast të kundërt, të vijojnë procedurat e mëtejshme”*. Me vendimin e datës 23.12.2014, përmbartuesi gjyqësor ka vendosur zgjidhjen e kontratës në mënyrë të njëanshme, datë 10.6.2012, dhe kthimin e akteve kreditorit.

11.7. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm, Komisioni konstaton se subjekti ka paraqitur në mënyrë shteruese dokumentacionin që provon se nuk e ka marrë apartamentin e porositur me kontratën nr. ***, datë 24.6.2009.

²⁰⁶ Email datë 13.5.2020.

²⁰⁷ Email datë 1.6.2020.

²⁰⁸ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.3.2010; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** akti, datë 20.5.2010; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.***, datë 3.10.2013; shkresë nr. *** prot., datë 27.5.2014, e Zyrës së Shërbimit Përmbartimor A. P.: procesverbal i datës 10.6.2014, i Zyrës së Shërbimit Përmbartimor A. P.; vendim i datës 23.12.2014, i Zyrës së Shërbimit Përmbartimor A. P..

Burimet e krijimit të shumës 11.800 euro

11.8. Në përgjigje të pyetësorit standard²⁰⁹, subjekti ka deklaruar se në vitin 2009 ka bërë një shpenzim prej 11.800 euro si kapar për prenotimin e një apartamenti banimi dhe se burimi financiar ka qenë një kredi e marrë pranë Raiffeisen Bank në masën 1.000.000 lekë, të ardhurat e tij, babait e nënës, plus të ardhurat e babait nga aktiviteti privat si ekografist.

Kredi nga Raiffeisen Bank, në vlerën 1.000.000 lekë

11.9. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Hua e marrë nga Raiffeisen Bank – qëllimi është blerje apartamenti banimi – shuma totale 1.000.000 lekë, datë fillimi 19.6.2009 dhe mbarim 19.6.2013, këst mujor 30.000 lekë. Aktualisht e mbyllur*”. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²¹⁰.

11.10. Referuar dokumentacionit të administruar nga Raiffeisen Bank²¹¹, rezulton se ndërmjet subjektit dhe kësaj banke është lidhur kontrata e kredisë bankare, e datës 19.6.2009, sipas së cilës banka ka rënë dakord t’i japë subjektit shumën 1.000.000 lekë, me qëllim përdorimin e tyre për arsye personale. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë rezulton se kjo kredi është lëvruar në datën 19.6.2009 dhe subjekti ka tërhequr shumat 500.000 lekë në datën 22.6.2009 dhe 460.000 lekë në datën 23.6.2009.

11.11. Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me përdorimin e kësaj kredie si burim për pagesën e shumës 11.800 euro.

Të ardhurat e shtetasit P. T. si ekografist në shumën 200.000 lekë, në vitin 2008

11.12. Komisioni trajtoi të ardhurat ndër vite nga aktiviteti si ekografist të personit të lidhur P. T. (në pikën 20 të këtij vendimi), nga ku rezultoi se fitimi neto në vitin 2008 ka qenë 155.700 lekë. Më tej, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet e subjektit dhe prindërve, për periudhën 1.1.2009 – 31.7.2009²¹², nga ku rezultoi një balancë pozitive në shumën 95.134 lekë.

11.13. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme në vlerën 11.800 euro për pagesën e kaparit për blerjen e apartamentit.

12. Të ardhurat nga dhënia me qira e banesës në rrugën “**”, në shumën 573.000 lekë bruto dhe 470.728 lekë neto**

12.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira e banesës në rrugën “****” për periudhën 2.5.2013 – 1.9.2016, në shumën 573.000 lekë bruto

²⁰⁹ Përgjigje për pyetësorin standard nr. *** prot., datë 31.1.2020, i Komisionit.

²¹⁰ Kontratë kredie bankare datë 19.6.2009; kontratë premtim shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.6.2009; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.7.2009; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** akti, datë 20.5.2010; nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 23.1.2017.

²¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020.

²¹² Vlera 10.800 euro paguar në datën 24.6.2009 dhe vlera 1.000 euro paguar në datën 31.7.2009.

dhe 470.728 lekë neto. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²¹³.

12.2. Për vërtetimin e marrëdhënies së qirasë dhe të ardhurave të realizuara nga kjo marrëdhënie, gjatë hetimit administrativ janë administruar dokumentet: (i) kontrata e qirasë për banim nr. ***, datë 3.5.2013 (e administruar nga notere D. K.²¹⁴), sipas së cilës subjekti i ka dhënë me qira shtetasit N. U. apartamentin²¹⁵ në rrugën “****”, me vlerë 15.000 lekë dhe afat 2.5.2013 – 2.5.2014; (ii) deklarata noteriale nr. ***, datë 19.1.2016 (e administruar nga noterë M. Xh.²¹⁶), në të cilën subjekti dhe shtetasi N. U. kanë deklaruar se kanë vazhduar me mirëbesim marrëdhënien e tyre si qiradhënës dhe qiramarrës për një afat nga data 2.5.2015 deri më 2.9.2015; (iii) deklarata noteriale nr. *** datë 25.7.2016 (e administruar nga notere A. A.²¹⁷), ku subjekti dhe shtetasi S. F. kanë deklaruar marrëdhënien e qerasë ndërmjet tyre nga data 2.2.2016 deri më 2.7.2016, me çmimin 15.000 lekë/muaj; (iv) kontrata e qirasë për banim nr. ***, datë 25.8.2016 (e administruar nga noter Ilirjan Isaj²¹⁸), e lidhur ndërmjet subjektit dhe shtetasit E. E. Z., për dhënien me qira të apartamentit²¹⁹ të ndodhur në rrugën “****”, për një periudhë 3-vjeçare, 1.9.2016 – 31.8.2019, ku parashikohet se qiraja mujore është 13.000 lekë.

12.3. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor justifikues lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për vitet 2013, 2014 e 2015²²⁰, nga ku rezulton se pagesat për këto vite janë bërë në datën 28.10.2016.

12.4. Me anë të pyetësorit nr. 2²²¹, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të sqaronte se cili ishte shkaku që i ka paguar detyrimet tatimore për vitet 2013, 2014 e 2015 me vonesë, si dhe të paraqesë dokumentacionin për pagimin e tatimeve në vitin 2016, të deklaruara në vlerën 153.000 lekë. Në përgjigje²²², subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shkaku që janë paguar detyrimet tatimore të qirasë me vonesë është mungesa e eksperiencës për mënyrën se si duheshin paguar tatimet në mënyrë periodike, duke menduar për të kryer një pagesë të vetme tatimore për gjithë kohëzgjatjen e një marrëdhënie me një qiramarrës konkrete...”*. Ndërsa për detyrimet tatimore për qiranë e vitit 2016, deklararon se janë paguar në datën 2.3.2022.

²¹³ Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.5.2013; kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.4.2014; deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.1.2016; deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.7.2016; kontratë qiraje për banim nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.8.2016; mandatpagesë datë 28.10.2016 e Credins Bank + urdhërpagesë për periudhën janar – dhjetor 2014; mandatpagesë datë 28.10.2016 e Credins Bank + urdhërpagesë për periudhën janar – dhjetor 2013.

²¹⁴ Shkresë protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 27.9.2021.

²¹⁵ Nr. pasurie ***, z. k. ***.

²¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 7.9.2021.

²¹⁷ Shkresë datë 4.10.2021.

²¹⁸ Shkresë datë 4.10.2021.

²¹⁹ Nr. pasurie ***, z. k. ***.

²²⁰ Mandatpagesë e Credins Bank, datë 28.10.2016, “Veprim në llogarinë Tako Gjergji”, me përshkrimin “Tat. Fitim + Gjobë + Kamatë. Janar – Dhjetor 2013. Shuma 27.373 lekë” bashkë me urdhërpagesën e printuara nga sistemi elektronik i tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2013; mandatpagesë e Credins Bank, “Veprim në llogarinë Tako Gjergji”, e datës 28.10.2016, me përshkrimin “Tat. Fitim + Gjobë + Kamat. Janar – Dhjetor 2014. Shuma 45.760 lekë” bashkë me urdhërpagesën e printuara nga sistemi elektronik i tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2014; mandatpagesë e Credins Bank, “Veprim në llogarinë Tako Gjergji”, e datës 28.10.2016, me përshkrimin “Tat. Fitim + Gjobë + Kamat. Janar – Dhjetor 2015. Shuma 30.595 lekë” bashkë me urdhërpagesën e printuara nga sistemi elektronik i tatimeve për periudhën tatimore janar – dhjetor 2015.

²²¹ Email datë 21.2.2022.

²²² Email datë 2.3.2022.

12.5. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimin se: *Shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore për vitet 2013, 2014 e 2015 dhe pagimi i detyrimeve tatimore të vitit 2016 gjatë procesit të hetimit administrativ nga Komisioni, në datën 2.3.2022, vërteton se subjekti në mënyrë të vazhdueshme nuk tregon kujdesin (diligjencën) e duhur për përmbushjen në kohë të detyrimeve tatimore.*

12.6. Në përgjigje të rezultateve të hetimit²²³, subjekti shpjegon se i ka deklaruar çdo vit të ardhurat e qirasë. Sipas tij, Kolegji, në vendimin nr. ***, datë 18.6.2021, orienton që subjekti duhet t'i jetë afuar kufijve të neneve 180 apo 181 të Kodit Penal, që qiraja të mos i quhet e ligjshme në kushtet pagesës së detyrimeve tatimore me vonesë. Gjithashtu, shpjegon se nuk ka qenë ndonjëherë subjekt me risk dhe ka paraqitur si provë shkresën nr. *** prot., datë 20.4.2022, të DRT-së Tiranë, e cila lidhur me pyetjen e subjektit nëse është përfshirë ndonjëherë në listën e subjekteve me risk, sqaron se ndaj tij nuk rezulton të jetë ushtruar apo programuar kontroll tatimor në vend.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

12.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

12.8. Komisioni, bazuar në qëndrimin orientues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit²²⁴ në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, nëse ato do të konsiderohen të ardhura të ligjshme, çmon se vlerësimi i tyre është bërë duke pasur në vëmendje disa rrethana. *Së pari*, duhet që të provohet bindshëm ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, pasi pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për të provuar krijimin e të ardhurave që nuk provohen me mjete të tjera. *Së dyti*, në konsideratë mbahet sjellja e subjektit në raport me mospagimin në kohë të tyre. Brenda këtyre kritereve, Komisioni ka vlerësuar rrethanat që kanë shkaktuar mospagimin në kohë të detyrimit për të përcaktuar nëse mospagimi ka qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie, apo një qëllim për t'u arritur.

12.9. *Lidhur me provimin e ekzistencës së të ardhurave nga qiraja*, Komisioni konstaton se nga hetimi administrativ rezulton se: (i) subjekti, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 29.10.2004, ka blerë apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 57 m², me adresë rr. “***”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë; (ii) me anë të kontratës premtim shitjeje nr. ***, datë 1.9.2012, parashikohet se pala premtuese shitëse i premtton palës blerëse Gjergji Tako shitjen e një apartamenti të ndodhur në ***, me nr. ***, kuota + 23.90, kati 7, tipologjia 2+1, me sipërfaqe totale 101.87 m² dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme 90.97 m²; (iii) në përgjigje të pyetësorit standard²²⁵, subjekti ka deklaruar: *“Për periudhën e rivlerësimit 1 mars 2013 e në vijim banoj në ***, pallati ***, hyrja ***, kati i ***-të, ap. *** ose ***”*. Këto fakte tregojnë që subjekti është

²²³ Email datë 21.4.2022.

²²⁴ Vendim nr. 15, datë 18.6.2021 (JR), pg. 23.

²²⁵ Përgjigje për pyetësorin standard nr. *** prot., datë 31.1.2020, i Komisionit.

pronar i pasurisë apartament të dhënë me qira, si dhe është bërë pronar i një banese tjetër të ndryshme nga ajo që ka deklaruar se e ka dhënë me qira.

12.10. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ është provuar se subjekti i rivlerësimit i ka dhënë me qira shtetasit N. U. apartamentin në rrugën “***”, për periudhat 2.5.2013 – 2.5.2014, 2.5.2014 – 2.5.2015 dhe 2.5.2014 – 2.9.2015, në vlerën 15.000 lekë/muaj. Më pas, këtë apartament ia ka dhënë me qira shtetasit S. F. për periudhën 2.2.2016 – 2.7.2016, me çmimin 15.000 lekë/muaj, si dhe ka lidhur kontratën e qirasë nr. ***, datë 25.8.2016, me shtetasin E. Z., për një periudhë 3-vjeçare, 1.9.2016 – 31.8.2019, me çmimin 13.000 lekë/muaj.

12.11. Sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen për ekzistencën e marrëdhënies së qirasë dhe të ardhurave nga kjo marrëdhënie.

12.12. Lidhur me sjelljen e subjektit për mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore, Komisioni konstaton se subjekti i ka shlyer detyrimet e tatimit në burim nga qiraja për vitet 2013, 2014 e 2015 në datën 26.10.2016, duke paguar edhe gjobat përkatëse. Gjithashtu, ka vijuar me pagimin me vonesë të detyrimeve tatimore edhe për vitin 2016, ku ka deklaruar se i ka shlyer në datën 2.3.2022.

12.13. Nga analizimi i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se në nenin 7²²⁶ parashikohet se të gjithë individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale dhe në nenin 8²²⁷ (i ndryshuar me ligjin nr. 8841/2001) përcakton si të ardhura të tatueshme të ardhurat nga qiratë. Referuar dispozitave ligjore që kanë qenë në fuqi në vitin 2013, rezulton se neni 33²²⁸ përcaktonte se personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10% nga shuma bruto e pagesave për qiratë. Pas ndryshimeve të ligjit nr. 8438/1998 me ligjin nr. 156/2014²²⁹, tatimi mbi fitimin nga qiraja u përcaktua në masën 15%. Gjithashtu, neni 35²³⁰ i ligjit ka parashikuar se paguesi i shumave duhet të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës. Sipas udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar²³¹, parashikohet se detyrimin për mbajtjen e tatimit në burim e kanë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat

²²⁶ Ligji nr. 8438/1998, neni 7, parashikon: “Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu”.

²²⁷ Ligji nr. 8438/1998, neni 8, parashikon: “Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: ...d) të ardhurat nga enfitheoza, huaja dhe qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar...”.

²²⁸ Ligji nr. 9326/2004, neni 33, parashikon: “1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10% nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë... ë) pagesat nga qiratë...”.

²²⁹ Hyrë në fuqi në datën 9.1.2015.

²³⁰ Neni 35 parashikon: “...b) Paguesi i shumave, për efekt të mbajtjes së tatimit në burim, të parashikuar në nenin 33..., është i detyruar të llogarisë, të mbajë, të deklarojë dhe të derdhë tatimin e mbajtur në burim, në llogaritë e organeve tatimore deri në datën 20 të muajit pasardhës të muajit të pagesës”.

²³¹ Udhëzimi nr. 5/2006, pika 5.1, parashikon: “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat. Në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”.

jofitimprurëse dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33.

12.14. Nga analiza e mësipërme, tatimi mbi të ardhurat nga qiraja është parashikuar që në vitin 2001 dhe subjekti detyrohej të paguante tatimin në burim në llogari të organeve tatimore deri në datën 20 të çdo muaji. Në rastin konkret, qiramarrës të banesës rezultojnë individë dhe jo persona juridikë dhe si pasojë ishte detyrim i subjektit të bënte pagimin e tatimit mbi të ardhurat.

12.15. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se shlyerja me vonesë e detyrimeve tatimore për vitet 2013, 2014 e 2015 dhe pagimi i detyrimeve tatimore të vitit 2016 gjatë procesit të hetimit administrativ nga Komisioni, në datën 2.3.2022, tregon për moszbatimin e detyrimit ligjor prej subjektit në kohën kur ky detyrim ka lindur, për pasojë pagimi me vonesë i këtij detyrimi, në referim edhe të jurisprudencës së Kolegjit²³², nuk e shëron paligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

12.16. Në përfundim, Komisioni nuk i mori në konsideratë të ardhurat nga qiraja të deklaruara nga subjekti në analizën financiare.

PASURITË E BASHKËSHORTES SË SUBJEKTIT, ZNJ. M. T.

Komisioni konstaton se në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka paraqitur certifikatën familjare të datës 24.1.2017, të lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, ku rezulton se subjekti Gjergji Tako figuron në përbërjen familjare me shtetasen M. T. dhe shtetasin P. T.. DPGJC-ja²³³ informon se subjekti i rivlerësimit dhe shtetasja M. P. T. kanë lidhur martesë në datën 2.9.2016. Në pyetësin standard²³⁴ subjekti deklaroi se jetesën me bashkëshorten e ka filluar në datën 2.9.2016²³⁵.

13. Automjet tip “Opel Astra G”, me targë *, në vlerën 4.000 euro**

13.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, shtetasja M. T. (D.) ka deklaruar automjetin tip “Opel Astra G”, me targë ***, me vlerë 4.000 euro. Si burim krijimi deklaroi të ardhura nga kursimet e saj, të ardhurat historike familjare të prindërve dhe mbetje nga marrëdhëniet me firmat piramidale.

13.2. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja²³⁶ rezultoi se me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.10.2011, shtetasja M. D. ka blerë nga shtetasi R. L. automjetin e mësipërm kundrejt shumës 4.000 euro.

13.3. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

14. Pjesa ideale në apartamentin e banimit të familjes

14.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se është pronare e pjesës ideale të një apartamenti banimi të familjes së saj, e cila vijon të jetë e regjistruar në ZVRPP në

²³² Vendim nr. 15, datë 18.6.2021.

²³³ Shkresë nr. *** prot., datë 13.10.2021.

²³⁴ Përgjigje për pyetësin standard nr. *** prot., datë 31.1.2020, i Komisionit.

²³⁵ “Për periudhën e deklarimit 2.9.2016 e në vijim kam bashkëjetuar me prindin P. T. dhe bashkëshorten M. T.”.

²³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021.

emrin e babait të saj. Nuk deklaroi burim krijimi. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²³⁷.

14.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Tiranë Jug²³⁸ rezultoi se shtetasi P. D., me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2000, ka blerë nga shtetasi T. A. apartamentin me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me adresë: rruga “****”, p. ***, shk. *** k. ***, ap. ***, Tiranë, me sipërfaqe totale 75 m², kundrejt çmimit 1.500.000 lekë, shumë të cilën blerësi ia ka likuiduar shitësit totalisht jashtë zyrës noteriale.

14.3. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2017, rezultoi se shtetasi P. D. ka ndërruar jetë në datën 21.5.2016 dhe trashëgimtarë ligjorë të tij janë njohur V. D. (bashkëshortja), J. D. (i biri), M. T. (D.) (e bija), D. D. (e bija), të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimtarit P. B. D., me nga 1/4 pjesë secili.

14.4. Komisioni vlerëson se dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ provon burimin e krijimit të pjesës në pasurinë apartament²³⁹ të personit të lidhur M. T. nga trashëgimia.

14.5. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

15. Llogari bankare në Credins Bank

15.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur ka deklaruar se ka llogari bankare pranë Credins Bank nga viti 2016 e në vijim, ku kalon paga e detyrës shtetërore pranë ALUIZNI-t, Drejtoria Tirana Rurale. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues²⁴⁰.

15.2. Nga informacioni i përcjellë nga Credins Bank²⁴¹ konfirmohet se personi i lidhur ka llogari bankare, ku nga verifikimi i lëvizjeve të saj konstatohet kreditimi i pagës nga ALUIZNI.

15.3. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

16. Gjendje cash në vlerën 327.784 lekë

16.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur ka deklaruar gjendje *cash* prej mbylljes së llogarisë bankare në BKT, ku ishte akumuluar paga e shoqërisë “****” sh.p.k. dhe një pjesë prej rreth dy muajsh e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në vlerën 327.784 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues²⁴².

²³⁷ Certifikatë pronësie e pasurisë nr. ***, z. k. ***, në emër të shtetasit P. D., datë 28.12.2000.

²³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2020; kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.12.2000; dëshmi e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.3.2017; kartelë e pasurisë së paluajtshme nr. ***, z. k. ***.

²³⁹ Nr. pasurie ***, z. k. ***.

²⁴⁰ Lëvizje e llogarisë bankare pranë Credins Bank.

²⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2020.

²⁴² Lëvizje e llogarisë bankare pranë BKT-së.

16.2. Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja²⁴³ konstatohet se në datën 25.1.2016 personi i lidhur ka tërhequr vlerën 327.784 lekë (të gjithë balancën e llogarisë). Kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

16.3. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e shumës 327.784 lekë në gjendje *cash*.

17. Automjet tip “Volkswagen Golf 1”

17.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur ka deklaruar se ka pasur një automjet tip “Volkswagen Golf 1”, të blerë në vlerën 150.000 lekë dhe e ka shitur në vlerën 50.000 lekë.

17.2. Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja²⁴⁴ rezulton se shtetasja M. D. ka blerë me kontratë nr. ***, datë 24.4.2007, automjetin tip “Volkswagen”, vit prodhimi 1979, me çmimin 150.000 lekë. Referuar lejes së qarkullimit rrugor, datë 27.4.2007, në emër të shtetasës M. P. D., ky automjet mban targën ***. Më pas, ky automjet është shitur nga personi i lidhur me kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.9.2008, kundrejt çmimit 50.000 lekë.

17.3. Nga verifikimi i faqes elektronike të AMF-së rezulton se subjekti figuron përdorues i automjetit tip “Volkswagen”, me targë ***, në periudhën 8.5.2008 – 7.5.2009.

17.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

18. Llogari bankare ndër vite

18.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur ka deklaruar se ka pasur: (i) llogari në Tirana Bank në periudhën 2003 – 2005, e mbyllur, rreth 500.000 lekë; (ii) llogari në Raiffeisen Bank ku i kalonte paga e shoqërive “****” dhe “****”, e mbyllur, në periudhën 2006 – 2013, (iii) llogari në Bankën Kombëtare Tregtare në vitet 2013 – 2016 ku i kalonte paga e shoqërisë “****” dhe e detyrës shtetërore pranë DPB-së, e mbyllur, pa vlerë konkrete.

18.2. Komisioni administroi dokumentacionin përkatës për këto llogari bankare, nga ku rezultoi se ato figurojnë të mbyllura.

18.3. Në përfundim, Komision nuk konstaton problematika lidhur me këto llogari bankare.

18.4. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë e bashkëshortes, konkretisht: (i) automjet tip “Opel Astra G”, me targë ***, me çmim 4.000 euro; (ii) gjendje e llogarisë bankare pranë Credins Bank, në datën 1.9.2016, me vlerë 605.596 lekë; (iii) gjendje *cash* në vlerën 327.784 lekë.

18.5. Sipas certifikatës familjare të datës 24.1.2017, të lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, rezulton se gjendja familjare e shtetasit P. D. në datën 1.10.2010 përbëhej nga këta persona: P. D., V. D., M. D., D. D..

²⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 30.1.2020.

²⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021.

18.6. Subjekti ka paraqitur në deklaratën *Vetting* 2017 dokumentacionin provues²⁴⁵ lidhur me të ardhurat e shtetasve M. D., P. D. dhe V. D..

18.7. Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm, atij të dorëzuar në pyetësonin nr. 2²⁴⁶ dhe atij të administruar nga Komisioni, rezulton si në vijim: (i) Të ardhura neto të personit të lidhur/M. D. në shumën totale 1.899.942 lekë, përgjatë periudhës 2004 – 2016, konkretisht: (a) në shumën 62.229 lekë nga punësimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k.²⁴⁷; (b) në shumën 448.213 lekë nga punësimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k.²⁴⁸; (c) në shumën 555.004 lekë nga punësimi pranë shoqërisë “****” sh.p.k.²⁴⁹; (ç) në shumën 704.052 lekë nga punësimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve²⁵⁰; (d) në shumën 130.445 lekë nga punësimi pranë ALUIZNI-t²⁵¹; (ii) Të ardhura nga pensioni ushtarak të përkohshëm të të ndjerit P. D.²⁵², në shumën 2.418.333 lekë, për periudhën 20.1.2007 – 30.5.2016; (iii) Të ardhura nga fitimi në gjykatë i shtesës së pensionit të të ndjerit P. D.²⁵³, në shumën 3.749.273 lekë; (iv) Të ardhura nga pensioni i pleqërisë i shtetas V. D.²⁵⁴, në shumën 1.383.105 lekë²⁵⁵, për periudhën 19.8.2011 – 30.10.2016; (v) Të ardhura nga paga të shtetas V. D.²⁵⁶, në shumën 1.695.698 lekë, për periudhën 2007 – 2011, të ardhura të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti, por që iu referuan kreditimeve në llogarinë bankare me përshkrimin “paga” dhe u morën në konsideratë, për sa kohë që për këtë periudhë u përlllogaritën edhe shpenzime jetese; (vi) Të ardhura nga tërheqja e mbetjes nga firma piramidale “****” të shtetas V. D.²⁵⁷, në datën 5.8.2005, në vlerën 46.315 lekë.

18.8. Duke qenë se Komisioni konstatoi se personi i lidhur nuk ka kryer asnjë tërheqje nga llogaria bankare në Credins Bank dhe ka kryer tërheqje të vogla nga llogaria në BKT, me anë të pyetësonit nr. 2²⁵⁸ i kërkoi shpjegime subjektit si i ka përballuar shpenzimet e jetesës bashkëshortja e tij, të paraqesë dokumentacionin justifikues, si dhe të deklarojë adresat e banimit dhe personat me të cilët ka jetuar bashkëshortja nga viti 2004 deri më 2.9.2016. Në përgjigje²⁵⁹, subjekti i rivlerësimit deklaroi se në periudhën 2015 – 2.9.2016 (data e martesës) bashkëshortja e tij ka jetuar me

²⁴⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 11.11.2016, i ISSH-së; kopje libreze pune të shtetas M. D., lëshuar në datën 1.11.2006; vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016, i DRSSH-së Tiranë për shtetasin P. D.; vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016, i DRSSH-së Tiranë për shtetasen V. D.; vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016, i DRSSH-së Tiranë për shtetasen Q. D.; mandatpagesë e Bankës Kombëtare Tregtare, datë 5.8.2005; certifikatë familjare e shtetasit P. D., datë 24.1.2017.

²⁴⁶ Librezë pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi në emër të shtetasit P. D.; lëvizjet bankare nga Banka Credins, tërheqje pensioni P. D.; vërtetim pensioni nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, datë 24.2.2022, V. D.; vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për punësimin e D. D, datë 23.2.2022; certifikata familjare (fotokopje).

²⁴⁷ Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare me nr. ***, datë 11.11.2016.

²⁴⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 27.10.2021, e ISSH-së, Drejtoria e Arkivit Tiranë, përlllogaritë pagat neto bazuar në legjislacionin në fuqi të kohës, vënë në dispozicion të subjektit përlllogaritjet e detajuara në Excel.

²⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.1.2020, e ISSH-së.

²⁵⁰ Referuar kreditimeve në llogaritë bankare të personit të lidhur.

²⁵¹ Referuar kreditimeve në llogaritë bankare të personit të lidhur.

²⁵² Vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016, i DRSSH-së Tiranë.

²⁵³ Referuar vendimit nr. ***, datë 16.6.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të paraqitur nga subjekti në pyetësonin nr. 2 dhe vlerave të kredituara në llogarinë bankare pranë Credins Bank të të ndjerit P. D..

²⁵⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 7.11.2016.

²⁵⁵ Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur ka deklaruar vlerën 1.472.700 lekë, por nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë ai figuron vlera 1.383.105 lekë.

²⁵⁶ Referuar kreditimeve në llogarinë bankare me përshkrim “Paga”.

²⁵⁷ Sipas dokumentit “Mandatpagesë kreditorët e ***-s”, datë 5.8.2005, të Bankës Kombëtare Tregtare, rezulton se shtetasja V. D. në datën 5.8.2005 ka tërhequr shumën 46.135 lekë.

²⁵⁸ Email datë 21.2.2022.

²⁵⁹ Email datë 2.3.2022.

familjarët e saj, në kuptimin e ndërveprimit ekonomik dhe në përbërjen familjare kanë qenë babai i saj P. D. (ndërruar jetë në datën 21.5.2016), nëna e saj V. D. dhe motra D. D..

18.9. Sa më sipër, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar nëse të ardhurat e prindërve të personit të lidhur mbulonin shpenzimet jetike²⁶⁰ për periudhën janar 2007²⁶¹ – tetor 2016²⁶². Referuar analizës financiare rezultoi se prindërit e personit të lidhur kanë pasur mundësi për përballimin e shpenzimeve të jetesës edhe për personin e lidhur.

18.10. Gjithashtu, Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat dhe pasuritë e krijuara përpara martesë nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit²⁶³, nga ku rezultoi se personi i lidhur/bashkëshortja ka pasur të ardhura të ligjshme në shumën 1.819.497 lekë, të mjaftueshme për blerjen e pasurive përpara martesës, në vlerën 1.645.700 lekë.

18.11. Në përfundim, Komisioni vlerëson se deklarimi është i saktë dhe përputhet me dokumentacionin justifikues.

PASURITË E BABAIT TË SUBJEKTIT, Z. P. T.

Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 2017 në përbërjen familjare edhe babain e tij P. T., duke paraqitur gjithashtu certifikatën familjare të datës 24.1.2017, të lëshuar nga Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë. Në këto kushte, bazuar në pikën 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, shtetasi P. T. konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe, si i tillë, ka plotësuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur.

Sa më sipër, Komisioni, bazuar në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, hetoi pasuritë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre të personit të lidhur P. T..

19. Aparat mjekësor “Eko”

19.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar aparat mjekësor ekzaminimi imazherik “Echo” nr. *** serie, i markës “Fukuda Denshi”, me pjesë 100%. Si burim krijimi deklaroi se është deklarata noteriale nr. ***, datë 8.6.2001, ku djali i tij i madh E. T. e ka blerë për 4.000 USD dhe ia ka dhënë në posedim nga ajo datë e në vijim me vlerë 4.000 USD, sipas dokumentacionit dhe 5.000 euro vlera reale e tregut të asaj kohe (2001). Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁶⁴.

19.2. Referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., datë 8.6.2001, të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezultoi se shtetasi A. K. ka deklaruar: “*I kam shitur z. E. P.T., i datëlindjes 4.3.1969, një aparat ekografie “Fukuda Denshi FF-Sonic”, tipi UF-4000, me nr. serie 30151836, Class 1-B, me një sondë sektoriale, 3.5 MHz, FUT-C111A, me një çmim prej 4.000 USD*”.

²⁶⁰ Për periudhën 2007 – 2014 u përllogaritën për prindërit, personin e lidhur dhe motrën; për periudhën 2015 – tetor 2016 për prindërit dhe personin e lidhur (motra ka filluar punësimin dhe nuk u llogaritën as të ardhura e as shpenzime).

²⁶¹ Të dhënat lidhur me të ardhurat e prindërve fillojnë në këtë periudhë.

²⁶² Deri në lidhjen e martesës të personit të lidhur me subjektin.

²⁶³ Shpenzimet e jetesës u përfshinë në analizën e prindërve.

²⁶⁴ Deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 8.6.2001, e shtetasit A. K..

19.3. Komisioni konstaton se personi i lidhur P. T. e ka deklaruar për herë të parë vetëm në deklaratën *Vetting* 2017 blerjen dhe marrjen në përdorim të aparatit “Eko” nga shtetasi E.T..

19.4. Pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Pika 14 e nenit 3 parashikon se persona të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit. Në rastin konkret, marrëdhënia e huapërdorjes pa kundërshtëpërblim e aparatit “Eko” është krijuar ndërmjet shtetasit E. T. dhe personit të lidhur P. T. dhe jo me subjektin e rivlerësimit.

19.5. Duke marrë në konsideratë faktet se: (i) subjekti ka provuar me dokumentacion se aparati “Eko” është blerë nga vëllai i tij E. T. në vitin 2001; (ii) marrëdhënia ndërmjet shtetasit E. T. dhe babait të tij P. T. është një marrëdhënie huapërdorjeje pa kundërshtëpërblim; (iii) gjatë kontrollit të kësaj pasurie nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë – në këto kushte, Komisioni, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit²⁶⁵, vlerëson të mos e shtrijë hetimin administrativ mbi burimin e ligjshëm të blerjes së aparatit “Eko” nga shtetasi E. T..

20. Të ardhurat e personit të lidhur P. T. nga aktiviteti tregtar si ekografist

20.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar të ardhura nga vetëpunësimi si biznes privat “Diagnostikim mjekësor me eko”, për periudhën 2008 – 2011, në shumën 496.000 lekë, pas zbritjes së detyrimeve të paguara për shtetin.

20.2. Subjekti ka paraqitur një vërtetim të Bashkisë Përmet²⁶⁶, sipas të cilit shtetasi P. T. ka ushtruar aktivitet me NIPT *** në qytetin e Përmetit, lagjja “****”, si ekografist, aktivitet i cili ka pasur sipas viteve përkatëse xhiron vjetore: (i) viti 2008 xhiro 200.000 lekë; (ii) viti 2009 xhiro 120.000 lekë; (iii) viti 2010 xhiro 150.000 lekë; (iv) viti 2011 xhiro 150.000 lekë.

20.3. Nga dokumentacioni i administruar nga QKB-ja²⁶⁷ rezulton se shtetasi P. T. është regjistruar si person fizik me NUIS ***, në datën 12.2.2008, me fushë veprimtarie “ekografist” dhe është çregjistruar në datën 4.4.2011.

20.4. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër²⁶⁸ informon se subjekti “****”, i regjistruar si person fizik me NIPT *** dhe adresë lagjja “****”, Përmet, është me status çregjistruar në datën 5.4.2011 dhe se pranë Agjencisë Rajonale Tatimore Përmet nuk ekziston asnjë dokument ose e dhënë për këtë subjekt.

20.5. Bashkia Përmet²⁶⁹ sqaron se subjekti tregtar “P. T.” ka deklaruar për vitin 2011 se do të realizojë një xhiro prej 150.000 lekësh. Kjo deklaratë bëhej që në janar të vitit ushtrimor, por brenda tremujorit të parë të vitit 2011 subjekti “P. T.” ka aplikuar pranë QKB-së për çregjistrim dhe është çregjistruar në datën 4.4.2011 dhe si pasojë Zyra e Tatim-Taksave të Bashkisë nuk i ka

²⁶⁵ Vendim nr. 24, datë 28.7.2021.

²⁶⁶ Vërtetim nr. *** datë 23.1.2017, i Bashkisë Përmet.

²⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2020; ekstrakt historik datë 23.1.2020.

²⁶⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 10.2.2020.

²⁶⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.11.2021; shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2021.

llogaritur detyrime për vitin 2011, pasi nuk ka realizuar xhiro dhe se për hetim tatimor duhet të merret xhiroja e viteve 2008, 2009 dhe 2010. Gjithashtu është përcjellë informacion lidhur me pagesën e taksave të ndërtesës, tabelës, pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit për vitet 2008 – 2010²⁷⁰.

20.6. Për sa i përket pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël, në pyetësin nr. 2 subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 1.3.2020, të Bashkisë Përmet²⁷¹, ku konfirmohet se ky subjekt tregtar ka paguar këstet e tatim-fitimit ndër vite, konkretisht 16.500 lekë në vitin 2008²⁷², 22.000 lekë në vitin 2009²⁷³ dhe 22.000 lekë në vitin 2010²⁷⁴.

20.7. Sa më lart, në analizim të dokumentacionit të administruar, Komisioni përlllogarit fitimin neto për çdo vit kalendarik, të paraqitur në tabelën në vijim, dhe e pasqyroj atë në analizën financiare.

Tabela nr. 5 – Të ardhurat dhe shpenzimet nga aktiviteti tregtar/babai

Viti/përshkrimi	2008	2009	2010	2011	TOTAL
Qarkullim	200,000	120,000	150,000	-	470,000
Shpenzim për këstet e tatimit mbi biznesin e vogël ²⁷⁵	-16,500	-11,000	-27,500	-5,500	-60,500
Shpenzim për taksat e tjera vendore ²⁷⁶	-15,800	-17,200	-15,920	-	-48,920
Shpenzime qiraje	-12,000	-12,000	-12,000	-4,000	-40,000
Fitim neto/humbje	155,700	79,800	94,580	-9,500	320,580

21. 1/5 pjesës ideale e një banese dhe truall në *** (Përmet)

21.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur P. T. ka deklaruar se është pronar i pjesës ideale 1/5 e banesës së prindërve të tij në Përmet dhe i një trualli me sip. 120 m² të prindërve në fshatin *** (ku janë 5 vëllezër e motra) dhe këto pasuri ende nuk janë regjistruar në ZVRPP, ndërkohë që aplikimi është bërë. Nuk deklaroi specifikisht burim krijimi, por nga deklarimi konstatohet se kjo pronë vjen nga trashëgimia e prindërve. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁷⁷.

21.2. Me anë të pyetësit nr. 1²⁷⁸, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit se kush e zotëron ose posedon ndërtimin dhe truallin aktualisht. Në përgjigje subjekti ka deklaruar: “...trualli prej 120 m² është në fshatin *Novoselë të rrethit Përmet... banesa e prindërve të babait tim P. T. në fshatin *** -Përmet është plotësisht e rrafshuar dhe nuk ekziston më si banesë. As mbetjen e banesës dhe*

²⁷⁰ Sipas tabelës së paraqitur në shkresë, ka paguar taksat mbi ndërtesën, tabelën, pastrimin, ndriçimin, gjelbërimit, ku: në vitin 2008 ka paguar në total 15.800 lekë; në vitin 2009 ka paguar në total 17.200 lekë; në vitin 2010 ka paguar në total 15.920 lekë.

²⁷¹ Kopje e vërtetimit nr. *** prot., datë 1.3.2022, të Bashkisë Përmet.

²⁷² Këste prej 5.500 lekësh në datat 12.6.2008, 21.10.2008 dhe 24.12.2008.

²⁷³ Këste prej 5.500 lekësh në datat 26.2.2009, 16.11.2009 dhe 12.1.2010 (dy pagesa në këtë datë).

²⁷⁴ Këste prej 5.500 lekësh në datat 25.5.2010, 3.8.2010, 5.12.2010 dhe 25.1.2011.

²⁷⁵ Referuar datave të pagesës së cituara në shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2022, Bashkia Përmet.

²⁷⁶ Referuar datave të pagesës së cituara në shkresën nr. *** prot., datë 29.10.2021, Bashkia Përmet.

²⁷⁷ Fletë regjistri i bujqve dhe tokave që punojnë, katundi ***, Përmet.

²⁷⁸ Email datë 13.5.2020.

as truallin nuk e posedon askush. Jemi në përpjekje e sipër për të realizuar regjistrimin zyrtar të kësaj prone pranë ASHK-së”.

21.3. Referuar dokumentit justifikues të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, “Fletë regjistrimi i bujqve dhe i tokave që punojnë”, Komuna ***, Nënprefektura Përmet, rezulton se në emër të kryefamiljari G. T. në N. figuron e regjistruar pasuria truall me sip. 120 m² dhe disa parcela tokë bujqësore me sipërfaqe totale 5.240 m².

21.4. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Gjirokastrë²⁷⁹ rezulton se me aktin noterial “Dëshmi trashëgime ligjore” është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore e trashëgimlënësës Th. T., e cila ka ndërruar jetë në datën 16.6.2000, ku rezultojnë trashëgimtarë të radhës së parë shtetasit A. G. A., P. G. T., V. G. T., Y. G. T. dhe A. G. Th. (T.).

21.5. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit për këtë pasuri.

22. 1/5 e pjesës ideale të disa pronave (dyqane dhe shtëpi banimi) në Vlorë

22.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, personi i lidhur P. T. ka deklaruar se është pronar i pjesës ideale 1/5 të disa pronave (dyqane dhe shtëpi banimi) në Vlorë, të cilat janë regjistruar në emër të shtetasve Th. T., P. T. dhe O. T.. Shtetasja O. T. ka pasur dy vajza, A. dhe Th. dhe ai ka 1/5 e pjesës së Th., nënës së tij. Pronat janë aktualisht të regjistruara në emër të pronarëve origjinalë. Nuk ka përllogaritje të saktë, për sa kohë nuk ka pjesëtim në natyrë të pronës për secilin trashëgimtar të pronarëve origjinalë, si pjesë e deklaruar 1/5 e 1/2 së 1/3. Nga përshkrimi i mësipërm, burimi i krijimit është trashëgimia. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues²⁸⁰.

22.2. Subjekti paraqiti në deklaratën *Vetting* 2017 vendimet nr. *** prot., datë 18.1.1995, nr. ***, datë 19.11.1994 dhe nr. ***, datë 23.13.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Bashkia e Qytetit, ku përcaktohet njohja si ish-pronar të Th. T., P. T. dhe O. T. të 5 dyqaneve që ndodhen në lagjen “****”, Vlorë, 2 dyqane që ndodhen në lagjen “****”, një magazine që ndodhet në lagjen “****”, një shtëpie me dy pjesë që ndodhet në lagjen “****”, një shtëpie me 5 dhoma në lagjen “****”, kthimin në natyrë të tyre dhe kompensimin e një sipërfaqeje truall prej 390 m².

22.3. Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 2²⁸¹, i kërkoi subjektit të shpjegonte nëse pronat e përmendura në vendimin e mësipërm të KKKPronave janë regjistruar pranë ASHK-së Vlorë, si dhe t’i vinte në dispozicion kopje të njehsuar me origjinalin të dokumentit të regjistrimit. Në përgjigje²⁸², subjekti paraqiti kopje të certifikatës së pasurisë nr.***, z. k.***, Vlorë, nga ku rezulton se shtetasi P. T. është bashkëpronar i kësaj pasurie me pjesë 36/720.

²⁷⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 20.2.2020.

²⁸⁰ Vendim nr. ***, datë 19.11.1994 dhe nr. *** datë 23.13.1994, i KKKPronave; notë transkriptimi datë 15.12.1934.

²⁸¹ Email datë 21.2.2022.

²⁸² Email datë 2.3.2022.

22.4. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit për këtë pasuri.

KONSTATIME TË TJERA – PASURIA E SHTETASIT P. T.

23. Truall me sip. 374 m² dhe 100 m² ndërtesë, me adresë në Përmet, në emër personit të lidhur P. T., si bashkëpronar

23.1. Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Përmet²⁸³ rezulton se sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme të ASHK-së shtetasit P. T., V. T., Y. T. e A. Th. janë bashkëpronarë të pasurisë nr. ***, z. k. ***, e llojit truall, nga të cilat truall 374 m² dhe ndërtesë 100 m², me adresë Bashkia Përmet.

23.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të origjinës së regjistrimit të kësaj pasurie rezulton se regjistrimi i kësaj pasurie rrjedh nga nota e transkriptimit e datës 3.7.1970, në favor të shtetasit G. T., ku pasqyrohet se shtetasja L. T. i ka ceduar këtij të fundit pronësinë e një shtëpie të ndodhur në Përmet, në lagjen “****”, e përbërë prej 2 katesh, me kusht që shtetasi G. T. të kujdesej për ushqimin e saj. Sipas vendimit nr. ***, datë 10.4.1986, të Gjykatës Popullore të Rrethit Përmet, shtetasi G. T. ka ndërruar jetë në datën 8.2.1986 dhe sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.4.2017, bashkëshortja e tij Th. T. ka ndërruar jetë në datën 16.6.2000, duke lënë si trashëgimtarë ligjorë fëmijët e tyre P. T., V. T., Y. T. dhe A. Th.. Në këto kushte, duket se pasuria e mësipërme rrjedh nga trashëgimia.

23.3. Në përfundim, Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit për këtë pasuri.

24. ANALIZA FINANCIARE

24.1. Komisioni kreu analizën financiare të fragmentuar në tri periudha: (i) 1996 – 2004 për të ardhurat, shpenzimet, detyrimet dhe pasuritë për subjektin dhe prindërit²⁸⁴; (ii) 2005 – 2008 për prindërit e subjektit²⁸⁵; (iii) 2005 – 2008 për subjektin; (iv) 2009 – 2016 për subjektin dhe personat e lidhur²⁸⁶, si dhe i vendosi në dispozicion subjektit të rivlerësimit aneksin nr. 1, me emërtimin “Analiza financiare” dhe aneksin nr. 2, me emërtimin “Metodika e analizës financiare”.

24.2. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personi i lidhur/babai kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 270.705 lekë për pagesën e apartamentit dhe të mobilimit të tij, si dhe për kryerjen e shpenzimeve në vitin 2012*, për të cilën subjekti paraqiti prova dhe shpjegime, trajtuar në paragrafët 2.64 - 2.69 të këtij vendimi.

²⁸³ Përgjigje e ardhur nëpërmjet sistemit elektronik të ASHK-së, në datën 11.5.2022.

²⁸⁴ Paraqitur në paragrafin 1.49 të këtij vendimi.

²⁸⁵ Paraqitur në paragrafin 2.27 të këtij vendimi.

²⁸⁶ Paraqitur në vijim, në tabelën nr. 13 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

24.3. Pas analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trajtuar në seksionet përkatëse të këtij vendimi, në tabelën në vijim paraqitet analiza financiare e rishikuar për periudhën 2005 – 2016.

Tabela nr. 6 – Analiza financiare për periudhën 2005 – 2016

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete <i>cash</i>	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhura	Detyrime	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
2005	736,833	0	-304,538	930,779	500,000	159,057	839,427
2006	0	0	1,398	863,452	-100,000	345,585	416,469
2007	0	0	35,044	799,681	-100,000	223,572	441,065
2008	0	0	-36,539	845,048	-150,000	141,120	590,467
2009	1,529,074	0	1,117,112	2,487,711	980,000	602,740	218,785
2010	0	0	-298,567	1,402,038	0	706,954	993,651
2011	0	0	-16,712	1,316,095	-30,000	753,756	549,050
2012	5,353,919	0	-1,071,976	1,398,233	5,087,560	1,922,035	281,815
2013	0	0	-86,394	1,546,155	-80,000	771,670	780,879
2014	0	0	-169,591	1,715,726	0	967,474	917,843
2015	0	0	37,742	1,791,085	700,000	1,701,542	751,800
2016	897,320	327,784	600,685	3,438,158	-67,635	1,417,148	127,585
TOTAL	8,517,146	327,784	- 192,335	18,534,159	6,739,925	9,712,653	6,908,837

24.4. Në përfundim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për periudhën 2005 – 2016 për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë

25. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në përfundimin se pavarësisht përdorimit të automjeteve pa leje qarkullimi përbën veprim në kundërshtim me etikën e prokurorit, duke marrë në konsideratë faktin se nga hetimi administrativ i pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako ndodhet në kushtet e deklaramit të saktë dhe me burime të ligjshme, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se ky fakt nuk përbën shkak për shkarkim nga detyra, referuar nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

26. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 17.1.2020, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr.***, datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

26.1. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Gjergji Tako: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

26.2. Komisioni kërkoi nga AKSIK-ja rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës të z. Gjergji Tako. Në përgjigje, AKSIK-ja²⁸⁷ ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin Gjergji Tako, sipas të cilit Grupi i Punës konfirmon konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Hetimi i Komisionit

26.3. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK -ja, Komisioni kreu hetim administrativ pranë organeve verifikuese dhe kërkoi informacion të përditësuar për subjektin e rivlerësimit, nga ku rezultoi se: (a) nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës; (b) nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit; (c) nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal për subjektin e rivlerësimit; (ç) nuk ka të regjistruar procedim penal apo kallëzim penal apo të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara gjatë hetimit; (d) nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

26.4. Në përfundim, Komisioni vlerëson se: (i) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (ii) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (iii) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, në përputhje me shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

27. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (a) raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë; (b) të dhënat e administruara nga Prokuroria e Përgjithshme; (c) denoncimet nga publiku; (ç) dosjet penale të administruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas vendimeve të ndërmjetme të datave 4.5.2022 dhe 10.5.2022; (d) shpjegimet e subjektit

²⁸⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 3.2.2022.

pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht; (dh) shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit kryesisht shtesë, si dhe shpjegimet e tij në seancat dëgjimore.

28. Nga 8 dosje të analizuar, Komisioni ka vlerësuar se: (i) Dokumenti nr. 2 “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2014” nuk përmban elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (ii) Në dosjen nr. 1, të përfunduar me vendimin për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në pyetje bashkëshorten e viktimës, me qëllim sqarimin e shkaqeve që kanë çuar në vetëflijimin e viktimës, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (iii) Në dosjen nr. 2, të përfunduar me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e rezultateve të aktit të ekspertimit nëse është ose jo i rremë, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (iv) Në dosjen nr. ***, të përfunduar me vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (v) Në dosjen nr. ***, të përfunduar me “Kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2013”, subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka përfshirë në dokumentin e njoftimit të akuzës së të pandehurit akuzën për veprën penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, sipas referimit të policisë; (b) akti “Për plotësimin e akuzës” ndaj shtetasit B. Q., për veprën penale “mbajtje pa leje të municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, është hartuar pa kryer veprime hetimore shtesë; (c) kërkesa për gjykimin e procedimit penal nuk përmban analizën e individualizimit të përgjegjësisë penale për secilin të pandehur, si dhe analizën e elementeve të figurës për veprat penale që akuzohen, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore; (vi) Në dosjen nr. ***, të përfunduar me “Kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, datë 18.11.2013”, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar vlerësimin mbi faktin penal dhe analizën e elementeve të figurës së veprës penale në ngarkim të të pandehurit, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës.

29. Nga verifikimi i të dhënave arkivore ka rezultuar se në vitin 2005 Prokurori i Përgjithshëm i ka dhënë subjektit të rivlerësimit masën disiplinore “vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”.

30. Nga verifikimi i ankesave të paraqitura në Prokurorinë e Përgjithshme dhe kallëzimet penale të regjistruara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Komisioni ka vlerësuar se: (i) Në vendimin për mosfillimin e materialit kallëzues nr. ***, datë 16.5.2019, për kryerjen e veprës penale “ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për verifikimin e rezultateve të aktit të ekspertimit nëse janë ose

jo të rreme, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (ii) Në procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit: (a) ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion objektiv dhe ligjor; (b) nuk ka administruar aktet e procedimit penal sipas parashikimeve të nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale; (c) ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të datës 31.5.2016 për pushimin e procedimit penal pas afro 5 muajve nga ardhja e materialit të ekzekutimit të letërporosisë nga Ministria e Drejtësisë; (ç) kërkesa për ndihmë juridike e përcjellë me shkresën e datës 25.5.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka sjellë si pasojë zvarritje të hetimeve; (d) vendimi i datës 20.6.2017 për pushimin e procedimit penal është marrë pa administruar provat e nevojshme për të dalë në një konkluzion të drejtë ligjor, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (iii) Në procedimin penal nr. ***, të vitit 2017, i regjistruar për veprën penale “ekspertim i rremë”, të parashikuar nga neni 309 i Kodit Penal, përveç konstatimeve në pikën (i): (a) arsyetimi në vendimin e datës 28.7.2017 për regjistrimin e procedimit penal me arsyetimin se *“Një procedim penal ndaj ekspertëve mund të niste vetëm në fund të shqyrtimit gjyqësor me një vendim të formës së prerë të çështjes”*, nuk është i mbështetur në nenin 309 të Kodit Penal; (b) kërkesa e datës 29.1.2018 për pushimin e çështjes penale nuk mbështetet në nenin 309 të Kodit Penal; (c) arsyetimi i subjektit të rivlerësimit në kërkesën e datës 29.1.2018, për pushimin çështjes penale se *“Vendimi i Gjykatës së Lartë përkrah qëndrimin e ekspertëve”*, nuk është i mbështetur në vendimin e Gjykatës së Lartë, duke treguar mangësi në aspektin e arsyetimit ligjor, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin.

31. Nga shqyrtimi i denoncimeve të paraqitura, Komisioni ka vlerësuar se: (i) Në procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për veprën penale “mjekim i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit: (a) në vendimin për regjistrimin e emrit të personit nën hetim, aktin e njoftimit të akuzës të pandehurit dhe në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015, nuk ka arsyetuar lidhur me shkakun determinant të ardhjes së pasojës fatale për jetën të shtetas M. B.; (b) në aktin e njoftimit të akuzës së të pandehurit dhe në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015 nuk ka arsyetuar lidhur me qëndrimin e kundërt me konkluzionet e aktekspertimit mjekoligjor; (c) në kërkesën për gjykim të datës 25.11.2015 nuk ka arsyetuar se cilat janë veprimet apo mosveprimet e të pandehurit që nuk përputhen me protokollet mjekësore, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsyetimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit; (ii) Në kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2018, i regjistruar për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar veprimet hetimore për verifikimin e aktit me të cilin ka kaluar në kufi i mituri S. Ç., duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të

ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore.

32. Nga shqyrtimi i dosjeve penale të administruara sipas vendimeve të ndërmjetme për shtrirjen e hetimit administrativ lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale për periudhën 11.12.2007 – 8.10.2016, Komisioni ka vlerësuar se: (i) Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 31.1.2014, për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer hetimet e nevojshme për të verifikuar faktin nëse i dyshuari ka ndërtuar në pronë publike; (b) në vendimin për mosfillimin e procedimit penal nuk ka analizuar ligjin për planifikimin e territorit dhe elementet e figurës së veprës penale, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (ii) Në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (iii) Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, datë 31.1.2014 dhe në kërkesën për dërgimin e çështjes për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me anën objektive të kryerjes së veprës penale “ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur shtetasit janë konstatuar se po kryenin ndërtim të paligjshëm mbi banesën e tyre ekzistuese; (iv) Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2014, të regjistruar për kryerjen së veprës penale “dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar analizën ligjore përkatëse, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (v) Në vendimin për mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. ***, të vitit 2015, për kryerjen e veprës penale “mosbindje ndaj punonjësit që ruan rendin publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar nenet e Kodit Penal që mbrojnë veprimtarinë e rregullt të organeve të policisë së rendit publik, veprimet ose mosveprimet që parashikon secila dispozitë për t’u konsideruar e konsumuar nga ana objektive vepra penale përkatëse, nuk ka arsytuar se pse në rastin konkret nuk vërtetohet shkelja e këtyre dispozitave, si dhe nuk ka pasqyruar dispozitat përkatëse procedurale që parashikojnë ankimin drejtpërdrejt në gjykatë, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues, të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit; (vi) Nga shqyrtimi i akteve të procedimeve penale nr. ***, viti 2013; nr. ***, viti 2015; nr. ***, viti 2014; nr. ***, viti 2016; nr. ***, viti 2016, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “mbajtje e lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore në drejtim të përcaktimit të nocionit ligjor-penal “dozë e vogël”, për efekt të zbatimit të nenit 283 të Kodit Penal dhe

jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë²⁸⁸ dhe në vendimet e pushimit të procedimeve penale nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit/dyshuarit, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, si dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës. Përveç këtyre konstatimeve, subjekti i rivlerësimit në tri raste²⁸⁹ nuk ka kërkuar kryerjen e aktit të ekspertimit kimik të lëndës së sekuestruar dhe në një rast²⁹⁰ nuk ka administruar aktin e ekspertimit toksikologjik, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues, të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (vii) Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “ndotja e ajrit”, të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit lidhur me nivelin e parametrave të shkarkimit në ajër të elementeve kimike, me qëllim arritjen e përfundimit nëse veprimet e të dyshuarit janë kundërvajtje administrative apo penale, në kundërshtim me nenin 201 të Kodit Penal, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik; (viii) Në procedimin penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit: (a) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e anës objektive të veprës penale; (b) nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore me qëllim përcaktimin e anës subjektive të kryerjes së veprës penale të dyshuar, duke treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, si dhe në kriterin e aftësisë organizative për të kryer procedurat hetimore; (ix) Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2013, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (x) Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “mashtrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke treguar mangësi në aspektin e arsytimit ligjor, bazuar në treguesin e cilësisë së analizës; (xi) Në kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “fshehje të ardhurash”, të parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë analizën e elementeve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të

²⁸⁸ Vendimi unifikues nr. 1, datë 27.3.2008.

²⁸⁹ Procedimet penale nr. ***, nr. *** dhe nr. ***.

²⁹⁰ Procedimi penal nr. ***.

interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik; (xii) Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të dyshuar, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë nëse të dyshuarit kanë konsumuar veprën penale përkatëse, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik; (xiii) Në vendimin për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, i regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e barazisë në tenderë”, të parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka analizuar elementet e figurës së veprës penale të dyshuar, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë ligjor nëse të dyshuarit kanë konsumuar veprën penale përkatëse, duke shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në tregues, të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin dhe në aspektin e arsytimit ligjor në marrjen e vendimit, duke u bazuar në tregues të tillë si cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik.

33. Në konkluzion të të gjithë vlerësimit profesional sa më sipër, të shtjelluar në mënyrë më të detajuar në vendimin e ndërmjetëm nr. *** akti, datë 17.6.2022, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka shfaqur në mënyrë të përsëritur mangësi në ndjekjen logjike të hetimit sipas kërkesave ligjore në arsytimin e vendimeve, në analizën e elementeve të figurës së veprës penale, në analizimin e jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si dhe në analizimin e legjislacionit përkatës në rastet kur dispozita e Kodit Penal ishte *blankete* (e bardhë).

34. Pas analizimit të detajuar të dosjeve të administruara qoftë në kuadrin e vlerësimit profesional, qoftë në kuadrin e vlerësimit të figurës, Komisioni konstatoi mangësi profesionale, të cilat mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së programit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës.

35. Me vendimin nr. *** akti, datë 17.6.2022, trupi gjykues vendosi pezullimin nga detyra të z. Gjergji Tako për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.

35.1. Në përfundim të këtij trajnimi, me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2023, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar në Komision rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit, bazuar në pikën 2 të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016.

35.2. Bazuar në rezultatet e arritura, të miratuara nga Këshilli Pedagogjik, si dhe Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. ***, datë 18.7.2023, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Gjergji Tako, ka arritur rezultate të mira, duke i kaluar mangësitë e parashtruara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në përfundim, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se subjekti:

- a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. bazuar në shkresën e Shkollës së Magjistraturës rezulton se ka përfunduar me sukses programin e trajnimit, duke mënjanuar mangësitë e konstatuara nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a”, nenit 59, pika 1 dhe të nenit 60 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Gjergji Tako, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 15.9.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj